



NJË MANUAL UDHËZUES PËR TË KUPTUAR BIBLËN

*Një metodë e thjeshtë dhe e
shkallëzuar për një studim
biblik të dobishëm dhe
për zbatim jetësor*

XHOSH MEKDAUELL

NJË METODË E THJESHTË DHE E PËRMBLEDHUR STUDIMI VETJAK QË MUND TË TË ÇOJË NË NJË NJOHJE MË TË THELLË TË BIBLËS

Shumë të krishterë dëshirojnë një kuptim më të thellë të Biblës, por u mungon një metodë e frytshme studimi. Të tjerë mendojnë se njohja e thellë e Biblës kërkon më tepër kohë nga sa kanë në dispozicion. Në këtë libër, folësi, autori dhe apologjist i njohur ndërkombëtar, Xhon Mekdouell, tregon për metodën e tij për t'u futur në thellësi të Biblës: një metodë që ti mund ta përshtasësh sipas programit tënd. Ai të udhëheq përmes tre hapave të thjeshtë që mund t'i përdorësh në tërë Shkrimin për të nxjerrë kuptimin më të thellë që ke dëshiruar gjithmonë.

Hapi i parë: *Si ta "shikosh". Një udhëzues rreth vëzhgimit*

Hapi i dytë: *Si ta "njohësh". Një udhëzues rreth interpretimit*

Hapi i tretë: *Si ta "vësh në praktikë". Një udhëzues rreth zbatimit*

Xhon Mekdouell, në çdo hap, ju drejton përmes përdorimit të tabelave, ilustrimeve dhe diagramave, duke ju dhënë një panoramë të qartë rreth asaj që do të arrish, duke zbatuar metodat e tij të studimit. Përveç kësaj ai do t'ju drejtojë në përzgjedhjen dhe përdorimin e ndihmësive të studimit si komentaret, çelësat dhe fjalorët bibliqë, përkthimet e Biblës, programet kompjuterike dhe ndihmësa të tjerë për studimin e Biblës.

Qofsh mësues i Biblës, drejtues i një grupi të vogël, studiues apo thjesht i krishterë që kërkon të thellohesh, ky libër do të të ndihmojë të bëhesh një student i dalluar i Shkrimit.



NJË MANUAL UDHËZUES PËR TË KUPTUAR BIBLËN

*Një metodë e thjeshtë dhe e
shkallëzuar për një studim
biblik të dobishëm dhe
për zbatim jetësor*

XHOSH MEKDAUELL

Josh
MCDOWELL
MINISTRY

DM
EAST



eBooks for download
east.om.org/ebooks



Përkthyes: Nardi Doka
Redaktuan: Aurora Manaj, Valbona Avdullaj

Titulli i origjinalit:
Guide to Understanding Your Bible nga Josh McDowell
© 2006 nga Josh McDowell

Originally published in English under the title
Guide to Understanding Your Bible by Josh McDowell.
© 2006 by Josh McDowell.

© 2014 by OM EAST for the Albanian edition.
Translated by permission. All rights reserved.

1

PSE TË STUDIOJMË BIBLËN?

Ta përvetësosh të vërtetën e Perëndisë

Po të jesh si unë, do të thotë se ke kaluar raste të shumta kur ke dashur ta njohësh Biblën aq mirë, sa disa pasazhe të nevojshme të të vijnë në mendje. Ndoshta të është dashur gjykim për një problem, udhëzim për të marrë një vendim të rëndësishëm, urtësi për të ndihmuar një mik ose dikë tjetër, ose thjesht të është dashur frymëzim për të përballuar ditën.

Ti mund të mendosh: “Po, e dua këtë lloj njohjeje biblike, por nuk është e mundur për mua. Mua s’më kujtohet as çfarë kam ngrënë dje për drekë, jo më ndonjë pjesë e panjohur nga libri i Habakukut”. Unë e kuptoj atë që mendon, sepse kam menduar më parë ashtu, por tani jo më. Tani po përdor një metodë studimi biblik, që më ka dhënë një thesar të njohjes biblike, të cilin mund ta përdor sa herë që të dua. Më kujtohen pasazhe dhe parime të panumërta biblike kur nuk më ndodhet afër një Bibël, ose kur nuk mund ta hap se po bëj diçka, si për shembull, po ngas makinën.

Nëse mendon se kjo metodë kërkon orë të tëra mësimi përmendësh të Shkrimit të Shenjtë, qetësohu! Unë besoj se mësimi përmendësh është i vlefshëm dhe e rekomandoj, por nuk është ky fokusi i këtij libri. Ajo nuk është një metodë që synon formimin për të përvetësuar *Shkrimin*, por synon të jetë një ndihmesë për përvetësimin e *përmbajtjes* së tij, në një mënyrë aq të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë sa e bën përvojën të kënaqshme. Por kur them “thjesht”, nuk nënkuptoj se nuk ka asnjë punë, por se metoda ime nuk është e ndërlikuar ose e vështirë për t’u kuptuar. Asgjë e vlefshme nuk vjen pa asnjë përpjekje, por, nëse e merrni mundimin, jam i sigurt se do të provoni të njëjtën ndjenjë gazmore që kam ndjerë unë, ndërsa njohja e fjalës së Perëndisë rritej në zemrën time dhe bëhej pjesë e qenies sime. Psalmisti David

e ka thënë bukur: *Porositë e Zotit janë të drejta dhe e gëzojnë zemrën* (Ps. 19:8).

Nuk besoj se më duhet të të bind për rëndësinë e Biblës. Nëse nuk beson në vlerën dhe të vërtetën e saj, nuk do ta merrje fare në dorë.

Me kaq shumë studime biblike në qarkullim, programe biblike kompjuterike dhe burime interneti të disponueshme, mund të habitesh pse nevojitet një libër për kuptimin e Biblës. Shumë prej këtyre burimeve të japin informacionin paraqitës ndaj çdo libri të Biblës, për të cilën do të të udhëzoj se si të mësosh vetë në faqet vijuese. Pse të mos lexojmë gjithçka rreth kuptimit, shkrimit, prejardhjes dhe mesazhit të librit të Isaisë në një studim biblik, në vend që ta shqyrtojmë vetë?

Në fakt, ky “shqyrtim që mund të bësh vetë” është çelësi. Njohja duhet të jetë jotja personalisht, e rrënjosur thellë në zemrën tënde. Të gjithë e dimë se një besim i trashëguar rrallëherë është kuptimplotë ose i fuqishëm. Megjithëse mund të jesh rritur në kishë nga prindër të devotshëm, ose mund të jesh kthyer në besim (te Jezusi) pasi të ka mbushur mendjen një mik, ti duhet ta njohësh vetë të vërtetën dhe t'i përvetësosh besimet. E vërteta në zemrën tënde duhet të jetë më shumë se sa një seri presupozimesh, që i pranon pasivisht nga prindërit, ose mësuesit e tu. Në të njëjtën mënyrë, kuptimi i Biblës do të jetë më i pasur dhe do të ngulitet më thellë, nëse do të ndërtosh themelet e njohjes në zemrën tënde, në vend që të përdorësh punën e të tjerëve.

Sot të krishterët kushtëzohen të mësojnë nga Shkrimi, por jo që t'i shqyrtojnë vetë të vërtetat. Procesi i të zbuluarit vetë të së vërtetës, të çon në një bindje më të madhe personale. Murgu i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Martin Luteri, e kishte aq të fortë këtë bindje, sa e përktheu Biblën në gjuhën gjermane, atë të popullit. Po e njëjta bindje e nxiti Kameron Taunsendin të niste punën e Përkthyesve Biblikë të Uiklifit, duke i ndihmuar njerëzit në mbarë botën që të kenë Bibla për studim personal, në gjuhën e tyre. Përkthyesi i kësaj organizate, Çet Biterman, e kishte këtë bindje aq të fuqishme, sa ishte gati të jepte edhe jetën për të.

Unë nuk kam asgjë kundër studimeve biblike, programeve studimeve biblike, programeve kompjuterike ose burimeve biblike të internetit, përkundrazi i rekomandoj, jam mirënjohës dhe i përdor ato. Në këtë libër do të të drejtoj te burime të tilla dhe do të të tregoj se si t'i përdorësh disa prej tyre, por vetë i nxis studentët t'i përdorin për të ndërtuar një njohje personale të Biblës, në vend që të varen nga burimi kryesor i njohjes, tek i cili duhet të kthehen sa herë që t'u duhen përgjigje. Qëllimi i autorit është që këto burime të përdoren për të

mbushur mendjen me njohuri, jo që të mbështetesh tek to si burim i jashtëm i njohjes, ku mund të drejtohesh sa herë që të jetë e nevojshme.

Rëndësia e disiplinës

Të studiosh Fjalën e Perëndisë është si të drejtohesh nga Shpirti i Shenjtë. Është një proces rritjeje i qëndrueshëm dhe i përditshëm. Rruga është e thyer dhe do të ndeshesh me gjendje të ndryshme shpirtërore gjatë udhëtimit. Disa ditë do të të duket se ndodhesh në majën e malit. Gjithçka që lexon dhe studion do të jetë gazmore dhe mendja do t'i kapë mirë. Kurse ditë të tjera, do të ecësh përmes një lëndine. Procesi do të duket i mërzitshëm dhe mendja jote nuk do të përqendrohet në detyrën që është përpara. Rëndësi ka që të shpërfillësh ndryshimet e gjendjes shpirtërore dhe të përparosh, sepse vazhdimësia do të japë fryt. Shumë njerëz mendojnë se të vërtetat e Biblës do të brofin tek ata, sapo të hapin librin. Këtë presim shpesh në këto kohë të plotësimit të menjëhershëm të dëshirave. Duam t'i kemi rezultatet në dorë brenda një çasti, por Perëndia nuk vepron në këtë mënyrë. Ai është i përkushtuar si ndaj procesit, ashtu edhe ndaj produktit, sepse e di që i pari garanton. Kështu vepron gjithmonë Ai. Për dyzet vjet Zoti përgatiti Moisiun, për tre vjet Palin dhe për pesëmbëdhjetë vjet Jozefin. Pse duhet të nxitohemi?

Studimi biblik kërkon kohë, përkushtim dhe zbatim, ashtu si edhe matematika, biokimia, rënia e pianos, ndërtimi i shtëpisë, ose fluturimi i një avioni. Asgjë e vlefshme nuk vjen pa përpjekje dhe përkushtim. Ti do të përkushtohesh pas diçkaje, edhe sikur të mos e plotësosh atë. Disa njerëz përkushtohen për të kaluar kohën e lirë para ekranit të televizorit. Bëhen ekspertë për të thënë fjalët magjike drejtuar Rrotës së Fatit, për të bërë pyetje të parëndësishme rreth rrezikut, ose për të folur rreth ngatërresave të jetëve të personazheve të një telenovele. A nuk është puna e të mësuarit të Biblës për pak orë, më përmëshese se sa të ngurtësuarit e mendjes me një dietë elektronike pasive gjërash të pavlera?

Synimi i këtij studimi

Synimi ynë përfundimtar për të kuptuar Biblën nuk është interpretimi, por zbatimi. Ne nuk kërkojmë më shumë njohje mendore në vetvete, por që t'ia përshtatim sa më shumë jetën dhe shërbesën tonë shëmbëllimit të Jezu Krishtit. Synimi është të njohim më shumë vullnetin e Perëndisë për jetët tona, që ta vëmë në praktikë dhe t'ua shfaqim natyrën e tij të tjerëve.

Tri kushte

Për të përmbushur këtë synim, të duhet të plotësosh tri kushte. Së pari, duhet të drejtosh vullnetin tënd. Sa serioz je për të studiuar Fjalën e Perëndisë dhe për t'u rritur si i krishterë? Sa e fuqishme është dëshira jote për t'iu përshtatur shëmbëllimit të Krishtit? Ashtu si u lut vetë Krishti: “Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar” (Gjoni 17:3).

Kushti i dytë për ty është të drejtohesh nga Shpirti i Shenjtë. Siç na thotë apostulli Pal tek Efesianëve 5:18: “Mbushuni me Shpirt”. Pa iu hapur Shpirtit të Shenjtë të Perëndisë, ai nuk mund të të mësojë. Një studim i ftohtë dhe mekanik i librit do të të japë thjesht fakte, por jo dallim ose urtësi. Informacioni mund të magazinohet në mendjen tënde, por libri nuk do të hapet dhe nuk do të vërshojë në jetën tënde, nëse nuk i nënshtrohesh udhëheqjes dhe ndriçimit të Shpirtit të Shenjtë. Të drejtohesh nga Shpirti do të thotë të shqyrtosh çdo sferë të jetës, duke hequr çdo gjë që është në kundërshtim me vullnetin e Perëndisë dhe duke u pastruar, nëpërmjet rrëfimit të çdo mëkati të njohur. Apostulli Gjon na thotë: “Po t'i rrëfejme mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na i falë ato dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi” (1 Gjoni 1:9). Pastaj kërkoji Shpirtit të Shenjtë të të mbushë, të të kontrollojë dhe fuqizojë çdo ditë.

Kushti i tretë për një kuptim të efektshëm biblik është të jetosh nën ndikimin e Fjalës së Perëndisë, të kalosh kohë duke e studiuar, sepse pa kaluar kohë, duke lexuar seriozisht Biblën, nuk mund të rritesh në njohje, sado të dhëna të nxjerrësh gjatë ushtrimeve që do të të tregoj në këtë libër. Vetë Bibla dhe jo thjesht studimi rreth Biblës është çelësi i njohjes.

Donald Grei Barnhaus, ish-pastori i kishës Tenth Presbyterian të Filadelfias, teksa po udhëtonte me tren, po lexonte Biblën. Një student i ri që ishte ulur midis radhëve, ngriti sytë nga gazeta që po lexonte dhe dalloj personalitetin e shquar kishtar.

Pas pak, mori guximin dhe pyeti:

– Dr. Barnhaus, si mund të jem një njeri i Fjalës së Perëndisë dhe ta njoh Biblën si ti?

Pastori vështroi materialet e studentit dhe u përgjigj:

– Bir, nëse kalon më shumë kohë duke lexuar gazetatat se sa këtë libër, do të kesh më shumë njohuri për gazetatat se sa për Biblën.

Dr. Barnhausi nuk po mohonte rëndësinë e njohjes së kulturës, por

e kishte fjalën për përparësitë. Cila është kryesorja? Çfarë lexon më shumë? A është Bibla përparësia kryesore në jetën tënde?

Qëllimi

Qëllimi i këtij libri është që Fjala të të drejtojë ty dhe jo ti atë. Njohja mendore e Biblës është e kotë, nëse nuk të çon në një shndërrim të plotë të jetës. Ashtu si thotë Pali te Romakëve 12:2:

Dhe mos iu përshtatni kësaj bote, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë.

Qëllimi i studimit biblik është të të nxisë të mendosh si Krishti. Ndërsa do të fillosh të mendosh si Krishti, do të veprosh si Ai. Dhe ndoshta sot, më shumë se në ndonjë periudhë tjetër në historinë njerëzore, ne kemi një nevojë të ngutshme që njerëzit të modelojnë Krishtin në shoqërinë tonë.

Ka shumë të ngjarë që e pranon Biblën si të vërtetë dhe të frymëzuar, ndryshe nuk do të ishte duke e lexuar, por mendo sa pikëpamje e ndryshme është kjo nga pikëpamja mbizotëruese postmoderne e të rinjve tanë.

Ti shpall se ke një të vërtetë të jashtëzakonshme, një të vërtetë që i mohon të gjitha të tjerat. Kjo e vërtetë është universale dhe absolute për të gjithë njerëzit, në çdo kohë e vend.

Ti shpall se e vërteta është e dokumentuar në një libër. Të gjitha këto shpallje bien në kundërshtim me filozofinë mbizotëruese, që mëson se nuk ka të vërtetë absolute, se të gjitha shpalljet e të vërtetave janë të barabarta dhe asnjëra nuk është absolute. Ata që e kanë këtë filozofi nuk i besojnë librit tënd. Që t'u tregosh të vërtetën rreth Krishtit, duhet ta modelosh atë. Duhet t'u tregosh atyre një mënyrë të jetuari që do t'i bëjë t'u shkojë goja lëng. Duhet të studiosh librin, të njohësh personin për të cilin flet, ta modelosh jetën tënde pas tij dhe t'u japësh bashkëmoshatarëve modelin më të lartë të dashurisë, duke u zbuluar dhe përcjellë dashurinë e Krishtit. Kjo është rëndësia serioze e studimit biblik. Ti e përvetëson të vërtetën e librit, e bën tënden dhe e zbaton në jetë, që të tjerët ta shohin.

Pra, nuk është fjala për rregulla. Perëndia nuk do që ne të studiojmë Biblën thjesht për të mësuar ligjet e jetës së krishterë ose për t'u frymëzuar për një jetë më të mirë. Kur i hapesh Biblës, ti i hap një derë

zembrës së saj, një mënyrë që ta njohësh atë, ashtu si është në të vërtetë. Ai jo vetëm fton për ta njohur atë, por jep edhe fuqinë për të jetuar si ai (2 Pjetër 1:3-4). Kur Fjala e Zotit rrenjohet në zemrën tënde, jeta jote dhe fjalët e tua do të dëshmojnë për realitetin e Zotit para botës. Meqenëse Zoti është brenda teje, jeta jote do të pasqyrojë jetën e Zotit para të tjerëve.

Kur Fjala pushton zemrën tënde, jeta jote dhe fjalët e tua do të dëshmojnë realitetin e Perëndisë në botë. Me Perëndinë në ty, do t'u tregosh të tjerëve për Të.

Perëndia na zgjodhi për të qenë pjesë e familjes së tij, sepse kjo e kënaq atë jashtë mase. Ai na zgjodhi për të qenë si ai, sepse ky është që nga fillimi vendi ynë në planin e tij kryesor. Na zgjodhi që ta pasqyronim atë tek të tjerët, sepse kjo është rruga e tij për të sjellë bekimet në botë. Dhe pa fjalën e Perëndisë në zemrën tonë, ne do të ishim pa një zbulim të saktë të saj, pa qenë në gjendje që ta njohim ashtu si është. Kjo është domethënia e Biblës për secilin prej nesh dhe për jetët tona të përditshme. Fjala e Perëndisë është lentja e përsosur me anë të së cilës mund të shohim Perëndinë dhe qëllimin tonë, i cili është të pasqyrojë natyrën hyjnore të Perëndisë. Ky është qëllimi ynë për ta studiuar.

Në këtë libër do të mësosh një metodë për studimin biblik. Nëse e zbaton vetë, do të mësosh thelbin e Biblës në brendësi dhe do ta njohësh më mirë se mikun tënd më të ngushtë. Nuk do ta hapësh më Biblën pa mësuar diçka. Pa dyshim që je habitur me pastorët ose mësuesit që gjejnë disa ide për të cilat nuk të ka shkuar kurrë mendja, në pasazhet që i ke lexuar shumë herë dhe pyet veten, se si vallë e zbuloi ai këtë njohuri. Nëse ndjek me zell planin tim studimor, do ta zbulosh vetë këtë. Do të shohësh kuptime të freskëta të pasazheve të njohura. Paralelizma dhe zbatime biblike do të shfaqen në çdo situatë. Ndërkohë që i shpreh dashuri bashkëshortit tënd ose bashkëshortës sate, të dashurit ose të dashurës sate, papritur të kujtohet një parim të dashurisë biblike. Do ta kthesh një studim të mërzitshëm në një aktivitet elektrizues. Çdo përvojë do të kalojë përmes një drite të re, drita e Perëndisë që shkëlqen përmes faqeve të Biblës dhe nëpërmjet pranisë së Shpirtit të tij të Shenjtë në jetën tënde.

Plani

Mund të duket se po e bëj studimin biblik mjaft të ndërlikuar. Pse të mos lexojmë thjesht Biblën dhe të meditojmë, duke e lejuar Shpirtin

e Shenjtë të na japë njohurinë e nevojshme? Në kopshtin e Edenit gjërat mund të kenë shkuar mirë, por në këtë botë të rënë në mëkat, na duhet pak strukturë që të arrijmë me siguri një njohje të plotë dhe të sigurt.

Rreziqet e metodave të rastësishme biblike janë të shumta dhe të mëdha. Njëri prej rreziqeve është moskuptimi i një pasazhi, duke qenë se nuk respektojmë me kujdes atë që thuhet në të. Një tjetër rrezik është ai i keqkuptimit, pasi kemi vetëm një informacion të pjesshëm të temës që jemi duke studiuar. Shpesh Bibla qartësohet vetëm nëse do të dimë vendndodhjen e pasazheve përkatëse të Biblës. Një rrezik tjetër është ai i studimit të një pasazhi, pa e lidhur atë me kontekstin e vet. Kuptimi i vargut do të ndikohet gjithnjë nga vargjet paraardhëse dhe nga ato pasuese. Metoda e studimit biblik që do të mësoni, do t'ju ndihmojë për t'i shmangur këto rreziqe.

Ja si do të veprojmë. Së pari, unë do ta kaloj metodën time të studimit të Biblës, hap pas hapi, duke të treguar saktësisht se si funksionon. Pas përmbledhjes, do të të tregoj si ta zbatosh studimin në jetën tënde.

Në të kaluarën unë riparoja vetura të vjetra dhe i shisja. Para se të çmontoja motorin, doja ta shihja më parë të montuar. Duke e pasur parasysh se si ishte motori në fillim, mund ta rimontoja. Kjo e shpjegon me dy fjalë planin e jashtëzakonshëm të metodës së studimit biblik. Ne do të fillojmë me një libër të Biblës, si model të studimit. Në fillim, do të vëmë lentet e mëdha për të përfutur një pamje të qartë të tablosë së përgjithshme. Pastaj do ta veçojmë dhe do të shohim si me mikroskop copëzat, për të mësuar se si lidhen në tërësi.

Do të nisim me një libër të Biblës, do të kalojmë në kapitujt specifikë, pastaj në paragrafët, vargjet, fjalitë e në fund fjalët. Libri model do të jetë Ungjilli sipas Gjonit, sidomos kapitujt 3 dhe 4. Sigurisht që do të kalojmë edhe në pasazhe të tjera, por këta dy do të jenë në qendër të vëmendjes.

Kam zgjedhur ungjillin sipas Gjonit, sepse besoj se është i lehtë për t'u mësuar dhe i përshtatshëm për këtë lloj studimi. Duket sikur apostulli kishte në mendje studimin e Biblës kur e ka shkruar librin.

Ja si do të vazhdojmë më tej:

Skica: Do të të mësoj si të formosh disa skica, që synojnë për të kapur atë që do të mësosh gjatë studimit. Këto skica nuk përbëjnë lëndën përfundimtare, por janë shënime përgatitore që synojnë mbledhjen e të dhënave, një mjet i përshtatshëm për të regjistruar të dhënat që

mbledh gjatë procesit të studimit biblik. Skicat do të bëhen burimi yt i të dhënave për përgatitjen e përmbledhjes përfundimtare të lëndës, pasi ta kesh shkruar e organizuar atë.

Skica e parë është një Skicë Titull, që të aftëson ta organizosh dhe ta mbash në kontekst atë që mëson. Fillon me tablonë e përgjithshme dhe pastaj në hollësitë e mëposhtme:

Libri

Kapitujt

Paragrafët

Vargjet

Shprehjet

Fjalët

Skica e titujve do të të shtyjë që të mbash tablonë e madhe para vetes, ndërsa merresh me hollësitë. Pas kësaj skice, do të kalojmë tre hapat bazë të studimit të Biblës. Ndërsa kalojmë përmes këtyre hapave, do të paraqes një skicë të re në çdo hap, që të organizosh më mirë mbledhjen paraprake të të dhënave, që t'i kesh në disponim kur të krijosh skicën e fundit. Tre hapat kryesorë të studimit biblik janë:

Vëreje: Ky hap të mëson parimin e vëzhgimit, që për një pjesë të bësh pyetjen “Çfarë shikoj këtu?”. Synimi është të mësosh të kuptosh saktësisht se çfarë thotë pasazhi, të shikosh përtej sipërfaqes dhe të zbulosh të vërteta më të thella që janë përfshirë, por që shpesh nuk vihen re në leximet e sipërfaqshme.

Kuptoje: Ky hap mëson parimin e interpretimit, ku bëjmë pyetjen se çfarë do të thotë dhe nuk duhet vetëm që të jemi të sigurt se e shohim gjithçka që thuhet, por edhe ta kuptojmë.

Zbatoje: Kjo është shprehja ime për zbatimin. Me këtë hap, ne arrijmë synimin përfundimtar të studimit biblik dhe pyesim: “Çfarë kuptimi ka për mua?”, ose më saktë: “Si zbatohet kjo për mua?”. Duhet ta dish çfarë kuptimi ka një pjesë dhe si zbatohet para se ta përshtatësh në jetën tënde. Ky zbatim është dhe qëllimi i gjithë procesit, jo thjesht ta mësosh, por edhe ta *zbatosh*.

Ushtrim, ushtrim, ushtrim.

Një i ri po nxitonte rrugëve të Nju Jorkut dhe me sa dukej kishte humbur rrugën. Kur iu afrua një qosheje, një taksi ndaloi dhe nga ajo doli i famshmi Artur Rubenshtajn. Nga dëshpërimi i riu nuk e njohu pianistin e madh, por iu afrua me vrap dhe e pyeti: “Zotëri, më trego

se si të shkoj në Karnegi Holl?” Rubenshtajni u përgjigj: “Po, vetëm me ushtrim, ushtrim, ushtrim”.

Ushtrimi është edhe çelësi i studimit të Biblës, sepse nuk mund ta arrish atë pa mund. Metoda ime studimore nuk është e ndërlikuar ose e vështirë për t’u kuptuar, por kërkon punë. Për mua, kjo punë është magjepsëse dhe procesi i zbulimit është shpërblimi, sepse ky zbulim i të dhënave të reja është si të zgjidhësh një mister.

Bukuria e kësaj metode është se nuk kërkon prej teje asnjë kërkesë specifike kohore. Sa më shumë punë të investosh, aq më të mëdha do të jenë rezultatet. Do të arrish atë që ke investuar.

Ti do të përfitosh nga tridhjetë minuta deri në tri orë studimi dhe përfitimet do të jenë në përpjetësim me investimin e kohës. Mendo për studimin biblik në këtë mënyrë. Nuk është një kurs akademik që e bën një herë dhe pastaj s’ke më punë me të. Ajo që do të mësosh është një mënyrë studimi, që do të mund ta përdorësh për gjithë jetën, sa herë që të hapësh Biblën. Është një metodë e thjeshtë dhe e organizuar për të mësuar të vërtetën e Perëndisë, që ta përdorësh për gjithë jetën. Pra, ky libër do të të paraqesë metodën dhe pastaj mund ta zbatosh në praktikë.

Detyrë

1. Lexo Ps. 19:7-11 dhe përmend tri arsye pse studimi i Biblës të sjell dobi.
2. Lexo tre herë Gjoni 3 dhe 4.

2

SI TË SHOHËH TABLONË E GJERË?

Si të bësh një skicë përmbledhëse?

Me siguri ke parë sekuenca të habitshme në televizor, të ci lat e tregojnë gjithë botën nga hapësira e jashtme, pastaj kamera afrohet. Ndërsa bota afrohet, Amerika e Veriut mbush ekranin e pastaj Shtetet e Bashkuara e Anglia. Kamera lëviz akoma derisa shikoni ndërtesat e largëta të qytetit dhe afrohet derisa mund të shikoni veturat që ecin nëpër rrugë dhe njerëzit nëpër trotuare. Kamera fokusohet pas një ndërtese të veçantë, një dritareje dhe pastaj brenda saj. Vazhdon të lëvizë e fokusohet tek një tryezë pune, pastaj tek një dokument që qëndron në atë tryezë, më pas afrohet dhe ndalon, duke bërë të mundur të lexosh fjalët e dokumentit.

Është e habitshme për mua se si grafiqet më të përparuara kompjuterike na japin një fokus të vetëm, që na çojnë nga hapësira e thellë në atë hapësirën te dokumenti që ndodhet në tryezë. Por kjo ilustron procesin që do të nisim në këtë kapitull. Do të fillojmë me “hapësirën e jashtme”. Pra, në këtë kapitull, kamera jonë do të fokusohet te tabloja e gjerë, pastaj do t'i afrohet më tepër asaj. Me vazhdimin e librit, do të afrohem gjithnjë e më shumë.

Skica përmbledhëse

Ne do ta shohim tablonë e gjerë jo me anë të një kamere, por me anë të një skice, që do ta quajmë “Skica Përmbledhëse”. Për të krijuar një ide rreth vlerës së skicës përmbledhëse, shiko ilustrimin e mëposhtëm.

Ti po bëhesh gati të shkosh në shtrat pas një dite të vështirë, kur, papritur, bie telefoni. Është vajza jote që merr nga konvikti i shkollës. Pasi bisedon për disa çaste, ajo shpjegon qëllimin e telefonatës. “Baba, – thotë ajo, – kam folur me shoqen e dhomës për gjërat shpirtërore,

por ajo e ka të vështirë ta kuptojë ringjalljen e Jezusit. A mund të më japësh disa pasazhe të Biblës që t'i diskutoj me të?”

Sa pasazhe mund t'i japësh asaj në atë çast? Nëse përgjigjesh “vetëm disa prej tyre”, ose “asnjë”, do ta shohësh se Skica Titull do të jetë mjet mjaft i dobishëm për ta zgjidhur këtë çështje.

Skica përmbledhëse do të të ndihmojë që të mbash mend atë që ndodhet në një kapitull të caktuar të një libri të caktuar të Biblës. Përgatitja dhe studimi i skicës do ta fiksojë këtë lloj njohjeje në mendjen tënde, pa përpjekjen e veçantë të të mësuarit përmendësh. Përveç të zbuluarit të të gjithë librit me një vështrim të vetëm, skica do të të japë temën e përgjithshme të librit. Do të sigurojë një farë thurime, në të cilën dredhat e studimit dhe kërkimit mund të thuren, ndërsa rrit njohjen. Skica përmbledhëse e bën një libër biblik më të lehtë për t'u mbajtur mend dhe për t'u mësuar.

Siç mund ta dish, në përkthimet e sotme të Biblës, mund ta gesh këtë informacion lehtësisht, pa përpiluar një skicë përmbledhëse. Shumë përkthime tani i ndajnë kapitujt e Biblës në paragrafë, me nëntituj, që të japin përmbajtjen thelbësore të këtij paragrafi. Ti mund të habitesh se pse duhet të shqetësohesh me një skicë, meqenëse ky informacion është tashmë i disponueshëm. Tani më duhet të them se këto skica përmbledhëse janë fakultative për metodën time të studimit biblik. Nëse koha jote e studimit të Biblës është mjaft e kufizuar ose synimi yt është vetëm studimi personal dhe jo mësimi, mund të preferosh ta anashkalosh procesin e Skicës Përmbledhëse. Thelbi i metodës sime fillon me fazën e vëzhgimit.

Siç e thashë më lart, skicimi do ta sjellë përmbajtjen e kapitujve në mendje dhe do të të fusë brenda përmbajtjes. Por, nëse nuk je në gjendje të bësh Skicat Përmbledhëse, mund të vendosësh t'i anashkalosh dhe të kalosh drejt e te hapi i vëzhgimit.

Përgatitja e skicës përmbledhëse

Para se të bësh diçka tjetër, të nxis të ndalosh dhe të kalosh një çast në lutje. Duhet ta fillosh çdo studim të Biblës, duke i kërkuar Zotit udhëheqje dhe urtësi. Ja, si mund të lutesh: “Hapmi sytë që të shoh, të mësoj gjërat e mrekullueshme nga Fjala jote dhe të kem dëshirë t'i zbatoj”.

Hapi 1: lexo librin. Siç e thashë në kapitullin e mëparshëm, do të përdorim Ungjillin sipas Gjonit si model studimi, duke punuar me

kapitullin 3 e 4 për të mësuar metodën time të studimit biblik dhe për të përgatitur skicat. Hapi i parë para përgatitjes së një skice është të njohësh lëndën.

Para se të fillosh me skicën, duhet të lexosh Ungjillin sipas Gjonit së paku dy herë, madje edhe më shumë, nëse ka mundësi. Duhet ta mbarosh të gjithë leximin përnjëherësh, që të ketë kuptim dhe vazhdimësi.

Pse disa lexime? A ke qenë ndonjëherë në një film për herë të dytë dhe je mahnitur se sa ke humbur herën e parë? Herën e parë që shikon një film, ose kur lexon një libër përqendrohesh në tregimin kryesor, në tablonë e gjerë, duke dashur të kuptosh dinamikën e përgjithshme të lëndës. Mund të humbasësh çështje anësore, të tërthorta dhe të stërholluara, ose të dhëna ndihmuese për shkak të përqendrimit me gjithë mendjen pas idesë kryesore. Çdo lexim i mëtejshëm i mbush boshllëqet.

Shtjelluesi i shquar i Biblës, G. Kampbell Morgan, e lexonte një libër 30 herë para se të niste studimin e tij. Nëse mund ta lexosh ungjillin sipas Gjonit të paktën një të dhjetën e kësaj mase, do të jesh në rrugë të mbarë drejt studimit që dua të të drejtoj.

Gjatë leximit të parë, kërko qëllimin e shpallur të librit, që mund të gjendet kudo në të, afër hyrjes, në mes ose në fund. Në ungjillin sipas Gjonit e gjejmë qëllimin e shpallur në kapitullin 20:31: “Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Mesia, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, të keni jetën në emër të tij”. Gjoni e bën të lehtë për ne, duke na e shpallur qëllimin e tij thjesht dhe qartë. Ai e shkroi këtë libër për të bindur njerëzit se Jezusi është Mesia.

Në leximin e dytë, kërko fjali të përsëritura. P.sh; Mateu përdor shpesh fjalinë “Pasi Jezusi kishte kryer”. Te Zanafilla, shpesh gjendet fjalia “Ja, tregimi i...”, fjali të përsëritura këto që të ndihmojnë të kuptosh zhvillimin e qëllimit të librit.

Në leximet e mëtejshme, shiko për ndarjet kryesore të librit. Librat e Biblës mund të ndahen në pjesë, ku secila ruan fokusin e vet. Shpesh këto pjesë bashkohen në një temë të përgjithshme, pasi janë paralele me njëra-tjetrën. Ato janë të gjitha të të njëjtit lloj. Për shembull, librat e 1 dhe 2 Samuelit kanë pjesë rreth personave të ndryshëm, Samuelin, Saulin dhe Davidin. Këta libra janë organizuar sipas temave biografike. Pjesët e mëdha të Daljes (Eksodit) janë të organizuara sipas gjeografisë, Izraeli në Egjipt, në Sinai dhe në Shkretëtirë. Njëmbëdhjetë kapitujt e Zanafillës organizohen sipas ngjarjeve kronologjike.

Zbulimi i këtyre temave nuk është aq i vështirë sa mund të të duket. Në fakt, çdo libër në Bibël organizohet sipas njërës prej pesë temave të mëposhtme:

1. Personave (1 dhe 2 Samuelit, 1 dhe 2 Mbretërve, Zanafilla 2-50)
2. Vendeve (Veprat, Jozueu)
3. Ngjarjeve (Ungjijtë, Zanafilla 1-11)
4. Ideve (Romakëve, Fjalët e Urta)
5. Kohës (Luka, Zbulesa)

Hapi 2: Lexo rreth librit: Pastaj rekomandoj që të lexosh lëndën prezantuese tek ungjilli sipas Gjonit nga një studim i mirë biblik. Mund të habitesh se pse nuk të sugjeroj të fillosh me studimin biblik, sepse në fund të fundit mund të mbledhësh gjithçka që të sugjerova të kërkoje në hapin 1 nga një studim biblik. Akoma mendoj se, sa më shumë të zbulosh drejtpërdrejt nga Shkrimi, aq më mirë do të rritesh, dhe sot ka studime biblike me bollëk, të botuara për çdo qëllim dhe nevojë dhe është marrëzi të mos shfrytëzohen lëndët e shkëlqyeshme që disponohen. Studimet biblike do të miratojnë ose korrigjojnë kërkimin tënd të Biblës dhe sigurojnë të dhëna të tjera të dobishme. Ja, çfarë mund të mbledhësh nga një studim biblik:

- Një vijë kohore të librit
- Një hyrje ndaj librit
- Statistikat jetike të librit, duke përfshirë qëllimin, autorin, personat të cilëve u është drejtuar, koha kur është shkruar, mjedisi, vargjet kyçe, vendet kyçe dhe njerëzit kyç e tipare të tjera të veçanta.
- Temat kryesore të librit
- Një hartë që tregon vendndodhjet kryesore të ngjarjeve të librit

Përveç studimeve biblike, shumë burime të tjera të shkëlqyera biblike janë të disponueshme si në internet, ashtu edhe në programe kompjuterike. Unë do të flas për dobitë individuale të këtyre burimeve në një kapitull të mëvonshëm, por për momentin mjafton të them se shumë prej tyre do të të japin informacionin që përmendet më lart dhe në një studim biblik. E rëndësishme është që këto burime të përdoren

që të fitosh njohje dhe jo të shërbejnë si një patericë për t'u mbështetur ose si një burim për ta përdorur, sepse nuk ke futur në kokë njohjen e nevojshme.

Fillimi i skicës përmbledhëse

Pasi ta kesh lexuar disa herë librin e Jozueut dhe pasi të jesh njohur mirë me temën, ndarjet dhe sfondin e librit, je gati të nisësh me skicën e parë. Mund të përdorësh çdo metodë që do për të krijuar skicën. Mund ta përpilosh me dorë, me letër dhe laps ose në kompjuter. Nëse nuk e përdor kompjuterin dhe nuk beson në aftësitë e tua vizatuese do të gjesh të shtypura në Shtojcën C skica boshe, të cilat mund t'i fotokopjosh dhe t'i zmadhosh sipas madhësisë së letrës që ke.

Fillo me një fletë format A4 të kthyer horizontalisht. Vendose emrin e skicës në krye (*për shembull, skica përmbledhëse: Gjoni 1-6*) dhe poshtë titullit, rreth 3 cm nga maja e faqes, bëj një vijë të drejtë horizontale nga hapësira anësore në të djathtë. Përmes faqes bëj një vijë të dytë horizontale rreth 1 cm, paralele me të parën. Pastaj një vizë të tretë horizontale përmes faqes. Këto viza do t'u përshtaten numrave dhe titujve të kapitujve, gjë që do ta shpjegoj më poshtë.

Tani vijat vertikale. Duhet një kolonë vertikale në të majtë për të etiketuar dhe identifikuar atë që po skicon (kapituj, tituj kapitujsh dhe paragrafësh). Këta elementë do t'i shpjegoj më poshtë, por po i paraqes tani që të lësh një kolonë për to. Atëherë, meqenëse po skicojmë gjashtë kapitujt e parë të ungjillit sipas Gjonit, të duhen gjashtë kolona të tjera me të njëjtën gjerësi. Bëj vizat vertikale ashtu si duhet.

Duke skicuar vetëm gjashtë kapituj, do t'i kesh të njëmbëdhjetë kolonat me gjerësi 29 cm. Shpesh, do të duhet të shtosh faqe horizontalisht, që të kesh vend edhe për kapituj të tjerë. Për shembull, Ungjilli sipas Gjonit ka 21 kapituj dhe, që kolonat të kenë secila gjerësinë minimale prej rreth 3 cm, do të të nevojiteshin dy fleta letre, që të kesh hapësirë të mjaftueshme horizontale për kaq kapituj.

Pasi bëtë skicën, le ta plotësojmë.

Hapi 1: Titujt e kapitujve: Së pari duhet të merresh me “kapitujt”, që do të shkruash në kolonën e parë, në hapësirën e ngushtë midis dy vizave të sipërme horizontale. Pastaj midis numëro kapitujt 1-6, mes të njëjtave vijave horizontale, shkruaj “Titujt e kapitujve”. Midis po këtyre vijave horizontale shkruaj në krye të çdo kolone titullin e secilit kapitull.

Titulli i Skicës							
Kapitujt	1	2	3	4	5	6	7
Titujt e kapitujve							

Po prit pak, mund të thuash ti, këta kapituj nuk kanë tituj. Ashtu është, duhet t'ua vësh ti. Por, para se të fillosh, duhet të marrësh një vendim që varet nga ajo që shpreson të përfitosh nga libri. Nëse interesohesh më shumë për përmbajtjen bazë të librit, do t'i titullosh në atë mënyrë. Nëse interesohesh më shumë për kuptimin ose teologjinë e librit, do të jenë titujt e tu që do ta pasqyrojnë këtë fokus. Për shembull, nëse fokusi është përmbajtja, mund të zgjedhësh si titull për Gjoni 11 “Ringjallja e Lazarit”, nëse është kuptimi ose teologjia, mund të zgjedhësh “Pushteti i Krishtit të vdekja”. Në çdo rast, ideja është po ajo, që të kesh një titull që e përmbledh ngjarjen ose temën kryesore të kapitullit, diçka që do të të ndihmojë të mbash mend përmbajtjen kryesore të kapitullit.

Në shumë botime të Biblës, botuesi ka siguruar tituj për kapitujt, por, nëse do të fitosh mjeshtëri me përmbajtjen, të nxis t'i shpërfillësh këta tituj kapitujsh (ose më mirë të them, puno nga një variant bible që nuk i ka ato) dhe të formulosh titujt e tu. Të vet-ushtuarit është një pjesë e rëndësishme e procesit të të njohurit me përmbajtjen e Biblës.

Dua të theksoj edhe diçka tjetër para se të fillosh. Kujto se autorët nuk i kanë vënë vetë ndarjet e kapitujve në Bibël, kanë shkruar në një rrjedhë të vazhdueshme fjalish, pa ndërprerje. Më vonë, ekspertët i shtuan ndërprerjet për lehtësim dhe qartësim studimi. Pjesa më e madhe e këtyre ndarjeve të kapitullit bie në vendin e duhur, por një pjesë jo. Prandaj, në studimin tënd, mund t'i rregullosh lirisht ndërprerjet në organizimin e lëndës në një mënyrë të volitshme për ty. Mund të ndiesh herë pas here nevojën të sjellësh disa vargje nga një kapitull i mëparshëm, ose të vësh një ose dy vargje në vargun pasues. Mos ngurro, sepse s'po e përdhos Fjalën ndërsa bën këtë. Kur më vijnë në mendje tituj specifikë të kapitullit, e kuptoj menjëherë se ku e kanë vendin në libër, në lidhje me titujt e tjerë. Titulli nuk më jep vetëm *përmbajtje* specifike, por edhe një *kontekst* specifik, sepse titulli im e dallon qartë atë kapitull nga të tjerët në libër. Mendoji titujt e tu të

kapitullit si doreza që mund t'i përdorësh për të depërtuar në një libër për të nxjerrë përmbajtjen e një kapitulli të caktuar. Është mirë që titujt e kapitullit të jenë të shkurtër, që të mbahen mend lehtë.

Nëse ke dhunti për humor, mos ngurro ta përdorësh në titullimin e kapitujve të tu. Një prej studentëve të mi e titulloi Gjoni 4 “Burim, burim”, një lojë e mençur fjalësh e bazuar në dy ngjarje kryesore të kapitullit: gruaja te *burimi* dhe djali i nëpunësit të mbretit që u *shërua*. Një student tjetër e titulloi Gjoni 9 “I verbri shikon më mirë se farisenjtë”, duke theksuar idenë se farisenjve, megjithë përgatitjen e tyre teologjike, u mungonte njohuria shpirtërore e të verbrit të shëruar. Ji krijues, titujt krijues dhe humori janë mjete të mira për mësimin përmendësh.

Hapi 2: Titujt e paragrafit: Pas titullimit të kapitujve kalojmë në atë të çdo paragrafi, brenda çdo kapitulli. Këta tituj paragrafësh i plotësojnë kolonat nën titujt e kapitullit. Jo çdo botim i Biblës përdor formën e paragrafit dhe është e qartë se për këtë ushtrim, do të të nevojitet ajo që e përdor atë.

Ki parasysh se edhe ato përkthime që i përdorin paragrafët nuk i ndajnë kapitujt e tyre në paragrafë në të njëjtën mënyrë. Ndarjet në paragrafë ndryshojnë nga një përkthim në tjetrin. Për qëllimin tonë, kjo nuk ka rëndësi. Faktikisht, ashtu si me kapitujt, mund të bësh lirisht ndarjet e tua të paragrafëve, nëse kanë më shumë kuptim se sa ato në biblën tënde. Paragrafët e tu duhet të jenë të shkurtër dhe me vend, nuk duhet të kalojnë në asnjë hollësi. Ndërsa fillon, mund të të nevojiten katër a gjashtë fjalë në titullin e paragrafit tuaj, sepse të mungon besimi që ta ruash në mendje një pjesë të mirë. Por, ndërsa studion dhe mëson nuk mund të të duhen më shumë se dy ose tre fjalë për të të nxitur kujtesën. I gjithë qëllimi i titullimit të paragrafëve është nxitja e kujtesës, që të hapen të gjitha të dhënat që di rreth atij paragrafi. Te çdo titull paragrafi, duhet të listosh vargjet e përfshira në paragrafin tënd.

Që t'ju tregoj se si funksionon procesi, le të shohim te Gjoni 1. Ndërsa punojmë me këtë ushtrim, mund të përmendësh skicën shoqëruese që tregon të gjithë titujt e paragrafit tim për këtë kapitull. Titulli im për kapitullin 1 është “Jezusi pranohet”. Ky titull kapitulli funksionon mirë për mua se vendos një temë, që e përcjell përmes titujve të paragrafit. Duke lexuar do ta kuptosh atë që dua të them.

Paragrafi i parë te Gjoni 1 përfshin vargjet 1-5. Në atë paragraf, Gjoni e prezanton Jezusin si Perëndia që kishte ekzistuar nga përjetësia

dhe që zbulohet si Fjala, që është krijuesi i gjithçkaje që ekziston. Titulli im për atë paragraf është “Pranuar nga Gjoni”, ndërsa për vargjet 9-13, titulli im është “Pranuar nga ne” dhe për vargjet nga 14-18 “Pranuar nga lavdia e tij”. Mund të shohësh edhe titujt e tjerë në skicën ilustruese për një ide më të qartë. Të gjithë titujt e paragrafit tim pasqyrojnë temën që kam zbuluar në kapitull dhe që kam shpallur në titullin e kapitullit “Jezusi pranohet”.

Kjo lloj përsëritjeje e vazhdueshme tematike është ndihmesë e mrekullueshme e të mësuarit përmendësh. Tema “pranuar” shfaqet në çdo krye paragrafi, duke i dhënë kujtesës një shtytje fillestare dhe duke e mbajtur në rrugën e duhur. Është si të bësh një gjerdan. Duke përdorur fjalën “pranuar” si gjerdan, mund t’i shtoj kujtesës sime përmbajtjen e paragrafëve, margaritar pas margaritari, pranuar si fjala, pranuar nga Gjoni, pranuar nga ne, pranuar nga lavdia e tij, etj..

Megjithëse kjo formë është e volitshme për mua, mund të mos jetë për ty. Jo çdo mendje funksionon njësoj. Rëndësi ka që të krijosh tituj paragrafësh që të nxisin kujtesën, mund ta kthesh anasjelltas gjithë renditjen e kësaj skice. Disa e bëjnë këtë, pasi kanë zbuluar se mund të kuptojnë temën e një kapitulli dhe të nxjerrin një titull më të mirë, nëse fillojnë me paragrafët, të cilët kombinohen për të sugjeruar një titull kapitulli. Duhet të bësh atë që të duket më e lehtë dhe e dobishme, atë që të ndihmon të ruash të dhënat në kujtesën tënde.

Për të shmangur konfuzionin, do të të them se nuk gjej gjithmonë një temë të saktë dhe plotësisht të unifikuar, që do të më japë një gjerdan për margaritarët e paragrafit tim. Ndonjëherë temat e kapitullit janë aq të shumëllojshme, sa nuk mund të unifikohen lehtë. Kapitulli vijues i Gjonit e ilustron qartë këtë. Në pjesën e parë të kapitullit, ne shohim që Jezusi e kthen ujin në verë në dasmën e Kanës. Në pjesën e dytë e shohim duke pastruar tempullin. Po të skicoja në bazë të teologjisë, në vend të ngjarjeve, mund ta unifikoja këtë kapitull me një titull të tillë si “Jezusi tregon autoritetin e tij”. Ai e tregoi autoritetin e tij te natyra, nëpërmjet mrekullive dhe te njerëzit kur pastroi tempullin, por, meqë po skicoj me anë të ngjarjeve, duhet t’i përmbahem fort tregimit, ndaj formulova këtë titull “Vera e dasmës dhe tempulli i pastruar”, i cili mund të mos jetë i zgjuar ose krijues, por tregon se titulli nuk ka pse të jetë gjithmonë imagjinar ose konçiz, mjafton që të shërbejë për të të nxitur kujtesën.

Hapi 3: Fjalët, vargjet kryesore dhe lënda në sfond. Në pjesën e poshtme të Skicës Përmbledhëse hiq një vijë horizontale rreth 2 cm,

përmes secilës prej kolonave të tua vertikale. Kjo vijë do të krijojë një hapësirë në fund të çdo kolone, në të cilën mund të shkruash dy gjëra: vargun dhe fjalën kryesore të kapitullit. Vargu kryesor duhet të jetë më afër përkufizimit ose përmbledhjes së temës së kapitullit, ndërsa fjala mund të jetë nga ai varg, ose nga një që përshkruan më mirë temën.

Për shembull, vargu kryesor të 1 Gjonit mund të jetë vargu 1, në të cilin Jezusi pranohet si identifikim me Fjalën e Perëndisë. Pjesa tjetër e kapitullit e përkufizon dhe e mbron këtë pohim. Fjala kryesore për kapitullin do të ishte “pranuar”. Për një shembull se si duken fjalët dhe vargjet kryesore në një Skicë Përmbledhëse, shih Skicat Kryesore në Shtojcën B. Vargjet dhe fjalët kryesore janë thjesht një ndihmesë shtesë për të përforcuar temën në mendjen tënde dhe për ta mbajtur më mirë në kujtesë. Është pikëçuditësja në fund të fjalisë, kokrra e qershisë në majë të akullores.

Pas plotësimit të skicës përmbledhëse do ta kesh më të lehtë të shtosh të dhëna të tjera rreth librit. Gjej një hapësirë të zbrazët diku në skicë, po të jetë e nevojshme edhe nga mbrapa dhe shto si më poshtë:

Autori

Data kur është shkruar libri

Ku është shkruar

Vargu kryesor

Fjala kryesore

Mjedisi historik

Mjedisi gjeografik

Çdo informacion tjetër që mund të jetë i dobishëm dhe interesant

I gjithë ky informacion është i disponueshëm në manualë bibliکہ, fjalorë bibliکہ, studime biblike ose komentare bibliکہ. Gjendet edhe në programe biblike kompjuterike si iLumina Gold, ose në faqe interneti të tilla si Biblegateway.com.

Detyrë

1. Lexo ungjillin sipas Gjonit
2. Lexo Gjoni 1-6, së paku tri herë
3. Formulo Skicën tënde Përmbledhëse sipas udhëzimeve në këtë kapitull.

HAPI I PARË

Si ta "Shohësh"

Udhëzues për vëzhgimin

3

BËJ PYETJET E DUHURA

Të mësosh çfarë të kërkosh

Në fillimet e shërbesës sime me Campus Crusade for Christ (Instituti “Jeta e Re”), u caktova të shërbeja në Argjentinë. Imagjinoni befasimin tim kur zbulova se sporti i tyre i preferuar nuk është futbolla amerikan ose basketbolla, por futbolla. Herën e parë që ndoqa një lojë futbolla, u hutova krejtësisht. Nuk kisha asnjë ide se çfarë po ndodhte. Nuk i njihja fare rregullat, strategjinë, nuk dija ç’do të ndodhte në fushë, por, pasi pashë disa ndeshje dhe dëgjova shpjegimet, mësova rregullat, hollësitë e lëvizjeve të lojtarëve dhe strategjinë e tyre. Fillova t’i parashikoja lojërat dhe madje t’u jepja këshilla lojtarëve dhe arbitrave. Tani dija çfarë të prisja dhe kjo njohje e rriti vlerësimin dhe kënaqësinë e lojës.

E njëjta gjë vlen për studimin biblik. Nëse nuk mëson disa nga aspektet bazë të librit, nuk do të dish çfarë të presësh. Libri do të të duket konfuz dhe monoton, sikur thjesht po e lexon nga ndjenja e detyrës, ose si një burim rastësor frymëzimi, por, kur të depërtosh në thellësinë e fjalëve të Biblës, do të të shpalosen tiparet e shumta të zbulesës së Perëndisë. Për këtë arsye ka rëndësi të kultivosh një metodë të tillë vëzhguese, që nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë të të ndihmojë të kuptosh atë që Perëndia do të të zbulojë.

Vëzhgimi të ndihmon të zbulosh se çfarë ka përtej sipërfaqes. Si ilustrim, FBI-ja i përdor filmat përgatitorë për t’u mësuar agjentëve artin e vëzhgimit. Një film zgjat tre minuta dhe paraqet një vjedhje në tren, e një listë me më se 100 pyetje, që vënë në provë vëzhgimet e agjentëve gjatë shikimit të filmit për herë të parë.

Në listë përfshihen pyetje të tilla si “A ishte personi mëngjërash?” “Ç’ndodhej në xhepin e pasëm?” “A kishte orë gruaja?” e kështu me radhë. Unë njoh një profesor seminari që e shfaq këtë film gjatë orës së metodave të studimit biblik dhe arrin mesatarisht 35 përgjigje të sakta

për më shumë se 100 pyetje. Por një vit, kursin e profesorit e zhvilloi një ish-agjent i FBI-së, i cili megjithëse nuk e kishte parë kurrë këtë film përgatitor, iu përgjigj saktësisht të gjitha pyetjeve. Ku qëndronte çelësi? Ai e dinte ç'do të ndodhte.

Kur nuk di se çfarë të shikosh, nuk arrin rezultatin që kërkohet. Është si në rastin e dëshmimit. Njerëzit që nuk dinë si të dëshmojnë, zakonisht nuk dëshmojnë. Ata që nuk dinë si të depërtojnë në vargjet e Biblës, zakonisht heqin dorë nga kërkimi, pasi nuk e kuptojnë atë që lexojnë. Shumë njerëz nuk e kuptojnë artin madhështor, sepse nuk dinë si ta shikojnë një pikturë. Në një muze, një grup vizitorësh kalonin pranë një pikturë duke tundur kokën, duke qeshur ose duke hedhur thumba për të, ndërsa një grup tjetër e vështronte me admirim, duke folur me njëri-tjetrin për kuptimin dhe ndikimin e kryeveprës. Pse këto reagime të ndryshme? Sepse këta të fundit dinë si ta shohin një pikturë, e kuptojnë lëvizjen, formën, gjestet, harmoninë dhe krijimin e një veprë arti, të gjitha elementet që e bëjnë pikturën të komunikojë. Prandaj, ndonjëherë dëgjoj njerëz që thonë se “nuk i gjukojmë ne pikturat, na gjukojnë ato ne”. E njëjta gjë mund të thuhet për ata që shpallin se s'mund të përfitojnë asgjë nga studimi i Biblës. Ky dështim ka të bëjë me përgjegjësinë e tyre.

Pengesë tjetër për një studim të efektshëm të Biblës është moskërkimi. Çestertoni ka thënë: “Jo se krishterimi është vënë në provë dhe është gjetur me të meta, por është gjetur i vështirë dhe s'është vënë në provë”. Kam frikë se kjo e përshkruan mirë qëndrimin e shumë personave ndaj studimit të Biblës. Kur e shohin se nuk e nxjerrin lehtë kuptimin, e mbyllin librin dhe i lënë përpjekjet. Ata nuk arrijnë të shikojnë si duhet, sepse nuk dinë si të shohin. Siç thashë më lart, nuk ka metodë të lehtë, nuk ka rrugëdalje që vjen lehtësisht. Studimi i Biblës kërkon mund, por shpërblimet janë të kënaqshme. Njohja e Perëndisë dhe e fjalës së tij sjellin një jetë të ndryshuar.

Gjashtë pyetjet bazë

Në një studim biblik mësojmë si dhe për çfarë të shohim, duke bërë këto gjashtë pyetje që i mësuam në klasën e tretë:

Kush?

Çfarë?

Kur?

Ku?

Pse?

Si?

Pavarësisht se mund të duken fëminore, gazetarët i bëjnë këto pyetje për çdo tregim që shkruajnë, sepse janë mjete shqyrtuese efektive. Ato e detyrojnë dikë të gërmojë në të gjitha të dhënat përkatëse dhe kam parë se janë po aq efektive për të rrëmuar në kuptimin e Shkrimit të shenjtë. Janë mjetet e mia për të këqyrur nën sipërfaqen e pasazhit, më ndihmojnë të shoh ç'ndodhet në të.

Këto gjashtë pyetje janë baza, pasi sjellin në sipërfaqe të dhëna që mund të mos jenë menjëherë të qarta. Shihi si lopata për të gërmuar thesare të groposura. Ato hetojnë thellë në një pjesë dhe sjellin në sipërfaqe mendime dhe kuptime të fshehura, na ndihmojnë të mësojmë si të shohim. Kur studion një pjesë të caktuar, lopata “Kush?” sjell në sipërfaqe të dhëna të personalitetit që përmenden, kurse lopata “Ku?” na sjell vendet. Le të shohim se si funksionojnë këto pyetje bazë. Për pyetjen “kush”, le të shohim te Gjoni 1:21. Pasi Gjon Pagëzori e mohon se është Mesia, udhëheqësit çifutë pyesin “Po kush je ti atëherë?”. Kësaj pyetjeje duhet t'i përgjigjesh për këtë studim. Po kush është Gjon Pagëzori? Përgjigjet mund t'i gjesh në pasazhe të tjera, duke përfshirë edhe përgjigjen e Gjonit në tri vargjet vijuese.

Pyetja e dytë është “Çfarë?”. Çfarë thuhet në atë pjesë? Çfarë po ndodh? Nëse përmenden njerëz në të, çfarë bënë ata? Çfarë e shkaktoi këtë? Lista e pyetjeve të tilla mund të jetë e gjatë.

Pastaj vjen pyetja “Kur?”. Kur ka ndodhur ngjarja në pjesë? Nëse pasazhi është profetik, kur do të ndodhë apo kur mund të ndodhë? Pyetja “kur?” sjell në qendër të vëmendjes dimensionin e kohës. E gjen ngjarjen historikisht në të kaluarën, ose profetikisht në të ardhmen. Mund të të ndihmojë ta lidhësh një pjesë me tjetrin, kur kohët përputhen, ose kur një pjesë profetike në Dhiatën e Vjetër përputhet me përmbushjen e tij në Dhiatën e Re.

Pyetja e katërt është “Ku?”. Ku ka ndodhur ngjarja e përshkruar? Ku po shkon personazhi i përfshirë? Ku do të ndodhë përmbushja profetike?

Pyetja e pestë “Pse?” të ndihmon të rrëmosh në motivimet dhe arsytet. Pse e tha ai këtë?

Së fundi, pyesim “Si?”. Si ndodhi ngjarja? Si mund të ndodhte? Si do të ndodhë? Pyetja “Si?” ka të bëjë me procesin. Si u ndërtua muri i Jerusalemit në kohën e Nehemisë? Si u kryqëzua Jezusi? Si e shëroi Jezusi të verbrin te Gjoni 9? Pyetja “si?” mund të zbulojë përtej të dhënave faktike. Mund ta përdorësh për të zbuluar emocionin e një pasazhi. Si ndikojnë rrethanat në sjelljen e karaktereve biblike? Nëse

do të ishte i verbri te Gjoni 9, si do të ndiheshe po të të kishte shëruar Krishti?

Përdori lirisht metodat dhe procedurat e tua për t'i bërë këto gjashtë pyetje bazë. Disa studentë pyesin “kush?” për të gjitha vargjet në një kapitull, para se të bëjnë pyetjet vijuese. Të tjerë preferojnë t'i bëjnë të gjashta këto pyetje bazë gjatë procesit të pyetjeve. Vendimi duhet të vendosësh vetë.

Skica vëzhguese

Ndërsa i bën këto gjashtë pyetje bazë, si mund t'i marrësh përgjigjet? Duke përgatitur një Skicë Vëzhguese. Te një letër format A4, shkruaj si titull në krye: “Skica vëzhguese”. Pastaj nën titullin formo vija paralele horizontale rreth 1 cm nga njëra-tjetra për krye kolone dhe ndaje hapësirën e mëposhtme në tri kolona vertikale, duke hequr dy vija të drejta vertikale. Do të të duhet më shumë hapësirë në dy kolonat e dyta, se sa në të parat. Midis vijave horizontale paralele shkruaj “Shkrimi” në kolonën e parë, “Vëzhgime” në të dytën dhe “Pyetje” në të tretën, si në modelin e treguar në Skicën Vëzhguese bosh në Shtojcën C. Tani do të shohim në çdo kolonë të skicës dhe do të kalojmë përmes procesit të plotësimit të saj.

Kolona 1: Shkrimi: Kolona e parë i përket Shkrimit. Mund të vendosësh Shkrimin në një nga dy mënyrat: referimin (p.sh “Gjoni 1:10), ose gjithë tekstin e vargut. Nëse po e përpilon skicën tënde me dorë, referimi i thjeshtë është më i lehtë, por unë preferoj ta kem gjithë vargun para vetes. Nëse po punon në kompjuter, sugjeroj të vësh gjithë vargun. Është e lehtë ta kopjosh nga programe biblike ose nga një burim interneti dhe t'ia bashkëngjisësh kolonës sate.

Kolona 2: Vëzhgimi: Kolona e mesit është zemra e skicës, aty ku shkruan vëzhgimet pas studimit të pasazhit. Ndër shënimet e përfshira kemi vëzhgimet spontane që dalin gjatë leximit, por shumica do të përbëhet nga të dhëna që do të zbulohen ndërsa bën gjashtë pyetjet bazë. Kolona e vëzhgimit është vendi ku vë përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve dhe shfaq rezultatin përfundimtar të studimit tënd vëzhgues.

Kolona 3: Pyetje: Nëse kolona e vëzhgimit është rezultati përfundimtar i studimit tënd, kolona e pyetjeve është procesi. Kolona e shkrimit përmban lëndën e parë, ndërsa ajo e pyetjes është fabrika ku përpunohen të dhënat dhe kolona e vëzhgimit është depo. Sigurisht që pjesa më e madhe e punës bëhet në fabrikë, ndaj ne do të kalojmë njëfarë kohe me kolonën e pyetjeve.

Tani do të të tregoj si t'i përdorësh pyetjet si vegla për të nxjerrë në dritë atë që duhet të kërkosh dhe si ta përdorësh skicën për të lehtësuar procesin dhe të dokumentosh rezultatin. Do të përdorim Gjonin 3, vargun 1-2a si pasazhin nga i cili do të mësojmë. “Midis farisenjve ishte një njeri me emrin Nikodem, një krer i judenjve. Ky erdhi natën të Jezusi”. Ja pasazhi, le të bëjmë pyetjet.

Pyetja 1: Kush? Pyetja e parë është “kush?”, ndaj në kolonën e vëzhgimit, vendos fjalën “kush”. Këtu duhet të jetë përgjigjja e pyetjes. Unë zakonisht shënoj fjalën, e shkruaj me të zezë ose e nënvizoj që të spikasë. Titulli është te hapësirat ku do të dokumentosh përgjigjen ndaj pyetjes “kush?”, pasi të kesh përcaktuar cila është përgjigjja.

Më pas kalo në kolonën e pyetjeve dhe vendos të gjitha pyetjet që të nxit kjo pjesë. Bëje këtë para se të vazhdosh me leximin dhe pastaj do të krahasojmë shënimet.

Pasi ke vënë pyetjet “kush?”, krahasoji ato me të miat: “Kush ishte Nikodemi? Kush ishin farisenjtë? Po udhëheqësit fetarë çifutë? Sipas meje, këto janë pyetjet që dalin nga ky pjesë.

Fillo me të parën: “Kush ishte Nikodemi?” dhe kalo disa çaste për të parë se sa vëzhgime mund të bësh prej saj. Pastaj eja ta krahasojmë përsëri.

Të vazhdojmë? Ja çfarë më tregoi pasazhi në përgjigje të pyetjes “Kush ishte Nikodemi?”. Ishte *njeri*, *farise*, quhej *Nikodem*; ishte *udhëheqës* dhe *jude*. Këto konstatime i nxjerrim nga vargu 1 (sipas vargut 10, ai ishte edhe mësues). Në njëfarë kuptimi, do t'i “njohësh” të gjitha këto gjëra, thjesht duke lexuar fjalinë, por, mbase mund të mos jesh fokusuar te hollësitë. Për shkak të pyetjes “kush?”, ndal për të studiuar e parë më thellë, në vend që thjesht të kalosh përciptazi e ta harrosh më pas. Vëri këto përgjigje në kolonën e vëzhgimit, nën pyetjen “kush?”.

Vëzhgimet që rrodhën nga pyetja “kush?” sollën pyetje të tjera: “Kush ishte farise? Si bëhej dikush farise? Çfarë bënte një farise? Cila është lidhja e një fariseu me një udhëheqës? Ç'arsimim nevojitej? Ç'është një çifut? Ç'është një udhëheqës”. Sigurisht që shumë prej këtyre pyetjeve nuk hyjnë te “kush”, por duhet t'i shkruash të gjitha në kolonën e pyetjeve, ndërsa mendon për to. Do të jenë të dobishme në hapin pasues të studimit, që është interpretimi. Mund të vendosësh t'u përgjigjesh vetëm atyre që janë më të lidhura me studimin, por duhet t'i shkruash të gjitha pyetjet që ke në mendje, sepse ndryshe do t'i harrosh. Vendos më vonë se cilat janë të rëndësishme. Ki parasysh

se këto skica nuk janë produkti yt përfundimtar i studimit, por janë procesi. Ato janë thjesht për të tërhequr vëmendjen.

Pyetja 2: Kur? Shiko përsëri pasazhin tonë model: Gjoni 3:1-2a “Midis farisenjve ishte një njeri me emrin Nikodem, një krer i judenjve. Ky erdhi natën te Jezusi”. Pasazhi i përgjigjet pyetjes “kur?” që në fjalinë e parë: Nikodemi erdhi “natën” te Jezusi. Para se ta zbulojmë këtë, dua të përmend një problem që do të hasësh ndonjëherë. Shpesh ndodh që nuk do të gjesh asgjë për t’iu përgjigjur njëres prej gjashtë pyetjeve interpretuese në një pjesë të caktuar. Në fakt, nëse e lexon Gjoni 3:1-2 nga një përkthim tjetër nga ai i *New Living Translation* (NLT), pyetja “kur?” mund të mos marrë përgjigje në vargun e parë. Për shembull *New American Standard Bible*, nuk na tregon se kur erdhi Nikodemi te Jezusi para vargut 2: “Ky njeri erdhi natën te Jezusi”. Kur në një varg nuk ka asgjë për t’iu përgjigjur njëres nga gjashtë pyetjeve, nuk duhet ta lësh mënjatë pyetjen dhe të kalosh në atë vijuese, por duhet të kalosh në vargun pasues që të shohësh nëse siguron një përgjigje.

Por në variantin e përkthimit NLT, që në vargun e parë e marrim përgjigjen. Nikodemi erdhi “natën” te Jezusi. Pra, nën kolonën tënde të vëzhgimit nën “kur” shkruani “pasi u err”, ose “natën”. Kjo përgjigje ndaj pyetjes sonë “kur?” është intriguuese dhe duket misterioze. Na shtyn të kalojmë menjëherë në pyetjen vijuese “pse?”.

Pyetja 3: Pse? Pse erdhi Nikodemi natën te Jezusi? Përdor imagjinatën, sikur të ishe Nikodemi dhe pyet pse ke ardhur te Jezusi natën dhe jo në dritën e diellit. Shkruaj çdo arsye që të vjen në mendje. Mos u shqetëso, do ta gjesh më vonë cila përgjigje përputhet me të vërtetën, kur të kalosh përmes hapave të interpretimit. Në këtë fazë, e gjithë ideja e ushtrimit është të zhytesh në pjesë. E them përsëri se këto skica nuk janë produkti përfundimtar, por thjesht procesi i punës. Pra, mos ngurro t’i shkruash hamendësimet.

Ja, si mund të mendosh: ta zëmë se je një jude, një farise, një udhëheqës fetar dhe një mësues, pra, një pjesëtar i respektuar i shtresës më të mirë të komunitetit të judenjve.

Pse do të vendosësh të shkosh natën te Jezusi? Ja, disa nga arsyet e mundshme nën hapat e vëzhgimit.

Mundësia e parë është që Nikodemi nuk donte që ta shihte kush. Pse? Mos vallë nga frika e farisenjve, e judenjve apo e udhëheqësve? Apo nga krenaria? Nëse ai ishte një mësues i madh sipas sistemit fetar judaik dhe Jezusi kishte fituar rivalitet, ka mundësi që të njihej si i

zvogëluar në sytë e bashkëmohatarëve të tij, nëse ndonjë prej tyre do ta shihte duke vizituar një kryengritës të tillë të paligjshëm?

Për ç'arsye tjetër do të zgjidhte Nikodemi të takohej me Jezusin pasi të errej? Ndoshta arsyeja nuk është aspak misterioze. Ai mund të ketë qenë mjaft i zënë gjatë ditës. Si mësues dhe udhëheqës fetar, dita e tij mund të ishte e ngjeshur me takime dhe mësim. Mund ta kuptojmë mirë këtë. Ose thjesht donte të fliste vetëm për vetëm me Jezusin për gjëra të tilla që nuk duhet t'i dëgjonte asnjë. Turmat që e rrethonin Jezusin gjatë ditës nuk do ta lejonin një bisedë të tillë private. (Është ironike të mendosh se, nëse ky ishte arsyetimi i tij, plani i tij me siguri dështoi. Përmbajtja e kësaj bisede private është bërë e njohur që prej 2000 vjetësh për gjithë botën).

Le të ndalemi pak dhe të përmbledhim përgjigjet tona në një formë skice:

Pse Nikodemi shkoi te Jezusi pasi u bë natë?

- I. Që askush të mos e shihte
 - A. Për shkak të frikës nga
 1. farisenjtë
 2. udhëheqësit fetarë
 3. judenjtë
 4. mësuesit
 - B. Për shkak të krenarisë
 1. për të mbrojtur reputacionin e mësimit
 2. për shkak të trazirës së tij të paligjshme
- II. Sepse ishte shumë i zënë gjatë ditës
- III. Dëshironte të fliste vetëm për vetëm me Jezusin

Thjesht duke bërë këto tri pyetje, ne krijojmë ide për pasazhin. Në fakt, duke zbuluar mundësi dhe motivime, depërtojmë në brendësi të pasazhit dhe ndiejmë ndikimin e tij. Tani që e ke parë se si funksionon procesi, do të kalojmë më shpejt përmes tri pyetjeve vijuese. Unë do të të jap udhëzime për formulimin e pyetjeve dhe mund të mendosh për përgjigjet, duke përdorur metodat që kemi zbuluar tashmë.

Pyetja 4: Çfarë? Shiko në pasazhin tonë model diçka për të cilën mund të pyesësh “Çfarë?” Unë shoh disa. “Kush ishte farise? Çfarë bënte ai? Cila ishte lidhja e një fariseu me një udhëheqës fetar? Ç’arsimim nevojitej? Kush ishte një mësues në Judenë e shekullit të

parë? Kush është jude? Kush është një udhëheqës? Shkruaji këto pyetje në kolonën e pyetjeve të tua. Ndryshe nga përgjigjet spekuluuese që duhet të japësh kur bën pyetje te motivimet e një personi (si kur pyesni pse erdhi Nikodemi natën), këto kanë përgjigje të qarta. Dhe disa nga përgjigjet nuk do të gjenden me anë të vëzhgimit të thjeshtë, sepse Bibla nuk i shpjegon ato. Kjo do të thotë se përgjigjet do të kenë të bëjnë me interpretimin, që do të zbulojmë në hapin tonë vijues të studimit. Që t'i gjejmë ato, duhet të bëjmë ca kërkime. Prandaj nuk do të merremi me këto pyetje në hapin e vëzhgimit, ato duhet t'i shënosh në kolonën e pyetjeve, që të trajtohen kur të zbulosh interpretimin.

Pyetja 5: Si? Le të shohim në pasazhin tonë biblik, nëse kemi përgjigje për ndonjë nga pyetjet “si”? Pasi u err, një mbrëmje, një udhëheqës fetar çifut me emrin Nikodem, një farise, erdhi për të folur me Jezusin”. Disa pyetje të vijnë në mendje menjëherë. Si bëhej dikush farise? Si aftësohej për të qenë i tillë? Si e njihnte Nikodemi Jezusin? Si e dinte se ku gjendej? Disa prej këtyre pyetjeve janë të hamendshme dhe disa kërkojnë hulumtime për të siguruar përgjigje të qarta. Shkruaji që të trajtohen në hapin e interpretimit.

Pyetja 6: Ku? Ja një rast në të cilin pasazhi ynë nuk i përgjigjet pyetjes “ku”. Siç thashë më lart, do të shohësh shpesh se jo të gjitha pyetjet zbatohen ndaj çdo pasazhi, por ti duhet ta bësh pyetjen. Ajo synon të nxjerrë të dhëna dhe mundohu që të nënvlerësosh ndonjë gjë që paraqet pasazhi. Pra, në vend që ta shmangësh pyetjen, duhet të kalosh në vargjet vijuese, derisa të gjesh atë që merret me pyetjen, ose derisa të plotësosh idenë e pasazhit dhe të shohësh se nuk ka ndonjë përgjigje të mundshme. Nëpërmjet këtij ushtrimi, ti mund të shohësh, si është e mundur të kalojmë orë të tëra, duke rrëmuar në një varg të vetëm. Kjo mund të të duket e pamundur, ose shkurajuese. Sado dëshirë të kesh për ta kaluar gjithë mbrëmjen duke studiuar Biblën, koha jote mund të jetë e kufizuar. Diçka e mirë te metoda që po paraqes këtu është se mund të kalosh aq kohë sa ke në dispozicion. Nëse ke vetëm 15 minuta për çdo mbrëmje, bëj çfarë të mundësh brenda aq minutash. Me kalimin e ditëve do të dish më shumë nga ç’do të dije pa bërë studimin. Kryesorja është të kalosh aq kohë sa ke, qoftë 15, 30, ose 45 minuta.

Ndonjëherë mund të gjesh kohë të disponueshme, jashtë orëve të studimit të rregullt. Mendo se sa shumë prej këtyre pyetjeve mund t’u përgjigjesh gjatë një udhëtimi prej 50 minutash, me avion, pa përmendur kohën që kalon në aeroport, duke pritur thirrjen e personelit të avionit.

Detyrë

1. Duke përdorur kapitullin 1 të librit të Gjonit, formo dhe plotëso një skicë vëzhguese.

4

RRËMO MË THELLË

Të rrëmosh nën sipërfaqe

Një djalë shkon tek i ati dhe e pyet: – Babi, ç'është një vrimë e zezë?

Babai u përgjigj: – Nuk e di, bir.

Pas disa çastesh, djali shkon përsëri dhe e pyet babain: – Baba, ç'është elektriciteti?

Babai mendoi për një çast dhe pastaj u përgjigj: – Nuk mund ta them, bir.

Pas pak, djaloshi kthehet për herë të tretë dhe pyet: – Baba, ç'është graviteti?

– Nuk e di, bir, – u përgjigj sërish babai.

Atëherë djali tha: – Babi, a lodhesh që po të bëj gjithë këto pyetje?

– Jo, bir, sigurisht që jo – u përgjigj i ati. – Si do të mësosh nëse nuk bën pyetje të tilla?

Shpresoj që të mos lodhesh së bëri pyetje të tilla. Në një studim biblik, pyetjet janë me të vërtetë mënyra për të mësuar. Pas shqyrtimit të gjashtë pyetjeve bazë të kapitullit të mëparshëm, ne vetëm sa kemi prekur sipërfaqen.

Tani do të mësojmë si të bëjmë 12 pyetjet e lidhjes, që kanë për qëllim shtimin e një dimensionit tjetër njohjes, duke të ndihmuar të lidhësh një pjesë të Shkrimit me një tjetër. Qëllimi i këtyre pyetjeve është analizimi i mënyrës se si ndërliidhen shprehje, njerëz, vende ose ide të ndryshme me ato të pasazheve të tjera. Nëse nuk e kupton mirë këtë tani, mos u shqetëso. Në këtë kapitull do të shpjegoj dhe tregoj si funksionon kjo.

Do t'i vësh këto vrojtme në kolonën qendrore të skicës sate të vëzhgimit.

Ja, 12 pyetjet e lidhjes:

1. Cilat gjëra janë të ngjashme?
2. Cilat gjëra janë të ndryshme?
3. Ç'gjëra përsëriten?
4. Ka prova të shkakut dhe pasojës?
5. Ka lëvizje nga e përgjithshmja në specifiken?
6. Ka ndonjë përparim?
7. Ç'pyetje apo përgjigje jepen?
8. Ka ndonjë problem dhe zgjidhje?
9. Është domethënëse kohëzgjatja e pasazhit?
10. Ç'fjalë lidhesh përdoren?
11. Ka ndonjë urdhërim?
12. Ka ndonjë premtim?

Pasi të kesh mësuar si të zhvillosh gjashtë pyetje në një kapitull, perspektiva e të ndeshurit me dymbëdhjetë të tjera mund të jetë hutuese, por nuk duhet të ndodhë. Në një pjesë të tillë si Gjoni 3:1-10, mund t'i bësh gjashtë pyetjet e para dhe dymbëdhjetë të tjerat brenda 30 minutash. Sigurisht që mund të kalosh më shumë kohë, nëse ke.

Përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk do të vijnë vetiu. Duhet ta mbash të gatshme mendjen dhe të hapur ndaj krahasimeve, ndryshe nuk mund t'i gjesh, por këto pyetje do të të ndihmojnë që të kalosh përmes procesit. Referoju dymbëdhjetë pyetjeve lidhëse në Shtojcën C.

Tani le t'i kalojmë këto pyetje një nga një, që të shohim se si mund t'i përdorësh si mjete kërkimi për të zbuluar njohjen e Shkrimit. Në kapitullin e ardhshëm do të merremi me një pyetje për të treguar më shumë se si mund ta përdorësh sa më thellë në një pjesë të caktuar.

1. Cilat gjëra janë të ngjashme? Kjo pyetje synon të të ndihmojë që të kërkosh krahasime ndërsa lexon një pjesë. Kujto se njerëzit nuk shohin gjëra në Shkrimet, sepse nuk dinë se si të shikojnë. Këto pyetje i izolojnë ato që duhet t'i shikosh. Nëse kërkon ato që janë të ngjashme, do të mund t'i shohësh më mirë. Ta zëmë se e ke kryer studimin e Gjoni 3 dhe po merresh tani me Gjoni 4. Ndërsa lexon takimin e Jezusit me gruan samaritane, fillon të kërkosh krahasime. Cilat gjëra janë të ngjashme me pasazhet e tjera që ke studiuar te Gjoni 3? Në të dy kapitujt, Krishti kishte mundësi për të dëshmuar, së pari ndaj Nikodemit dhe pastaj ndaj gruas samaritane. Bëj pyetjen e lidhjes: cilat janë ngjashmëritë midis dy takimeve?

Ja përgjigjet që mund të pasojnë:

Të dy takimet ishin personale, vetëm për vetëm.
 Të dy kishin të bënin me persona të interesuar për çështjet e besimit.
 Në të dyja rastet Krishti e drejtoi bisedën në çështjet shpirtërore.
 Në të dyja rastet Krishti u mor me çështjet kryesore.
 Krishti nuk pranoi të anashkalonte çështje dytësore të debatueshme.

Këto ngjashmëri e zgjerojnë njohjen tënde të Krishtit, që e tregoi përkushtimin e tij kur u dha atyre pikërisht atë që duhet të zbulonin, duke ardhur tek ai. Ato tregojnë edhe se, pavarësisht nga ndryshimet në pozitë ose prejardhje, nevojat thelbësore janë po ato. Të gjithë kanë nevojë për Krishtin. Mund t'i përfshish këto dhe vëzhgime të tjera që janë nxitur nga pyetja, në kolonën qendrore të skicës sate të vëzhgimit.

2. *Ç'gjëra janë të ndryshme?* Me këtë pyetje ti kërkon të kundërtën e asaj që paraqesin pyetjet. Nuk kërkon ngjashmëri por kontraste. Kur e zbatojmë këtë pyetje ndaj Gjonit 3 e 4, vëmë re disa ndryshime domethënëse midis Nikodemit dhe gruas samaritane, siç na e tregon skica e mëposhtme:

Ndryshimet midis Nikodemit dhe gruas samaritane

Gjoni 3 (Nikodemi)	Gjoni 4 (gruaja samaritane)
Një burrë	Një grua
Një jude	Një samarian
I shquar nga ana sociale	I veçuar shoqërisht
Vjen natën	Vjen ditën
Përsëri pyet	Vjen me besim
Judaizmi	Feja <i>samaritane</i>
Udhëheqës fetar	Pagan fetar
I turpëruar	I guximshëm

A të befason numri i kontrasteve? A e shikon se këto kontraste i bëjnë këto dy pasazhe paralele, të ngjashme me njëri-tjetrin? Kontrastet na ndihmojnë të kuptojmë pse Gjoni e përshkruan ngjarjen në kap. 4, në

vijim të kap. 3. Dy persona takohen me Krishtin; njëri fetar, me pozitë të lartë shoqërore dhe mjaft i respektuar, tjetri një person i dëbuar nga shoqëria për marrëdhënie kurorëshkelëse. E megjithatë, Krishti i shpërfill të gjitha ndryshimet dhe i trajton njësoj, duke shfaqur interes të madh për të dy dhe duke i drejtuar tek një kuptim më i madh i së vërtetës.

3. *Cilat gjëra përsëriten?* Vazhdimisht, kudo në ungjillin sipas Gjonit, Jezusi përdor fjalinë “Me të vërtetë po ju them”... (në disa përkthime). Kjo përsëritje tregon se Jezusi ishte i interesuar për mposhtjen e dyshimit me të vërtetën. Ai e pohon vazhdimisht të vërtetën absolute të fjalës së tij. Kjo nuk është një e vërtetë, por e vërteta. Shpesh, fjalët, fjalitë ose idetë përsëriten në ndihmë të të mësuarit, ose për të shtuar theksimin. Kërko përsëritje të tilla dhe kur t'i gjesh ato, pyet pse përsëriten. Arsyeja mund të të ndihmojë që të zbulosh një ide që ndryshe do të kishte mbetur e fshehur.

4. *A ka ndonjë provë të shkakut dhe pasojës?* Shkaku dhe pasoja, pra një gjë të çon në një tjetër. Ndonjëherë pasazhet që përmbajnë shkak dhe pasojë nuk të brofin vetiu, por disa fjalë të caktuara do të të japin ndonjë të dhënë: fjalët që lidhin shkakun me pasojën janë *sepse*, *prandaj*, ose *që kur*. Kur përdoret *sepse*, efekti zakonisht vjen para shkakut, si te Gjoni 10:17: “Prandaj Ati më do, sepse unë e lë jetën time që ta marr përsëri”. Pasoja është dashuria e Atit për Jezusin. Shkaku është që Jezusi na do aq shumë sa jep jetën e vet. Mësojmë se dashuria flijuese e Krishtit e bën atë të dashur ndaj Atit. Shkaku dhe pasoja shfaqin marrëdhënie që e pasurojnë njohjen tonë të Shkrimit.

5. *A ka kalim nga e përgjithshmja në specifike?* Ky lloj kalimi ndodh te Shkrimi i Shenjtë. Te Gjoni 1:10 lexojmë për këtë thënie të përgjithshme rreth Krishtit: “Bota u krijua me anë të tij, por bota nuk e njohu”. Pastaj në vargun 11, kemi këtë thënie specifike: “Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan”. Vini re se si thënia e parë e përgjithshme ndërton të dytën specifike. E gjithë bota nuk e njohu Krishtin është parimi i përgjithshëm dhe mohimi i tij prej popullit të vet është rasti specifik i parimit. Çfarë do të thotë për ne? Së pari, Izraeli paraqitet si një miniaturë e qëndrimit ndaj Krishtit, se emri i tij njihet kudo. Së dyti, ne mësojmë nga ngjarje të mëvonshme se ata jashtë Judesë e pranuan Krishtin, ndërsa çifutët qëndruan në mosbesim. Pikërisht ata, të cilëve u ishte dhënë nderi dhe përgjegjësia e sjelljes së Shpëtimtarit në botë nuk arritën të merrnin pjesë në atë shpëtim.

6. *A ka përparime?* Kërko një ide ose një ngjarje që ndërtohet, zhvillohet ose shpaloset. Shpesh përparimi do të kulmojë në një akt ose ide specifike. Për shembull, i gjithë ungjilli sipas Gjonit paraqet një

përparim të tillë. Shërbesa publike e Jezusit filloi dalëngadalë dhe vazhdoi me rritje të dukshme të konfliktit derisa kulmoi në hyrjen ngadhënjyese në Jerusalem, që shënoi Javën e Vuajtjeve, duke kulmuar me kryqëzimin.

Një shembull të përparimit e gjejmë tek Gjoni 4, një pjesë e veçantë tek e cila kemi gjetur informacion të vlefshëm. Në fillim Jezusi kaloi përmes Samarisë dhe ndaloi në Sikar, në pusin e lashtë të Jakobit. Aty takoi një grua që po nxirrte ujë dhe nisi të bisedonte me të, gjë kjo e e nxiti të përballej me mëkatin e saj e ta kthente në besim (te Jezusi). Ajo u thotë miqve të vijnë ta dëgjojnë Jezusin dhe shpejt i gjithë fshati kthehet në besim. Ç'përparim!

7. *Ç'pyetje apo përgjigje jepen?* Pyetjet dhe përgjigjet mbartin shpesh argumente, që kulmojnë në të mësuarit e parimeve të rëndësishme. Pyetjet të nxisin të mendosh, të shqyrtosh çështjet dhe të qëndrosh brenda objektivit. Kur një mësues përpiket të nxisë një argument, do të kërkojë të përdorë pyetje për të nxjerrë përgjigjen e dëshiruar. Pyetjet mund të përdoren edhe për të gjetur përgjigjet që nuk i dimë. Te Gjoni 3:34, Nikodemi e pyet Jezusin “A mund të hyjë ai për së dyti në barkun e nënës së vet dhe të lindë?”. Pyetja i jep mundësi Jezusit që të shpjegojë konceptin biblik të rilindjes dhe jetës së mbretërisë, që është po aq i rëndësishëm për ne sot, sa ç'ishte për Nikodemën.

8. *A ka ndonjë problem dhe zgjidhje?* Problemet dhe zgjidhjet shpesh kapin njohuri domethënëse brenda kuptimit të Shkrimit. Ne gjejmë një shembull të një problemi te Gjoni 2:1-3. Në një dasmë në Kanë, i zoti i dasmës nuk ka më verë, gjë që asokohe ishte e rëndë në Jude. Në vargun 3, nëna e Jezusit ia paraqet atij problemin dhe nga vargu 6-10 paraqitet zgjidhja. Jezusi e kthen ujin në verë, duke ruajtur nderin e dollibashit. Në vargun 11, na jepet arsyeja për këtë zgjidhje: “Kjo shenjë e mrekullueshme në Kana të Galileës ishte shfaqja e parë e lavdisë së Jezusit dhe dishepujt e tij besuan në të”. Problemi çoi zgjidhjen dhe zgjidhja siguroi prezantimin me pushtetin e Krishtit, duke sjellë shumë veta në besim tek ai.

9. *A është zgjatja e pasazhit domethënëse?* Kur fatkeqësia e tsunamit solli në vitin 2005 vdekjen e 150 000 vetave në vendet përreth Oqeanit Indian, ngjarja mbushi për ditë të tëra faqet kryesore të gazetave më të njohura të vendit. Nga ana tjetër, kur presidenti lokal i bankës foli në Klubin e komunitetit të Rotarit, gazeta lokale citoi një fragment të shkurtër të fjalimit të tij. Rëndësia e tregimit përcaktonte hapësirën në dispozicion. I njëjti parim zbatohet ndaj Shkrimit. Autorët

e Biblës e mbushnin hapësirën më të madhe me parimet e ngjarjet më të rëndësishme, duke lënë vetëm disa vargje për më pak të rëndësishmet. Në ungjillin sipas Gjonit, nga 1:29 deri 12 mbulohen ngjarjet gjatë shërbesës trevjeçare të Jezusit, pastaj në kapitullin 13, Gjoni i kushton pesë kapituj Jezusit dhe darkës së fundit me dishepujt e tij, dy kapituj arrestimit, procesit, vdekjes dhe dy kapituj ringjalljes dhe shfaqjeve të tij pas ringjalljes.

A tregon fakti që Gjoni u kushton 12 kapituj 3 vjetëve dhe pesë kapituj një nate që thekson fjalët e fundit drejtuar dishepujve të tij? Këtë mund ta përcaktosh duke i kushtuar vëmendje hapësirës që autori i jep një teme të caktuar. Nëse ai trajton një periudhë të shkurtër kohore me shumë hollësi, ne nxënësit do të bënim mirë të bënim të njëjtën gjë, kërko mirë arsyet e theksimit dhe kalo më shumë kohë duke i shqyrtuar këto pasazhe për të zbuluar kuptimin e tyre. Theksimi i autorit tregon të fokusohesh.

10. Ç’fjalë lidhjeje” përdoren? Të tilla si: *por, që kur dhe nëse, prandaj*, etj. Ne u morëm me disa prej tyre, kur folëm për shkakun dhe pasojën, por këtu vëmë re se këto dhe lidhëza të tjera tregojnë lidhjet midis një ngjarje dhe një tjetre, ose midis një ideje dhe tjetrës. Për shembull, te Gjoni 8:12, Jezusi thotë: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës”. Në këtë pjesë *nëse* lidh dy ide e tregon lidhjen midis tyre. Një ide është të *ndjekësh Jezusin*, tjetra është “*nuk do të ecë në errësirë*”. Ajo *nëse* lidh një ide me tjetrën dhe tregon lidhjen e “të ndjekurit të Jezusit” me fjalën “nuk do të ecë në errësirë”. Duhet të bësh fillimisht të parën që të arrish të dytën. Lidhëzja *nëse* tregon një lidhje varësie të idesë së dytë me të parën.

Kërko *lidhëza kushtëzuese* të tilla si “nëse – atëherë. Thënie “nëse – atëherë” paraqesin kushte specifike për përmbushje. *Nëse* bën gjëra të caktuara, *atëherë* Perëndia do të bëjë disa gjëra të caktuara. Disa nga përkthimet më të reja nuk e përdorin këtë strukturë, por heqin fjalën “atëherë”. Në raste të tilla “atëherë” nënkuptohet shpesh. Për shembull, shikoni te 1 Gjoni 1:9: “Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi”. Lidhëzat janë kritike ndaj kuptimit të pasazhit, sepse tregojnë natyrën e kushtëzuar të premtimit: *Po* të rrëfejmë mëkatet tona, *atëherë* do të na falë. Lidhëzat kushtëzuese tregojnë se premtimi nuk është pa kushte.

Kërko *lidhëza qëllimi* si “me qëllim që”, ose “për shkak se”. Lidhëzat e qëllimit japin arsyen, ose *qëllimin* e një veprimi të caktuar.

Përsëri, strukturat e ndryshme në përkthime të ndryshme bëjnë që disa fjalë të gjenden në disa bibla e jo në të tjera. Ne kemi një lidhëz qëllimi te Filipianëve 3:12: “jo, sikurse t’ia kisha arritur, as, sikurse të isha bërë i përsosur, por — vrapoj që, në ndonjë mënyrë, të mund ta zë, sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit [Jezusi]”.

Pse Pali vazhdon të vrapojë? *Me qëllim që* na tregon: që të fitojë çmimin për të cilin e ka thirrur Krishti.

11. *Ç’urdhërime shikon?* Ji vigjilent për urdhërimet në Bibël, sepse janë të rëndësishme për arsyë të qarta – ato mund të zbatohen për ne sot.

12. *Ç’premtime shikon?* Kërko me kujdes ndonjë premtim të Perëndisë dhe shqyrto ndonjë kusht që mund të lidhet me ta. Megjithëse urdhërimet janë të rëndësishme për arsye praktike, premtimet janë të rëndësishme, sepse janë frymëzuese dhe na japin shpresë.

Detyrë

Bëj vëzhgime nga Gjoni 2 në skicën tënde, duke përdorur 12 pyetjet e lidhjeve të trajtuara në këtë kapitull.

Fjalë domethënëse që gjenden në Pasazhet e Biblës

1. Lidhjet Logjike:

- a. Kontrast. por (Efesianëve 2:4)
megjithëse (Romakëve 1: 21)
shumë më tepër (Romakëve 5:15)
sidoqoftë (Romakëve 5:33 ???)
ende (Romakëve 5:8)
por
kur
përndryshe (Romakëve 11:6)
- b. Krahasim ashtu si edhe (Efesianëve 2:3)
edhe (Efesianëve 1: 11)
porsi (Efesianëve 5:22)
sikurse (Efesianëve 4:32)
kështu (Efesianëve 5:28)
gjithashtu (1 Pjetrit 3:7)
dhe
siç /sepse?
- c. Lidhje reciproke po ashtu ... si (Efesianëve 5:24)
sepse... sikurse edhe (Efesianëve 5:23)
kështu... porsi (Efesianëve 5:28)
- d. Arsye. për shkak (Efesianëve 2:4)
për këtë arsye (Efesianëve 3:15)
për këtë qëllim (Efesianëve 6:22)
nëpërmjet (Efesianëve 2:8)
sepse (Kolosianëve 1:4)
- e. Rezultat. pra (Efesianëve 2:19)
prandaj (Efesianëve 2:11)
si rezultat (Efesianëve 4:14)
si rrjedhim
veç kësaj
- f. Qëllim / Rezultat. që (Efesianëve 1:4)
dhe që (Efesianëve 1:18)
Në mënyrë që (Efesianëve 4: 28)
- g. Kusht nëse (Efesianëve 3:2)

2. Lidhje të përkohshme ose periudhash: . . . tani (Efesianëve 2:2)
derisa (Efesianëve 4:13)
kur (Efesianëve 1:20)
përpara (Efesianëve 1:4)
pasi (Efesianëve 1:13)
ndërsa (Efesianëve 1:16)
në qoftë se (Kolosianëve 3:1)

3. Lidhje gjeografike Ku (Kolosianëve 3:1)

5

SHIH SI FUNKSIONON

Përfshirja në proces

Për të treguar se si funksionon metoda e 12 pyetjeve të lidhjeve, le të bëjmë një ushtrim më rrënjësor, bazuar te një pjesë që kemi parë tashmë. Do të shohim përsëri Gjonin 4, ku Jezusi takohet me gruan samaritane në pusin e Sikarit. Duke përdorur pasazhe të këtij kapitulli, do të japim shembuj që tregojnë se si procesi i përdorimit të pyetjeve bazë dhe të lidhjeve do të shqyrtojë të dhënat që duhen për një studim të mirë biblik.

Drama e vogël që luhet në këtë kapitull ka vetëm dy tipare kryesore, Jezusi dhe gruaja samaritane. Ne e dimë se kush është Jezusi, por tani duam të dimë më shumë për këtë grua. Ndërsa lexojmë për të, le të nisim procesin e zbulimit duke bërë pyetjen e parë bazë “Kush?”. Kush ishte kjo grua? A mund të zbulojmë shumë rreth identitetit dhe karakterin e saj nga të dhënat në këtë kapitull? Po, pasazhi na zbulon diçka për të. Ja, disa nga përgjigjet e mia. Ajo ishte:

1. një prostitutë, ose kurorëshkelëse (v. 18)
2. një formaliste fetare – ajo mendonte se kishte vetëm një rrugë adhurimi (v. 20)
3. një nacionaliste – krenare për trashëgimin e saj (v. 12)
4. e ndjeshme ndaj çështjes së racizmit midis judenjve dhe samarianëve (v. 9)
5. nuk donte të nxirrte ujë (v. 15)
6. e etur që të njihnte Mesinë (vv. 25, 28-29)
7. samaritane (v. 9)

Si pasojë e pyetjes sonë interpretuese “kush?” ne kemi mësuar paksa për këtë grua samaritane. Pra, le ta ilustrojmë hapin vijues duke bërë dy

pyetjet e para të lidhjeve për karakteret kryesorë. Pyetja e parë është “Cilat janë gjërat e ngjashme”? Në këto vargje shohim se si Jezusi, ashtu edhe gruaja samaritane:

1. kishin një trashëgimi të përbashkët te Jakobi (v. 12)
2. kishin interes për gjërat shpirtërore (v. 19-28)
3. ishin të etur fizikisht (v. 7)
4. kishin interesim të dukshëm për të folur me njeri-tjetrin.

Përfshi atë që ke mbledhur nga kjo pyetje në skicën tënde të kolonës së vëzhgimit.

Kur përfshihesh në proces, shpesh vëzhgimet do të arrijnë thënien e thjeshtë dhe të qartë të tekstit dhe do të kalojnë në parime më të gjera. P.sh; në bisedën e Jezusit me gruan samaritane mund të shohësh thjeshtësinë me njerëzit. Ai i donte të gjithë ata që takonte, edhe ata që i përkisnin një shtrese të ulët si kjo grua. Mund të vësh re se për shkak të natyrës së tij njerëzore, ai kishte po ato nevoja fizike si ne. Lodhej dhe e merrte etja. Mund të shikosh se si gruaja u tërhoq ndaj Jezusit, që, ashtu siç e kuptoi menjëherë, mund të plotësonte etjen e saj shpirtërore. Vendosi këto vëzhgime më të zgjeruara, së bashku me ato kryesoret në skicën vëzhguese.

Tani le të kalojmë në pyetjen e dytë të lidhjeve: “Cilat janë ndryshimet?” Kjo pyetje do të shërbejë si mjet për të shqyrtuar kontrastin midis Jezusit dhe gruas samaritane. Bëmë një ushtrim të ngjashëm në kapitullin e mëparshëm, ku ballafaquam Nikodemin dhe gruan samaritane, duke treguar ndryshimet midis personit që Jezusi takoi te Gjoni 3 dhe atij që takoi te Gjoni 4. Këtë herë do të shfaqim ndryshimet ose kontrastin midis Jezusit dhe gruas samaritane.

Ndryshimet

Gruaja	Jezusi
1. Gruaja kurorëshkelëse	Biri i Perëndisë, Rabin
2. Grua	Burrë
3. Raca samaritane	Jude
4. Feja samaritane	Judaizmi
5. Nga Samaria	Nga Judeja

Pasi të bësh pyetjen dhe të vëzhgosh ndryshimet, shkruaji në skicën tënde vëzhguese.

Tani do të ndalem të përmend disa gjëra, që do t'i zbulojmë më hollësisht në kapitujt vijues. Në këta kapituj do të shpjegoj hapin pasues pas vëzhgimit, që është interpretimi. Në hapin e interpretimit do të pyesësh për ndryshimet midis Jezusit dhe gruas samaritane “Çfarë duan të thonë? Si ndikojnë në komunikimin? A krijojnë pengesa, apo janë të parëndësishme?” Për t'i zbuluar këto pengesa, duhet të kthehesh te pyetja “Çfarë?” Shiko çdo ndryshim dhe pyet “Çfarë pengese do të krijojë ky ndryshim midis Jezusit dhe gruas samaritane?”

Tani do të shohësh se vëzhgimi i thjeshtë i tekstit nuk do të të japë të gjitha përgjigjet që të nevojiten. Për këtë do të të nevojiten kërkimet e jashtme. Përgjigjet që mbledh nga këto burime nuk do të jenë thjesht një vëzhgim, por interpretim, sepse do ta tejkalojnë atë që shikon në tekst, duke kaluar në zbulimin e kuptimit të tij. Në kapitujt vijues do të shpjegoj më shumë për hapin e interpretimit, por tani sugjeroj që të mos i ndjekësh në mënyrë rigorozë këto hapa studimi. Hyr e dil nga vëzhgimi dhe interpretimi gjatë zbulimit. Për këtë do të fokusohem më vonë, por ndërsa po zbulon ndryshimet midis Jezusit dhe gruas, duhet të bësh një nga këto dy gjëra: ose të kalosh përkohësisht në hapin e interpretimit dhe t'u përgjigjesh pyetjeve të interpretimit, ndërsa tema është në mendjen tënde, ose duhet të mbash shënim pyetjet e interpretimit ndërsa dalin, që t'u përgjigjesh kur kalon në hapin e interpretimit.

Nga teksti duket qartë se ai ishte mjaft i efektshëm në kapërcimin e pengesave që e ndanin nga gruaja samaritane. Prandaj shtrohet pyetja “si?”. Si e ka bërë ai këtë?

Së pari, ai e shpërfillte çdo traditë që ishte pengesë, pavarësisht se sa e qëndrueshme ishte ajo. Te Gjoni 4:3-4 lexojmë: “E la Judenë dhe shkoi përsëri në Galileë”.

Por duhej të kalonte nëpër Samari. Judeja dhe Galileja ishin të dyja krahina izraelite, nën sundimin romak dhe Samaria ishte në mes. Çifutët i përbuznin aq shumë samarianët, sa kur u duhej të udhëtonin nga Judeja në Galileë, nuk kalonin nga Samaria, por i binin gjatë që të mos preknin tokën e saj. Por, siç na thotë vargu 3:3-4, Jezusi kaloi nëpër Samari. Ai e shpërfilli traditën e ligë dhe degraduese dhe kaloi me guxim përmes rrugëve të Samarisë, shpërfilli edhe traditat që nuk lejonin të flisje me një mëkatar, një grua dhe një samaritane.

Së dyti, Jezusi përdori pak psikologji për të dobësuar çdo pengesë që mund të ishte ngritur në mendjen e saj. Pa dyshim që, duke qenë e

refuzuar gjithë jetës nga çifutët dhe, madje, edhe nga populli i vet, për shkak të mëkateve të saj të dukshme, ajo nuk do të hynte në një bisedë të tillë me këtë çifut pranë një pusi. Shikoni çfarë bëri Jezusi për ta kapërcyer këtë pengesë: ai kërkoi një nder. “Të lutem, më jep pak të pi”, – tha ai. Që të tërheqësh një person, duhet t’i kërkosh nder, sepse duket që i je disi borxhli dhe i krijon besim ideja që s’është në pozitë inferiore. Parimisht, njerëzit duan t’i ndihmojnë të tjerët, sepse i bën të ndihen mirë.

Duke shënuar vëzhgimet te mënyrën se si Jezusi kapërceu pengesat, mund të shkruash në skicë: “Ai shpërfilli traditat, duke kaluar nëpër Samari” dhe “Kërkoi një nder; t’i jepej ujë”.

Në këtë kapitull nuk duam të plotësojmë thjesht një skicë, por të paraqesim disa shembuj se si të mbledhësh të dhëna nga teksti, duke përdorur pyetjet. Le t’i kalojmë pyetjet 3-5 dhe të merremi me pyetjen e lidhjeve 6: “A ka përparim?” Kujto se një përparim është një ide, një ngjarje që zhvillohet, ose shpaloset e kulmon shpesh me një ide, ose veprim specifik.

A kemi ndonjë shenjë treguese të përparimit te Gjoni 4? Sigurisht që po. Dëshmia e Jezusit ndaj gruas samaritane na jep një shembull klasik, që na tregoi se si një takim i thjeshtë e në dukje i rastësishëm, rezultoi në shpëtimin e shumë banorëve të qytetit. Duke bërë pyetjen për përparimin, gjeta katër raste në bisedën me gruan, gjatë së cilave Jezusi e vuri atë në një nivel më të lartë mendimi. Le t’i zbulojmë.

Së pari, Jezusi i propozoi gruas samaritane diçka të dëshirueshme (v.10, 13-14). Cila ishte dëshira e kësaj gruaje? Ajo do të donte të kishte një burim uji në shtëpinë e saj, që të shmangte ecjen e përditshme në diellin e nxehtë, ku pa dyshim i duhej të duronte talljet e grave të tjera. Jezusi i ofroi ujë të bollshëm, që ajo të mos kishte më kurrë etje. Ishte e natyrshme që ajo të pushtohet nga kureshtja. “Zot, ma jep këtë ujë, që unë të mos kem më etje dhe të mos vij këtu të nxjerr ujë!” (v.15). Ajo dëshironte ujin, por dukej se nuk e kuptonte natyrën shpirtërore të propozimit.

Së dyti, Jezusi i tregoi gruas pse nuk mund ta merrte ujin që i paraqiste. Mëkati ishte pengesa dhe atij i duhej ta vinte në dukje, që ta hiqte prej saj. Vër re se sa me stërhollim e bën ai. Në vend që të gjëmonte “Për shkak të mëkatit tënd të tmerrshëm!” ai i tërhoqi vëmendjen me fjalët “Shko, thirre burrin tënd” (16). Gruaja u përgjigj menjëherë: “Unë nuk kam burrë” (17). “Mirë the: “Nuk kam burrë”, – tha Jezusi prerazi “sepse ti kishe pesë burra dhe ky që ke tani nuk është burri yt; për këtë ke thënë të vërtetën!” Ai ngriti nivelin e

bisedës. Kaloi nga një kërkesë në dukje e thjeshtë, në ekspozimin e problemeve të thella të gruas, që e pengonin atë të gjente paqen e kërkuar. Gruaja u befusua kur pa se Jezusi dinte gjithçka për të dhe e kuptoi se ishte para një profeti, një njeriu fetar. U përpoq t'i shpëtonte shqyrtimit personal për jetën e saj duke ndryshuar temën e duke kaluar në një tjetër që do ta hutonte këtë njeri të përshpirtshëm. “Gruaja i tha: "Zot, po shoh se ti je profet. Etërit tanë adhuronin në këtë mal, por ju thoni se vendi ku duhet të adhurojmë është në Jerusalem"” (19, 20).

Orvatja e gruas për të ndërruar temën e bisedës bëri që Jezusi të kalonte në nivelin e tretë të përparimit në të. Ne shohim se ai nuk pranon të tërhiqet në një argument, përkundrazi, përfshin idenë që përkushtimi ndaj Perëndisë nuk varet nga ndonjë vend i caktuar, por nga njohja e atij që adhuron. Ai i përgjigjet asaj që të mos devijojë në gjëra të tilla të parëndësishme si vendi, sepse adhurimi i vërtetë është shpirtëror (v. 21-24) dhe nuk ka të bëjë me të shkuarit në këtë mal ose atë qytet, por me realitetin e Perëndisë dhe rregullimin e marrëdhënies me të. Ai e kalon atë, nga ekspozimi i mëkatit në nevojën për të njohur Perëndinë dhe kështu biseda përparon më tej.

Atëherë, gruaja kalon në fazën e katërt të përparimit me përgjigjen e saj vijuese. Siç duket, ajo nuk e beson përgjigjen e Jezusit. Ndonëse joshet nga fjalët e tij, nuk bindet se tradita e saj e njohur e adhurimit në një mal të caktuar është e gabuar dhe se adhurimi është çështje e shpirtit dhe e realitetit. Por në vend që të diskutonte për çështjen, ajo përpiket të shmanget, duke iu drejtuar një autoriteti që nuk është akoma në gjendje ta zgjidhë, duke iu shmangur aludimeve të argumenteve ku po drejtohet Jezusi. Ajo thotë: “Unë e di se do të vijë Mesia, që e quajnë Krisht; kur të ketë ardhur, ai do të na kumtojë çdo gjë”. Kjo përgjigje i jep Jezusit mundësinë që i duhet të përcjellë përfundimin: “Unë jam Mesia!”. Para syve të saj qëndron i tërë autoriteti që i duhet për të vërtetën. Ai është uji për të cilën ka etje, e vërteta që kërkon, përgjigjja ndaj nevojave të saj. Në këtë hap përfundimtar ai sfidon besimin e saj. A do të besojë, apo jo? Më vonë shohim se ajo beson (39-42).

Përmes katër hapave progresive, Jezusi e ka drejtuar te vetja.

1. Jezusi i propozon diçka të dëshirueshme.
2. Ai i tregoi pse nuk mund ta kishte.
3. I tregoi atë që këron Perëndia
4. E nxiti që të besonte.

Sa më shumë që mëson të kërkosh, aq më shumë gjen. A po shikon një përparim paralel në qëndrimin e gruas ndaj Krishtit, gjatë bisedës? Në vargun 9, ajo e quan çifut, një shprehje tallëse për një samarian. Në v.11, i drejtohet “zotëri”, një shprehje e sjellshme që tregonte respekt. Në v.19, e quan profet e pastaj në v.29, u thotë të tjerëve se është Mesia.

Ne mund të shohim një përparim edhe në rezultatet ungjillizuese të takimit të saj me Jezusin:

1. Ajo u takua me Krishtin (v. 26)
2. U tregoi të tjerëve, siç duket brenda pak çastesh (v. 29)
3. Nga dëshmia e saj, të tjerët besuan te Krishti (v. 39)
4. Të tjerët takuan Krishtin dhe besuan (v. 41)

Le të zbatojmë tani një tjetër Pyetje të Lidhjeve ndaj tekstit. Në pyetjen 4: “A ka prova të shkakut dhe pasojës?” Shikoni vargun 28: “Atëherë gruaja e la kovën e saj dhe u kthye në qytet e u tha njerëzve”.

Fakti që ajo e la kovën me ujë, një zakon i vlefshëm i kohës, tregon entuziazmin dhe ngutën e saj. Ajo me zor priste që të përhapte lajmin për Jezusin. Ky veprim i papritur është një pasojë. Cili ishte shkak? E gjejmë në vargun 26, kur Jezusi i tha asaj: “Unë jam Mesia”. Kjo zbulesë mahnitëse bëri që ajo ta linte kovën dhe të rendte në qytet për t’u treguar të tjerëve.

Por, është interesant fakti që veprimi i saj nuk është vetëm një efekt, por edhe një shkak në vetvete, që të çon në efekt tjetër. Ne e shohim këtë efekt në vargjet 39-42, ku lexojmë se si pasojë e dëshmisë së saj, shumë prej banorëve të qytetit erdhën për të dëgjuar Jezusin dhe besuan në të. Pra, duke bërë të njëjtën pyetje shkak-pasojë, ne shohim se jo vetëm që gruaja u kthye në besim (te Jezusi), por kthimi i saj kishte ndikim në mbarë qytetin. Ai çoi në rizgjim.

Tani do të bëjmë pyetjen 5 “A ka lëvizje nga e përgjithshmja në specifike?” Shikoni fillimin e bisedës midis Jezusit dhe gruas. Ata nisin të flasin për ujin. Fillimisht, tema është në përgjithësi uji, uji i kulluar dhe i pijshëm, H₂O. Por menjëherë, Jezusi e ngushton kuptimin, duke përdorur ujin si metaforë, me një domethënie shpirtërore. Pasi vendosi temën shpirtërore, ai flet për Atin (v.23) dhe nga Ati, e kalon temën tek vetja, Mesia (26), duke e kaluar bisedën nga diçka mjaft e përgjithshme si uji, në diçka specifike, vetvetja.

Tani do të kalojmë në pyetjen 7 “Ç’pyetje apo përgjigje jepen?” Ne shohim Jezusin që bën një pyetje në v.35. “A nuk thoni ju se ka edhe katër muaj dhe vjen korrja?”. Një pyetje e tillë të nxit të bësh disa

pyetje bazë. *Kujt* po i fliste Jezusi? *Çfarë* nënkuptonte me këtë? Kur shohim përsëri v.31, ne shohim përgjigjen e pyetjes “kush?”: ai po u fliste dishepujve të tij. Kur vazhdojmë të lexojmë deri tek 38, gjejmë përgjigjen e “çfarë?”. Vetë Jezusi e shpjegon. Ai u shpjegon dishepujve se sjellja e njerëzve në besim nuk njihet periudhë të veçantë, sepse nevoja është e pranishme gjatë gjithë kohës. Zemrat e njerëzve janë duke u përgatitur vazhdimisht dhe dishepujt e tij po përgatiten për të mbledhur njerëzit që Gjon Pagëzori kishte përgatitur nëpërmjet predikimit të tij të mëparshëm në Samari.

Ne shohim një pyetje tjetër në v.33, që na jep një ide se çfarë po bënte Jezusi këtu. Sapo mbaroi bisedën me gruan samaritane, dishepujt u kthyen dhe e nxitën që të hante. Ai u tha: “Unë kam një ushqim, të cilin ju s’e njihni”. Sigurisht që ata kujtuan se po fliste për bukë dhe mish e u habitën se ku mund t’i kishte gjetur, ndaj pyetën njëri-tjetrin se kush mund t’ia kishte sjellë.

Atë çast, dishepujt e kishin mendjen tek ushqimi, por Jezusi e përdori takimin me gruan samaritane për të ngritur mendjet e tyre drejt një synimi më të lartë, që ishte misioni i tyre për të përfutur botën për Krishtin. Pyetja e tij për të korrat krijonte një urë midis shqetësimeve të tyre fizike për të mbushur barkun dhe shqetësimin të tij më të lartë për shpëtimin e njerëzve.

Jezusi u tha atyre në v.35: “Ngrini sytë tuaj dhe shikoni fushat që tashmë zbardhjnë për korren”. Këto fjalë mund t’u kenë bërë shumë përshtypje dishepujve kur banorët e qytetit, pasi i kishin besuar dëshmisë së gruas te pusi, filluan të vinin për ta parë dhe dëgjuar atë, në vargun 39. Ata panë me sytë e tyre korren që ai kishte përmendur.

Me një kombinim të pyetjeve bazë dhe të lidhjeve, nuk duhet shumë kohë për të plotësuar faqe të tëra të një Skice Vëzhguese. Siç mund ta shikosh, procesi shpesh kalon në cikle, midis një lloji pyetjeje dhe një tjetre, ndërsa pyetjet e lidhjeve nxisin ato themelore dhe anasjelltas. Shpresoj që ky kapitull të të ketë ndihmuar ta kuptosh procesin aq mirë sa ta bësh edhe vetë. Hapi vijues në studimin biblik është interpretimi, që do ta paraqes në kapitullin e ardhshëm.

Detyrë

Te vëzhgimet që ke bërë nga Gjoni 2, duke përdorur pyetjet e lidhjeve, shkruaj së paku 10 pyetje të reja interpretuese.

HAPI I DYTË

Si “ta njohësh atë”

Udhëzues për Interpretimin

6

INTERPRETIMI – GJEJ KUPTIMIN E VËRTETË

Zbulo të vërtetën e Biblës

Kur përpiqemi të kuptojmë domethënien e vëzhgimeve tona, ne përfshihemi në *interpretim*. Interpretimi mund të përkufizohet si “procesi i përcaktimit të kuptimit të tekstit”. Synimi përfundimtar i interpretimit është të kuptosh domethënien e pasazhit. Ne duam të zbulojmë se çfarë donin të thoshin autorët e Biblës kur kanë shkruar Shkrimin e Shenjtë. Secili prej këtyre autorëve ka qenë një njeri, por secili ka shkruar nën frymëzimin e Shpirtit të Shenjtë. Pra, kur ne zbulojmë se çfarë nënkupton autori njerëzor, zbulojmë se çfarë nënkupton autori hyjnor.

Gabimi i postmodernistëve

Sot shumë njerëz dyshojnë se mund të njohim atë që ka dashur të thotë autori hyjnor. Jo shumë kohë më parë një i ri më tha: “Me aq shumë interpretime të Biblës, si mund ta di se çfarë duhet të besoj? Më duket se kur e lexoj Biblën, mund të besoj çdo gjë që dua”. Sot njerëzit kanë aq shumë interpretime të ndryshme të Biblës, sa vënë në pikëpyetje njohjen e domethënies, ose nëse ka një kuptim me të vërtetë objektiv. Konfuzioni shtrihet edhe më tej. Shumë njerëz sot dyshojnë për ekzistencën e së vërtetës absolute, ose, nëse besojnë se ekziston, mendojnë se është e pamundur të njihet. Ky lloj dyshimi ka ndikuar te shumë të krishterë, edhe ata që besojnë në Bibël. Megjithëse janë të bindur se është e vërtetë, ata dyshojnë për aftësinë e çdo personi për të interpretuar të vërtetën saktësisht dhe objektivisht. E dëgjojmë vazhdimisht: “Nëse interpretimi yt funksionon për ty, shumë mirë, por unë e shoh ndryshe. Për mua ka rëndësi se si e interpretoj unë”. Ose “Nuk kam po ato mendime nga ky varg, por nuk ka asnjë problem, sepse çfarë është e vërtetë për mua, mund të mos jetë e vërtetë për ty”.

Për shembull, disa njerëz fetarë nuk besojnë se Jezu Krishti është Biri i mishëruar i Perëndisë, që erdhi në tokë në trup njerëzor. Ne të krishterët mësojmë se ai me të vërtetë është Biri i Perëndisë. Është e qartë se të dyja mësimet nuk mund të jenë të vërteta. Nuk ka rrugë të mesme, nuk mund të pajtohen dy pikëpamjet e kundërta. Ose Jezusi është Biri i Perëndisë, ose nuk është. Nëse ai nuk është Biri i Perëndisë, atëherë mund të ketë një sërë interpretimesh rreth identitetit të tij, por Bibla shpall prerazi se është Biri i Perëndisë. Kjo është tema e Ungjillit të Gjonit. Nëse do, mund ta interpretosh mendimin tënd individual për këtë libër dhe të paraqitësh çfarëdo kuptimi alternativ që dëshiron, por kështu, vetëm sa imponon mendimin tënd duke e quajtur këtë proces interpretim. Interpretimi i vlefshëm përqipet të zbulojë atë që nënkuptonte autori.

Të krishterët e vendosur për të ndjekur Perëndinë dhe për të njohur vullnetin e tij duhet ta refuzojnë qëndrimin e sotëm të zakonshëm ndaj interpretimit biblik. E vërteta e Biblës ekziston si një fakt i qëndrueshëm që nuk varet nga mënyra si e shohim. Jezu Krishti jetoi, mësoi, u kryqëzua dhe u ringjall. Ky është një fakt i qëndrueshëm i historisë, i pohuar fuqimisht në Bibël, pavarësisht nëse mendon se është e vërtetë për ty. Ose Jezusi është Biri i Perëndisë, ose nuk është. Ose Bibla është objektivisht e vërtetë ose nuk është. Mënyra se si ti dhe unë i shohim këto të vërteta, nuk e cenon aspak saktësinë ose vlefshmërinë objektive të tyre. Të fshihesh pas justifikimit të vjetër e të çalë se Bibla nuk mund të kuptohet objektivisht është dembelizëm, frikë, ose paramendim.

Sipas 1 Pjetrit 1:20, asnjë pjesë i Shkrimit nuk mund të ketë kuptim individual, por ka një kuptim objektiv që duhet të zbulohet me përlulje, gatishmëri për të pranuar atë që nënkupton, pavarësisht nga çfarë nënkupton, nga paragjykimet tona, nga teologjia, filozofia, ose preferenca jonë. Nënkupton atë që nënkupton në të vërtetë e jo atë që mendoj unë se nënkupton, ose çfarë dua unë që të nënkuptojë. Interpretimi nuk zhvillohet, por zbulohet.

Të 2 Tim. 3:16-17 thuhet: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësimin e së vërtetës dhe për të na nxitur të kuptojmë të keqen në jetët tona. Na bind dhe ndreq e na mëson të bëjmë atë që është e drejtë. Është mënyra se si Perëndia na përgatit e na pajis tërësisht për çdo vepër të mirë që kërkon të bëjmë”. Shiko çfarë thotë kjo pjesë për atë që bën për ne. Mëson të vërtetën, na tregon të mirën dhe të keqen, na ndreq, na shpie në drejtimin e duhur dhe na pajis për të bërë vullnetin e Perëndisë. Por, a do të kishin kuptim të gjitha këto, nëse Shkrimi do të ishte aq i errët dhe i vështirë për t’u interpretuar, sa të mos kuptohej? Sigurisht që jo. Përkundrazi,

Shkrimi duhet të jetë i kuptueshëm, ndryshe nuk mund të kryejë funksionet e përshkruara nga Pali në këtë pjesë. Ne të gjithë kemi të njëjtën Bibël dhe të njëjtin Shpirt të Shenjtë. Perëndia dëshiron që të gjithë të njohim të vërtetën që na jep në këtë libër të frymëzuar. Ai synon që secili prej nesh të kuptojë kuptimin objektiv e jo atë individual.

Çelësa për interpretimin

Qëllimi i interpretimit është të zbulojmë se çfarë do të thotë Bibla objektivisht, të gjejmë të vërtetën që përcjell, ta pranojmë përlulisht dhe ta zbatojmë me rreptësi. Pavarësisht nga deklaratat e kundërta, Bibla nuk është një libër shumë i vështirë për t'u kuptuar. Nuk ke pse të jesh student i diplomuar, të njohësh greqishten, ose hebraishten dhe nuk ke pse të kryesh studimet në një shkollë biblike. Të gjitha këto ushtrime kanë një vlerë të madhe dhe unë i këshilloj, por nuk janë krejtësisht të domosdoshme për kuptimin. Të gjithë mund të mësojmë të mbledhim të vërtetat dhe kuptimin e Biblës. Sigurisht që kërkon mund dhe studim, por kur dini të përdorni metodën e duhur të interpretimit në studimin e Shkrimit, bëhet e kuptueshme në mënyrë të mrekullueshme.

Le të shohim disa nga faktorët, që duhen konsideruar në interpretimin e një pasazhi biblik.

Metafora: Pjesë e interpretimit është thjesht të zbatosh gjykimin e shëndoshë. Ti mund t'i kuptosh pasazhet më mirë, nëse e lë gjuhën që të shprehet në mënyra të zakonshme, në vend të imponimit të njëfarë standardi të veçantë, artificial për gjuhën e përdorur në Bibël. Bibla është letërsi dhe të njëjtat parime gjuhësore vlejné edhe për shkrime të tjera. Disa njerëz nuk arrijné ta kuptojné këtë fakt të thjeshtë. Duke qenë se janë të bindur se çdo fjalë e Biblës është fjalë për fjalë e vërtetë, ata e kanë të vështirë t'i pranojnë shumë metafora si të tilla. Megjithëse është e drejtë të besohet Bibla si e vërtetë, duhet lënë vend edhe për metafora, krahasime dhe analogji, në formën ekzistuese, pa i sforcuar ato në një kuptim të fjalëpërfjalshëm. P.sh, kur Jezusi thotë "Unë jam buka e jetës", do të tregojë se është një copë gruri e përzier me brumë dhe e pjekur? Sigurisht që jo! Po thotë metaforikisht se siguron mbështetje për jetën tonë shpirtërore, ashtu si një copë buke siguron mbështetje për jetën tonë fizike. Ky shembull është i padiskutueshëm, por do të habitesh nga interpretimet e shpikura që dëgjon kur njerëzit përpiqen t'i interpretojnë fjalë për fjalë metaforat biblike.

Gramatika: Bibla përdor jo vetëm metaforën, por edhe gramatikën. Mos u shqetëso se nuk do të të caktoj të skicosh fjali, por duhet t'i

kushtosh vëmendje gramatikës, sepse shpesh kjo bëhet faktor në interpretimin e saktë. Gramatika ka të bëjë me kohë foljesh, pyetje, urdhra, kryefjalë dhe kundrinorë, elemente këto që përcaktojnë strukturën e gjuhës dhe janë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e saktë të kuptimit.

Për shembull, gramatika ka shumë ndikim në interpretimin e thënies së Jezusit: “Unë jam buka e jetës”, ashtu si dhe njohja e metaforës. Vër re se ai e përdor foljen “jam” në kohën e tanishme: “Unë *jam* buka e jetës”. Është e rëndësishme që nuk thotë: “Unë isha buka e jetës” e as “do të jem buka e jetës”. Fakti që përdor *unë jam* tregon për natyrën e pandryshueshme e të përjetshme të Krishtit. Na kujton se si Perëndia iu zbulua Moisiut pranë ferrishtës së ndezur, në malin Sinai. Kur Moisiu e pyeti Perëndinë si quhej, në mënyrë që t’i përgjigjej faraonit se kush e kishte dërguar, i vetmi emër që dha Perëndia ishte “Unë JAM”. Përdorimi i së njëjtës shprehje nga ana e Jezusit pohon hyjninë e tij. Ai është Perëndia që ekziston gjithnjë, ruajtësi i përjetshëm i gjithësisë dhe i jetëve tona.

Historia: Bibla është shkruar në periudha historike specifike. Qëndrimet, sfondi, mënyra e jetesës dhe struktura politike e një periudhe të caktuar do të ndikojnë në kuptimin e një pasazhi. Le të shohim thënien e Jezusit: “Unë jam buka e jetës” në kontekstin e vet historik. Çfarë na tregon për mënyrën se si duhet ta interpretojmë?

Sfondi historik ishte shekulli i parë gjatë pushtimit romak të Izraelit. Në atë kohë buka ishte burimi kryesor i ushqimit dhe nuk ishte shtesë ndaj ushqimit kryesor siç është sot, diçka për t’u ngrënë me një biftek, patate dhe sallatë. Buka ishte ushqimi kryesor, ndaj përdorimi i saj nga Jezusi si metaforë thekson rëndësinë jetike që ka për jetën shpirtërore të dëgjuesve. Ashtu si pa bukë do të vdisnin fizikisht, pa Jezusin ata do të vdisnin shpirtërisht.

Po të mos konsiderojmë siç duhet metaforën, gramatikën dhe historinë, ne rrezikojmë kuptimin objektiv të pasazhit. Kur humbasim kuptimin objektiv, rrezikojmë të imponojmë me shkujdesje kuptimin tonë të pasazhit dhe do të humbasim të vërtetën që synon të përcjellë.

Procesi interpretues

Deri tani në këtë libër kemi treguar si të vendosim pyetjet dhe t’i përdorim për të shqyrtuar disa pasazhe të caktuara. Kemi kaluar përmes procesit të vëzhgimit. Tani është koha të përcaktojmë se çfarë nënkuptojnë këto vëzhgime. Pikërisht këtu nis hapi i interpretimit.

Por, ndërsa po flas për hapat, dua të theksoj diçka. Ndërsa merresh me skicat, mos u përipiq të bësh një dallim të fortë midis vëzhgimit dhe interpretimit. Unë mund të t'i jap këto metoda të mësimi dhe kuptimit të Biblës vetëm duke i ndarë në hapa të veçantë, duke shpjeguar se si funksionon secili prej tyre para se të kalojmë më tej. Në fakt, hapat do të përzihen me njëri-tjetrin, pasi një hap do të shkrihet në një tjetër e me kohë nuk do t'i shohësh si të veçantë. Për shembull, një pjesë e mirë e vëzhgimit e ka interpretimin të integruar në të. Në një ushtrim më të hershëm vëzhgove se Nikodemi ishte farise. Kur vazhdove me pyetjen bazë “Ç’është një farise?” po bëje një pyetje interpretuese. Për të gjetur përgjigje ndaj pyetjeve të tilla duhet të bësh më shumë se sa thjesht të vëzhgosh tekstin, sepse teksti i drejtpërdrejtë nuk e siguron përgjigjen. Përgjigjja nuk do të kërkojë thjesht vëzhgim, por interpretim. Gjatë diskutimit të mësipërm për metaforën, gramatikën dhe historinë, vure re se disa prej të dhënave që të dhashë nuk vijnë drejtpërdrejt nga Bibla. Për shembull, rëndësia e bukës në shekullin e parë duhet të mësohet gjetkë.

Pra, tani mund të pyesësh: “Si t'i gjej përgjigjet e duhura ndaj pyetjeve të mia interpretuese?” Do të gjesh referime librash, ose burime kompjuterike për të gjetur kuptimin e plotë të shprehjes “farise”. Përgjigjja që do të gjesh do të jetë më shumë se vëzhgim, pra *interpretim*. Kur ndeshesh me shprehjen “farise” në hapin tënd të vëzhgimit, mund të vendosësh t'i përmbahesh një besnikërie të paepur për të konkurruar me atë hap dhe thjesht të vazhdosh të bësh vëzhgime nga teksti – një farise ishte udhëheqës i judenjve, pjesëtar i sinagogës etj... Por ka më shumë kuptim, ndërsa je ndeshur me temën e farisejve, për të vazhduar me interpretimin dhe për të zbuluar se si ishte një farise. Le të bashkohen hapat për të plotësuar procesin e zbulimit kur ndeshesh me subjektin.

Interpretimi formohet mbi themelin e vëzhgimit. Nëse vëzhgon atë që Bibla thotë dhe i mbledh të gjitha vëzhgimet, mund të interpretosh më saktësisht. Sa më e madhe cilësia e vëzhgimit, aq më i saktë interpretimi. Ndërsa vazhdon të lexosh këtë libër, do të vësh re se sa ide përsëriten. Një pjesë e mirë e asaj që kemi mësuar për vëzhgimin do të rrjedhë drejt interpretimit. Shumë nga parimet që përdorim në vëzhgim, mund t'i përdorim edhe në interpretim.

Por, para se të fillojmë, duhet të përpilosh një tjetër informacion paraprak, skicën kapëse. Në fakt, do të jetë më saktë ta quajmë këtë fletë dhe jo skicë, një Fletë Interpretimi, në të cilën mund të shënosh interpretimet e tua, ndërsa punon. Nuk ka kuptim ta quajmë skicë,

sepse nuk ka kolona, por thjesht një titull në qendrën e sipërme ku thuhet “interpretim”. Nën titullin, në qendër, shkruaj pasazhin që do të interpretosh. Në hapësirën e poshtme, do të plotësosh të dhënat që mbledh nga ai pjesë, nga procesi interpretues. Më vonë do t’i referohesh kësaj filete për interpretimet e tua të pasazheve dhe fjalëve, ndërsa formulon skicën përfundimtare.

Dy kapitujt pasues do të paraqesin procesin e interpretimit. Duke kaluar përmes çdo hapi, njohja jote do të shtohet ndjeshëm. Nuk do të kuptosh vetëm atë që ka thënë autori, por edhe pse e ka thënë dhe çfarë ka dashur të thotë.

7

LËRE BIBLËN TË TA INTERPRETOJË

Të përdorësh Biblën si burim

Pa dyshim që ke dëgjuar predikues, ose mësues të Biblës të kenë thënë se ajo shpjegon veten. Sigurisht që ata nuk duan të thonë se libri fillon e flet me zë të dëgjueshëm gjatë leximit: “Ja, çfarë dua të them këtu”. Ata duan të thonë se Bibla shpesh trajton të njëjtat tema në më shumë se një vend, duke zgjeruar kuptimin ose duke u shtuar nuanca. Pra, mund ta kuptosh më mirë një pjesë të caktuar, nëse mëson ku ta gjesh temën e trajtuar në një pjesë tjetër.

Ndër-referim

Gjetja e këtyre pasazheve të lidhura quhet *ndër-referim*, që do të thotë thjesht të ndjekësh një temë ose një fjalë nga një varg në tjetrin, brenda Biblës, për të mbledhur gjithçka që libri ka për të thënë rreth temës. Ndër-referimi është vetëm një nga mjetet për interpretimin e mirë dhe me të do të fillojmë. Më vonë, gjatë kapitullit do të zbulojmë mjete të tjera interpretuese nga Bibla, si kontekste dhe përkufizime.

Epërsia e sistemit të ndër-referimeve gjendet në pushtetin e vet. Meqenëse lejon Shkrimin të interpretojë veten, mund të varesh nga saktësia e gjetjeve të tua. Personalisht, e shoh si një nga fazat më të kënaqshme të studimit biblik, sepse në këtë fazë fillon të konstatosh me të vërtetë se si të shpaloset kuptimi i Biblës.

Metoda e zakonshme e ndër-referimit fillon me tablonë e gjerë dhe pastaj kalon në hollësitë. Fillo duke parë pyetjet që ngrite për të formuar vëzhgimet e tua. Çfarë duhet të gjesh për të shënuar interpretimet e tua? – një skicë tjetër. Meqenëse kjo skicë do të përmbajë vetëm dy kolona, mund ta përpilosh vertikalisht dhe jo horizontalisht në faqen tënde. Si titull në krye, shkruaj “Skica e referimeve”. Pastaj, nën titull vër fjalën ose vargun që do të ndër-

referosh. Kolona e parë, ajo në të majtë, do të jetë më e ngushtë se sa ajo në të djathtë. Unë sugjeroj që ta bësh kolonën e parë rreth 6 cm të gjerë, kështu pjesa tjetër e faqes do të jetë kolona e dytë. Titulli i kolonës sate të parë do të jetë “Ndër-referimi” ndërsa ai i së dytës “Domethënia”. Shih Skicën Ndër-referimi bosh në Shtojcën C.

Burimet e referimeve

Ka disa burime të disponueshme për të gjetur ndër-referimet. Shumë botime, ose përkthime të Biblës kanë ndër-referime të shënuara në një kolonë të veçantë, pas vargut. Burimet që ndodhen në internet janë mjaft të dobishme përsa u përket ndër-referimeve, për shkak të shpejtësisë me të cilën mund t'i gjesh në kompjuter.

Një tjetër burim i mirë për ndër-referimet është konkordanca jote biblike. Një konkordancë është e dobishme pasi ndonjëherë, fjala që do të përmendësh mund të mos jetë rreshtuar në kolonën e ndër-referimeve të përkthimit tënd të Biblës. Një tjetër mjet i dobishëm është një Bibël me referime zinxhir. Bibla e vetme me referime zinxhir që ndodhet në qarkullim është Bibla e Studimit ("the New Thomson Study Bible") në përkthimin LIM. Nuk ka të ngjarë që të jesh duke përdorur versionin KJV në studimin tend biblik, por ky vëllim me referime mund të jetë i dobishëm, sepse referimet e veta të hollësishme në pjesën anësore dhe indeksi i referimeve mund të të ndihmojnë të ndjekësh një temë të caktuar në të gjithë Biblën.

Si të bësh ndër-referimet

Për ushtrimin e parë të ndër-referimeve, kthehu përsëri te Gjoni 3. Në vargun e parë kemi fjalën “farise”, me të cilën kemi shpenzuar njëfarë kohe, prandaj le të fillojmë me të. Ne duam të dimë se çfarë na tregon Bibla te farisenjtë, pra ku përmendet, apo diskutohet ajo fjalë në Bibël? Filloj duke parë fjalën në Biblën e Studimit. Shqyrtoj me kujdes faqen anësore dhe zbuloj se fjala nuk është ndërreferuar as në Biblën LIM. Pra, hapi im vijues është t'i kthehem konkordancës sime biblike. Kërkoj fjalën “farise” në konkordancë dhe zbuloj një listë që më tregon të gjitha vargjet në Bibël ku gjendet ajo fjalë. Meqenëse konkordanca na jep shumë referime për “farisenjtë”, unë sugjeroj të fillosh me ato që ndodhen në librin që po studion, në këtë rast, librin e Gjonit. Pastaj, pas kërkimit të referimeve në ungjillin sipas Gjonit, shiko ato të librave të tjerë, të të njëjtit autor (Gjonit) dhe ato nga e gjithë Dhiata e Re. Nëse nuk ke kohë për të kontrolluar të gjitha referimet, përdor ato të shkruara nga i njëjti autor. Është

më mirë ta lësh atë të interpretojë fjalët e veta.

Ky lloj kërkimi është më i ndjeshëm në një burim interneti të tillë si Biblegateway.com, ku mund të zgjedhësh versionin tënd të Biblës, të shkruash fjalën që po kërkon dhe kërkuesi do të paraqesë një listë me të gjitha vargjet në Bibël që përmbajnë fjalën e dëshiruar. Në rastin e farisenjve, janë rreth 100 përdorime në Dhiatën e Re. Në ekranin tënd, mund t'u hedhësh një shikim të shpejtë vargjeve në ungjillin sipas Gjonit dhe të zgjedhësh ato që të japin informacion të dobishëm e pastaj t'i kopjosh e bashkëngjisësh në skicën tënde.

Ndërsa shikon këto vargje në ungjillin sipas Gjonit, do të gjesh disa të dhëna te farisenjtë: se disa prej tyre ishin anëtarë të këshillit të lartë (sinedrin) (Gjoni 11:47), kokëfortë për një interpretim rigoroz të ligjit (Gjoni 8:3), nuk besonin se Jezusi ishte Mesia (Gjoni 9:16) dhe shumë vargje tregojnë se ata e kundërshtonin Jezusin dhe donin ta ndalonin. Të gjitha këto të dhëna ndihmojnë për të krijuar një ide për qëndrimet e farisenjve dhe do të përfshish atë që lidhet me skicën tënde.

Të ndjekësh zinxhirin

Tani duam të bëjmë një ushtrim që tregon se si të bësh ndërreferimet nga shënimet në faqen anësore. Megjithëse kjo metodë është më e mërzitshme dhe e panevojshme nëse ke burime kompjuterike, e përfshij atë, pasi mund të doni të bëni studim biblik në rastet kur nuk mund të përdorni kompjuterin. Gjatë një udhëtimiti dy orësh me avion ose gjatë pritjes në aeroport ose në dhomën e mjekut. Nëse nuk ke me vete një kompjuter portativ, atëherë duhet të kesh të paktën një bibël dhe një bllok shënimesh. Mund ta bësh studimin e biblës, nëse bibla jote ka referime anësore. Për këtë ushtrim do të përdor *Biblën e Studimit*, meqë ky version i përfshin referimet anësore me numra të lartë. Siç kam vënë re më lart, ky version nuk ka referime anësore ndaj “farisenjve”, prandaj ne do të ndjekim fjalën “udhëheqës”. Kjo ka kuptim, sepse në skicën më të hershme, njëra nga pyetjet tona bazë ishte “kush janë udhëheqësit?”.

Në skicën tënde të referimeve, në kolonën e parë, shkruaj fjalën “udhëheqës”. Në vargun një, të shkruar në të majtë të fjalës “udhëheqës”, vër re gjermën më të epërme “b”. Pastaj shiko në faqen anësore, horizontal me vargun dhe gjeni “1”, që tregon ndërreferime ndaj vargut 1. Pastaj gjej gjermën më të epërme “b”. Pranë gjermës do të shohësh referimet, Luka 23:13 dhe Gjoni 7:26, 48.

25 ^aMateu 9:4; Gjoni
1:42, 47; 6:61, 64; 13:11

1 ^aGjoni 7:50; 19:39
^bLuka 23:13; Gjoni 7:26,
48

2 ¹Ose *duke dëshmuar
për mrekullitë* ^aMateu
23:7; Gjoni 3:26 ^bGjoni
2:11 ^cGjoni 9:33; 10:38;
14:10f.; Veprat 2:22; 10:38

3 ¹Ose, *prej së larti* ²
Korintasve 5:17; 1 Pjetrit
1:23 ^bMateu 19:24; 21:31;
Marku 9:47; 10:14f; Gjoni
3:5

KAPITULLI 3

Midis farisenjve ishte një njeri me emrin
^aNikodem, një ^bkre i judenjve.

2 Ky erdhi natën te Jezusi dhe i tha: “^aMësues,
ne e dimë që ti je mësues i ardhur nga Perëndia,
sepse askush nuk mund të bëjë ^{1b}shenjat, që bën
ti, në qoftë se ^cPerëndia nuk është në të”.

3 Jezusi iu përgjigj dhe i tha: “Në të vërtetë, në
të vërtetë po të them që nëse një nuk ^alind ¹përsëri,
ai nuk mund të shohë ^bmbretërinë e Perëndisë”.

4 Nikodemi i tha: “Si mund të lindë një njeri kur
është plak? A mund të hyjë ai përsëri në barkun e
nënës së vet dhe të lindë?”

Më tej, në skicën tënde ndër-referuese, në kolonën e majtë nën titullin “Ndër-referim” shkruaj Luka 23:13. Pastaj kthehu tek ai varg dhe lexoje “Atëherë Pilati mblodhi udhëheqësit e priftërinjve, kryetarët dhe popullin”. Çfarë tregon ky varg për udhëheqësit? Çfarë shikon si domethënese në interpretimin e kuptimit të “udhëheqësit”? Ne kuptojmë se Pilati i njihte farisenjtë si krerë të judenjve. Fakti që ai i thirri tregon se kishte njëfarë lidhjeje dhe ushtronte pushtet te ta. Pra, në kolonën e “domethënies” së skicës sate, horizontal me referimin Luka 23:13, shkruaj “Lidhjet me Pilatin”.

Ç’gjë tjetër gjejmë te Luka 23:13? Ne kemi dy grupe njerëzish që përmenden këtu; jo vetëm udhëheqësit, por edhe kryepriftërinjtë. Pra, në kolonën e “domethënies” nën “lidhje me Pilatin” në skicën tënde, shkruaj: “kategori” dhe nën të “kryepriftërinjtë”. Çfarë kategorie tjetër udhëheqësish njohim? Farisenjtë. Kemi mësuar tashmë mjaft për ta dhe e dimë se janë një nga llojet e udhëheqësve çifutë, prandaj nën “kategoritë” shto “farisenjtë” nën “kryepriftërinjtë”.

Tani do të ndjekim shkurtimisht zinxhirin e referimeve për të treguar se si funksionon procesi. Vër re se te Luka 23:13, gërma e vogël e epërme “a” gjendet menjëherë pas në të majtë të fjalës “udhëheqës”.

12 ^aVeprat e Apostujve
4:27

13 ^aLuka 23:35; Gjoni
7:26, 48; 12:42; Veprat e
Apostujve 3:17; 4:5, 8;
13:27

13 Dhe Pilati, si mblodhi ^akryepriiftërinjtë,
udhëheqësit dhe popullin,

14 dhe u tha atyre: “Ju më prutë këtë njeri si
^açoroditës të popullit; dhe ja, unë, pasi e hetova
para jush, nuk ^bkam gjetur te ky njeri asnjë nga
fajet për të cilat ju e paditni”.

Kërko “a” -në korresponduese pranë “13” në faqen anësore dhe do të gjesh një referim te Luka 23:35. Shkruaj Luka 23:35 në kolonën e “ndër-referimeve” të skicës sate, pastaj ktheju vargut dhe lexoje: “Dhe populli rrinte aty për të parë; dhe kryetarët me popullin e përqeshnin duke thënë: “Ai i shpëtoi të tjerët, le të shpëtojë veten nëse është vërtet Mesia, i zgjedhuri i Perëndisë”. Çfarë mësojmë për udhëheqësit në këtë varg? Ata po përqeshnin Jezusin, sepse e përbuznin. A do të thotë kjo se hamendja jonë rreth faktit se Nikodemi erdhi te Jezusi pasi u err ishte e saktë? A kishte frikë ai nga ç’do mendonin bashkëpunëtorët e tij po ta shikonin me një person, të cilin udhëheqësit e tjerë nuk e besonin dhe e përbuznin? Vër re se ky varg ka një gërmë të lartë që tregon një tjetër ndër-referim për fjalën “udhëheqës”. Por, kur i hedhim një sy referimit në faqen anësore, shohim se na kthen te Gjoni 3:1, pikërisht aty ku filluam. Kjo na tregon se kemi arritur fundin e zinxhirit të referimeve për këtë fjalë të caktuar, megjithëse në shumë fjalë të tjera zinxhiri mund të vazhdojë më gjatë.

Por nuk kemi mbaruar ende me këtë fjalë. Kur vështruam vargun e ndër-referuar, Luka 23:13, ndoqëm vetëm një nga referimet shtesë që jepen aty.

Tani, le të shohim të tjerat. Po të kesh kohë, kërko të gjitha referimet që gjenden për Lukën 23:13, para se të kthehesh te Gjoni 3:1, ku filluam.

Referimi vijues për Lukën 23:13 është Gjoni 7:26. Në kolonën e ndër-referimeve të skicës, shkruaj “Gjoni 7:26” e pastaj kthehu te vargu dhe lexoje: “E megjithatë ja, ai po flet lirisht dhe nuk i thonë asgjë; mos udhëheqësit e kanë njohur me të vërtetë se ai është Mesia?”. Cila është domethënia e këtij pasazhi? Është e qartë se udhëheqësit çifutë nuk ishin në dijeni të faktit që Jezusi ishte Mesia, ndërsa njerëzit ndoshta mendonin se ata duhet ta dinin, por po e shpërfillnin qëllimisht të vërtetën e dukshme. Sidoqoftë, nga kjo pjesë mund të shohim se udhëheqësit e judenjve nuk besonin se Jezusi ishte Mesia. Në kolonën e “domethënies” së skicës, shkruaj: “Udhëheqësit nuk i besonin Jezusit”.

Referimi vijues ndaj Lukës 23:13 është Gjoni 7:48, ku lexojmë: “Mos vallë ndonjë nga udhëheqësit apo nga farisenjtë besoi tek ai?” Çfarë shikon këtu? Ky pasazh na tregon se udhëheqësit e judenjve nuk ishin në dijeni se dikush mes tyre besonte te vërtetësia e Jezusit. Dukej se, nëse dikush prej tyre besonte, e mbante të fshehtë e kjo përforcon supozimin tonë se Nikodemi kishte frikë të qëndronte në kundërshtim me udhëheqësit e tjerë, sepse mund të huteste pozitën e tij të lartë dhe të përjashtohej nga sinagoga. Pra, në kolonën e “domethënies”, nga ana tjetër te Gjoni 7:48, shkruaj: “Nikodemi kishte frikë të fliste për lidhjen e tij me Jezusin”.

Referimi vijues ndaj Lukës 23:13 tregon se nuk hamendësojmë aspak kur e interpretojmë v.48 ashtu si bëmë më lart. Në këtë referim, Gjoni 12:42, lexojmë: “Megjithatë, edhe midis udhëheqësve, shumë besuan në të; por për shkak të farisenjve, nuk e rrëfenin, për të mos qenë të përjashtuar nga sinagoga”. Duket se dyshimet tona po miratohen. Me sa duket, Nikodemi ishte një nga udhëheqësit që besonin, por e mbante fshehur për të mbrojtur pozitën. Kjo pa dyshim shpjegon pse Nikodemi erdhi natën te Jezusi. Farisenjtë kishin pushtet kur ishte fjala për çështje fetare dhe mund të dëbonin nga sinagoga këdo që besonte se Jezusi ishte Mesia. Një sërë krerësh besonte te Jezusi, por pa e pranuar haptazi.

Në kolonën e referimeve të skicës, shkruaj Gjoni 12:42, pastaj në atë të domethënies, shkruaj: “Shumë krerë besonin te Jezusi, por nuk e shpallnin nga frika se mos farisenjtë i dëbonin nga sinagoga”.

Rrallë ndiqen më shumë se tre breza ndër-referimesh nga origjinali. Zakonisht është koha që ndikon si faktor kryesor. Megjithatë, kam vënë re se tri referime ma japin informacionin e nevojshëm. Nëse jo, do të vazhdoj në një rast të caktuar, por kjo rrallëherë është e nevojshme.

Kur të kesh mbaruar me të gjitha referimet e mëtejshme ndaj Lukës 23:13, kthehu te Gjoni 3:1 dhe kërko referime shtesë. Referimi tjetër për Gjonin 3:1 është Gjoni 7:48, që ne e kemi zbuluar tashmë. Kështu, na kanë shteruar ndër-referimet ndaj këtij pasazhi.

Në shembullin e Skicës Ndër-referimi në Shtojcën B, në faqet 126-127 jepet një model i një skice referimesh, përgatitur nga një student. Vëre se ky student ka shkruar pak më larg se ne gjatë demonstrimit, duke shtuar tre ndër-referime nga Veprat. Nëse ke kohë të shkosh pak më tutje, do të të vlejë.

Konteksti

Te shqyrtimi i kontekstit, si ndër-referimi është edhe një mënyrë tjetër për të lejuar Biblën të vetëinterpretohet, por ndyshe nga të ndjekurit të një fjale, ose ideje në Bibël, me kontekstin ne qëndrojmë më afër duke e shqyrtuar fjalën ose vargun brenda *kontekstit* të vargjeve paraprirëse dhe atyre pasuese.

Konteksti mund të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi shumë gabime biblike mund të lidhen me mosshqyrtimin e kontekstit. Duke përzgjedhur vargje dhe duke shpërfillur kontekstin, ti merr nga Bibla atë që do.

Mund ta bësh Biblën të thotë atë që dëshiron ti. Sipas një tregimi të lashtë, një person u ndesh rrugës me një besimtar tjetër të kishës dhe konflikti arriti deri në një urrejtje të flaktë. Me Biblën në dorë, ai iu afrua kundërshtarit dhe i tha: “Ja çfarë të urdhëron Bibla” dhe duke u kthyer te Mateu 27:5, lexoi: “Dhe ai, pasi i hodhi siklat prej argjendi në tempull, u largua dhe shkoi e u var në litar”. Pastaj iu kthye te Luka 10:37 ku lexoi: “Shko dhe bëj kështu edhe ti”.

Shumë keqkuptime dhe keqinterpretime biblike mund të zgjidhen duke shqyrtuar kontekstin. Për shembull, kam parë studentë që pasi kanë lexuar Palin dhe Jakobin rreth temës së besimit dhe veprave, supozojnë se dy autorët kundërshtojnë njëri-tjetrin. Te Jakobi 2:17 lexojmë se besimi pa vepra është i vdekur e megjithatë te Galatasve 3, Pali pohon se besimi e jo veprat është i vetmi mjet i shpëtimit. Pra, besimi apo veprat? A kundërshton vetveten Shkrimi në këtë rast? Jo, aspak. Kontradikta në dukje vjen për shkak të veçimit të vargjeve nga konteksti. Kur Pali flet për besimin te Galatasve, ai e lidh atë me shpëtimin, sepse besimi te Krishti është mjeti ynë i të treguarit të varësisë ndaj tij, si rrjedhojë është dhe mjeti i pranimit të shpëtimit. Kurse Jakobi, nga ana tjetër, nuk flet për shpëtimin, por për shenjtërimin. Ai po flet për jetën e të krishterit. Thotë se besimi i vërtetë nuk është thjesht një shpallje e tij, por qëndrimi, i cili ka të bëjë me atë që themi edhe bëjmë. Në fakt, Jakobi thotë “Fjalët janë të lira, ti thua se ke besim, por provoje me veprimet e tua”.

Pali dhe Jakobi nuk e kundërshtojnë njëri-tjetrin. Kur shikon kontekstin, mund të shohësh se si theksimet e ndryshme na japin së bashku një tablo më të plotë nga sa jep një i vetëm.

Për të treguar se çfarë zbulon konteksti, le të shohim edhe një herë Gjonin 7:48, një pjesë me referime që shqyrtuam më lart. Në këtë varg

thuhet: “Mos vallë ndonjë nga udhëheqësit apo farisenjtë besoi në të?”. Duket se, nëse ndonjë nga farisenjtë, ose udhëheqësit çifutë besonte te Jezusi, ata e mbanin të fshehtë dhe grupi nuk dinte gjë për të. Por ky varg e shpalos kuptimin e plotë ndërsa vazhdojmë të lexojmë. Supozimi që nuk kishte besimtarë ndër çifutët është i gabuar. Në vargun vijues shohim se kishte së paku një person ndër ta që e admironte Jezusin. Zëdhënësit e judenjve vazhduan duke thënë:

“Por kjo turmë që nuk e njuh ligjin, është e mallkuar”.

Nikodemi, një prej tyre, i cili natën kishte shkuar te Jezusi, u tha atyre:

“Mos vallë ligji ynë dënon një njeri para se ta ketë dëgjuar dhe ta dijë ç’ka bërë?”.

Ata u përgjigjën dhe i thanë: “Mos je edhe ti nga Galileja? Hulumbo Shkrimet dhe do të shohësh se nga Galileja s’do të dalë Profeti”.

Udhëheqësit e judenjve theksojnë se askush nga farisenjtë e ditur nuk besonte te Jezusi, por vetëm turmat vulgare që farisenjtë i përbuzin si të marrë, të kufizuar në njohje dhe si rrjedhim, të mallkuar për këtë shkak. Atë çast, ndërgjegjja e Nikodemit duhet të ketë qenë sëmbuar. Ai ndërhyr me një orvatje mbrojtëse të Jezusit, duke u kujtuar udhëheqësve se ligji ndalon gjykimin e dikujt pa shqyrtuar mirë në një gjyq të drejtë gjithçka që thotë dhe bën. Por udhëheqësit e tjerë iu drejtuan me zemërim Nikodemit, duke aluduar se ishte bërë palë me Jezusin dhe nuk e kishte studiuar mirë profecinë, ndaj dhe nuk e dinte se Mesia nuk mund të vinte nga Galileja.

Vër re se si reagon Nikodemi ndaj kësaj padie të inatosur. Ai heshti dhe nuk foli fare për takimin me Jezusin natën. Mund të kishte thënë se kishte shkuar dhe kishte folur me këtë njeri, se ai është më i arsyeshëm nga ç’mendonin ata, të tregonte bisedën që kishin bërë, por nuk tha asgjë. Bëri sikur nuk e kishte takuar kurrë Jezusin. Ne mund të hamendësojmë lehtë se Nikodemi kishte frikë t’i kundërshtonte udhëheqësit e tjerë sepse do të humbiste pozitën e lartë dhe do të dëbohej nga sinagoga.

Ja, sa mund të mësohet nga një varg referimi brenda kontekstit të vet. Shkruaji zbulimet e kontekstit në fletën e interpretimit.

Detyrë

1. Zgjidh një fjalë nga Gjoni 1 dhe përpilo një skicë referimesh tek ajo.
2. Zgjidh një pjesë dhe lexo vargjet e lidhura para dhe më pas. Pastaj shkruaji zbulimet në fletën e interpretimit.

8

KËRKO JASHTË BIBLËS

duke përdorur burime jashtëbiblike

Bibla interpreton veten, por të dhënat që nevojiten për të fituar njohje rrënjësore të Librit duhet të vijnë nga burime të tjera. Gjatë shekujve, ekspertët që mbështeten në tekste historike, arkeologji dhe shkrimet e të krishterëve të hershëm kanë formuluar vëllime me informacion të shkëlqyeshëm rreth Biblës, të cilat mund t'i përftohsh me anë të librave dhe burimeve kompjuterike. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë disa prej këtyre burimeve dhe do të jap një përmbledhje rreth përdorimit të tyre.

Për të treguar si ta bëjmë interpretimin, do të vazhdojmë të përdorim Gjonin 3, këtë herë vargjet 1-10. Pra, në Fletën Interpretuese, shkruaj atë referim nën titullin. Do të plotësosh të dhënat që ke marrë nga ai pjesë, në hapësirën nën të. Më vonë, do t'i referohesh kësaj skice për interpretimet e tua të pasazheve dhe fjalëve, kur të bësh skicimin përfundimtar.

Përkufizime

Mënyra më e dobishme për të interpretuar një fjalë nga Bibla, pra, për t'i njohur kuptimin, është ta kërkosh atë në një fjalor. Sugjeroj që të fillosh me një fjalor të përgjithshëm. Shpesh fjalorët e zakonshëm do të të japin përkufizimin e fjalës që po kërkon.

Një tjetër burim për përkufizimet është një fjalor biblik. Zakonisht një fjalor biblik do të të japë një përkufizim më të zgjeruar biblik se sa një fjalor i përgjithshëm. Ka disa fjalorë të mirë biblikë, të cilët do t'i përmend në shtojcën C, udhëzuesin e veçantë informativ. Një fjalor i mirë nuk të jep vetëm përkufizimin dhe sfondin e një fjale, por edhe përdorimet në Dhiatën e Vjetër dhe në Dhiatën e Re.

Kur kërkon fjalë në fjalorë është mirë të kërkosh antonimet, ose fjalët me kuptim të kundërt. Shpesh antonimet ndihmojnë në

përkufizimin e njëra-tjetrës. Për shembull, kur kërkon fjalën “dashuri”, kërko edhe fjalën “urrejtje”. Kur kërkon “farise”, kërko edhe fjalën “saduce”. Për fjalën “mësues”, shiko edhe “edukim”, madje “edukim judaik”. Gjurmë të tilla do të zgjerojnë dhe mprehtësojnë njohurinë tënde të temës.

Përkthime dhe parafrazime nga Bibla

Burimi vijues për të shqyrtuar janë përkthimet e Biblës, përveç asaj që përdoret zakonisht. Krahasimi i fjalëve të ndryshme përdoret për të dhënë një pikëpamje të re të temës dhe për të hapur sytë ndaj interpretimeve të zgjeruara. Sugjeroj që të shikosh përkthime të ndryshme si dhe një parafrazim. Tani është në qarkullim një parafrazim (ose më mirë një përkthim dinamik): Bibla ECM.

Po të jap një këshillë për përdorimin e parafrazimeve. Mos e bazo doktrinën tënde te një parafrazim. Shpesh parafrazimet bëhen nga një person i vetëm dhe, sado të mira të jenë, do të pasqyrojnë në mënyrë të pashmangshme pikëpamjet e tij. Për doktrinë kërko një përkthim të mirë, të formuluar nga një komitet i përbërë ekspertësh të respektuar.

Libra referimesh

Sot ka shumë burime të tjera për të kërkuar fjalë, ide, tregime biblike dhe të dhëna për jetën, mendësinë dhe qëndrimet në kohën biblike. Do të përmend disa prej tyre më poshtë. Ata përfshijnë studime biblike, enciklopedi biblike, komentare, atlasë dhe studime fjalësh. Këto materiale na japin idetë studimore të ekspertëve dhe vrojtimit e njerëzve që kanë shpenzuar gjithë jetën për kërkime dhe studime për tema që mund të mos jemi në gjendje t'i zbulojmë. Shpesh, libra të tillë mund të sigurojnë të dhëna të larmishme që janë mjaft të dobishme për të sjellë njohje dhe qartësi ndaj fjalëve dhe pasazheve biblike.

Kam ndeshur shumë njerëz që këmbëngulin se nuk do të përdorin asgjë tjetër në studimin e tyre përveç vetë Biblës. Ata besojnë se nëse dikush “udhëhiqet nga Shpirti”, nuk ka pse të varet nga libra të tjerë për të kuptuar Biblën. Unë besoj se pikëpamja e tyre është e gabuar, sepse vetë Bibla e bën të qartë se Perëndia na ka dhënë mësues, si dhe të krishterë të tjerë me dhunti të veçanta që synojnë të ndërtojnë kishën dhe të forcojnë besimtarët. Sa herë që dëgjojmë një predikues në një kishë, ose një mësues të Biblës në një grup të vogël mësimi, “kemi dalë jashtë Biblës” për të mësuar se çfarë ka për të thënë një tjetër te atë që thotë Shkrimi. Nuk ndryshon nga rasti kur një mësues e hedh njohurinë e vet në një libër që ne ta lexojmë, në vend që të na

e japë gojarisht. Gjatë shekujve, shumë të krishterë të devotshëm kanë përpiluar shkrime që mund të jenë mjaft të vlefshme për të mësuar më shumë te mësimet e Biblës.

Ja një listë me disa lloje ndihmesash jashtëbiblike që mund t'i konsiderosh të dobishme:

Studime biblike. Një Bibël për studime është një nga mjetet më të dobishme të studimit që ke në dispozicion. Ato përmbajnë të dhëna aq të larmishme, sa nuk do t'i njihje dot pa qenë mësues i Biblës, ose student serioz. Një studim i mirë i Biblës mund të zëvendësojë shumë prej llojeve të referimeve të librave të përmendura këtu. Studime të tilla përfshijnë një komentari të shkurtër biblik, hyrje në librat e Biblës dhe përmbledhje të tyre, skica, harta, grafikë, kolona anësore, shënime tekstuale në fund të faqes, referime zinxhir, fjalorë, konkordanca dhe të dhëna të tjera ndihmuese që mund të shmangin shpesh nevojën për t'iu drejtuar burimeve të tjera. Shumë studime biblike programohen përreth një teme të caktuar. Për shembull, studime biblike për burrat, gratë dhe studime zbatuese. Ka dhe studime të bazuara te profeci, luftë shpirtërore, ose fitim njerëzish për Krishtin. Dhe ka vazhdimisht studime të reja në qarkullim. Duhet t'i shqyrtosh mirë dhe të zgjedhësh atë që u përgjigjet më mirë nevojave.

Po të tregoj shkurtimisht një shembull të një studimi biblik që është në përdorim. Në *Biblën e Studimit*, mund të shikojmë tek Indeksi i Shënimeve në pjesën e pasme dhe të shikojmë një fjalë. Le të përdorim një që e njohim mirë, fjalën “farisenj”. Përveçse na jep një listë me vargje që përmbajnë shënime te farisejtë, indeksi na tregon se ka një skicë për ta. Pastaj shohim se skica ka një përkufizim të shkurtër të farisenjve dhe saducenjve, bashkë me dy kolonat që shfaqin karakteristika pozitive dhe negative të secilit grup. Brenda përkufizimit dhe dy listave, ne shohim qartë kush ishin farisenjtë, çfarë besonin dhe si sillleshin. Nga këto përshkrime shohim më qartë pse e kundërshtonin Jezusin me aq zell. Të dhënat që mbledh nga një studim biblik mund t'i vësh në Fletën e Interpretimeve.

Studime të Fjalës. Për studentët seriozë, ose mësuesit biblikë, një libër studimi fjalësh do të jetë i dobishëm për shkak të informacionit të detajuar që siguron te fjalë të caktuara. Jo vetëm që përfiton një përkufizim, por edhe sfondin kulturor të fjalës, përdorimin e saj në atë kulturë dhe historinë e saj. Preferenca ime për librat e studimit të fjalëve është *Biblën e Studimit*.

Hartat. Hartat biblike, si për shembull në Bibën e Studimit, të ndihmojnë që të krijosh një ide te lëvizjet dhe udhëtimet e karaktereve

dhe njerëzve të Biblës. Për shembull, gjatë studimit të Gjonit 4, ku na thuhet se Jezusi me dishepujt duhet të linin Judenë dhe të udhëtonin përmes Samarisë për të shkuar në Galile, një atlas do të të ndihmojë të vizualizosh udhëtimin e tyre duke të treguar lidhjen e tre sferave gjeografike dhe kilometrat që duhet të përshkonin. Hartat shërbejnë edhe për të treguar ndryshimet në kufijtë politikë gjatë shekujve. Një hartë e Palestinës në kohën kur filloi të banohej nga dymbëdhjetë fiset e Izraelit, është e ndryshme nga i njëjti rajon nën pushtimin romak, në kohën e Krishtit. Atlasët mund të të tregojnë gjerësinë e perandrive të mëdha, në historinë e Biblës, asaj egjiptiane, asiriane, babilonase, perse, greke dhe romake. Mund të kuptosh më shumë te vështirësitë e Palit gjatë udhëtimit të tij, nëse i studion udhëtimet e tij në një hartë të shekullit të parë.

Ndonjëherë një hartë mund të sigurojë çelësin thelbësor për të hapur kuptimin që ke rreth një pasazhi, ose libri biblik. Për shembull, pa hartë zor se mund të arrish një kuptim të qartë të librit të Jozueut. Vetëm duke iu referuar një harte, gjatë leximit të pushtimit të Kanaanit, mund të vlerësosh strategjinë e shkëlqyer të luftës nga ana e Jozueut. Gjenerali i Luftës së Dytë Botërore, MekArtur dhe gjenerali izraelit, Moshe Dajan, e admironin gjeneral Jozueun dhe studionin planin e tij të pushtimit të Kanaanit. Mund ta marrësh me mend se, ndërsa ata lexonin librin e Jozueut, njëkohësisht ndiqnin lëvizjet e tij ushtarake në hartë.

Të gjitha studimet biblike dhe madje, shumë versione të Biblës, përmbajnë shumicën e hartave që do të nevojiten. Por mësuesit dhe studentët seriozë mund të shqyrtojnë një atlas si një burim shtesë për një informacion më të thellë dhe të hollësishtëm nga ana gjeografike.

Enciklopedi. Si Fjalori enciklopedik shqiptar ashtu edhe ato biblike, janë mjete informative të dobishme, sepse mund të sigurojnë të dhëna për historinë biblike, gjeografinë, kulturën, njerëzit, veprat e artit dhe arkeologjinë. Sigurisht që një enciklopedi biblike është më e fokusuar dhe e detajuar te tema biblike se sa një enciklopedi e përgjithshme. Një studim i mirë biblik mund të të sigurojë një pjesë të mirë të asaj që do të gjesh në një enciklopedi biblike, ndonëse jo me të njëjtën thellësi e hollësi.

Komentarë. Një komentari biblik përbëhet nga komentet e një eksperti që shpjegon kuptimin e pasazheve biblike. Mund të jenë të thelluar, vepra shumëvëllimshme varg për varg, ose komentare njëvëllimësh të gjithë Biblës, duke trajtuar temat bazë të kapitujve dhe duke trajtuar disa vargje kryesorë. Një tipar bazë i studimeve biblike është se të gjitha kanë një komentari funksionues që shoqëron tekstin.

Sigurisht që, sa herë që përdorim një komentari, duhet të kemi parasysh se po lexojmë pikëpamjen e një autori të vetëm. Këta autorë janë njerëzorë dhe të aftë për të gabuar, njësoj si edhe ne. Duhet të jemi gjithmonë vigjilentë, që të krahasojmë atë që mësojnë komentaret me atë që vëzhgojmë vetë në Bibël.

Libra tematikë. Libraritë e krishtera janë plot me libra për çdo temë që do të mësohesh në hollësi. Mund të blesh libra akademike, ose libra të njohur te tema të tilla si shfaqjesimi, shpengimi, shpëtimi, shenjtërimi, jeta e krishterë, Perëndia, Shpirti i Shenjtë, Jezusi, ose për çfarëdo tjetër. Nëse fokusi yt i studimit biblik është një temë e veçantë, shiko në librarinë lokale për burimet më të mira të disponueshme.

Burime kompjuterike. Disa herë në këtë libër kam aluduar për burime kompjuterike që u disponohen tashmë studentëve të Biblës, si në internet ashtu edhe në programe që mund t'i instalosh në kompjuter. Shumë prej këtyre burimeve kompjuterike mund të zëvendësojnë shumicën e librave që kam përmendur më lart. Një shembull i shkëlqyeshëm i një burimi në internet është ai që kam përmendur, Biblegateway.com, që është i mrekullueshëm për të gjetur pasazhe specifike të Shkrimit dhe referime ndërlidhëse. Ky burim mahnitës përmban tekstin e plotë të çdo përkthimi kryesor të Biblës që qarkullon sot në treg. Madje, edhe duke shkruar referimin nga shkrimi, ose një a dy fjalë, mund ta përdorësh si konkordancë, ose të shikosh tekstin e çdo vargu në çfarëdo varianti të Biblës. Dhe me burimet kompjuterike reagimi është i menjëhershëm. Jo vetëm që kursen kohën për të kthyer fletët, por edhe për të shkruar pasazhin. Thjesht mund ta kopjosh dhe ta bashkëngjisësh në dokument.

Një shembull i shkëlqyeshëm i programeve biblike që mund të instalosh është iLumina Gold. Ky program mund të zëvendësojë shumë mirë çdo libër që kam përmendur më lart. Përmban një fjalor biblik, një enciklopedi biblike, tekstin e plotë të Biblës në katër përkthime me një sërë mënyrash për ta arritur, ndihmesa studimore të Biblës, skica, harta dhe komentare. Ka dhe shumë elemente pamore, ku përfshihen edhe fotografi, ilustrime, pamje të animuara të disa ngjarjeve biblike dhe të dhëna arkeologjike.

Le të shohim ç'mund të bëjë iLumina duke përdorur fjalën "farise". Nga faqja kryesore, kalo tek Enciklopedia. Kliko te kutia "të gjithë artikujt" në fund të faqes dhe do të gjesh një listë me tema dhe një kuti për të shkruar fjalën që po kërkon. Shkruaj "farise" dhe menjëherë do të shfaqet një artikull i tërë te farisenjtë dhe saducenjtë, me të dhëna të ndara në këto nënkategori: Farisenjtë në Dhiatën e Re, Zanafilla e

Farisenjve dhe Karakteristikat Bazë të farisenjve. Pastaj pason i njëjti informacion te saducenjët. Nëse ka më shumë informacion se ç'dëshiron, një kuti përmbledhëse në të djathtë të faqes të jep "Faktet e shpejta" te farisenjtë dhe i krahason me saducenjët. I gjithë informacioni vihet para syve të tu brenda pak sekondash. Kur t'i gjesh përkufizimet që dëshiron, kopjoji, bashkëngjiti në Fletën e Interpretimit dhe dokumento burimet.

Formimi i interpretimit te themelin e vëzhgimit

Për të treguar se si interpretimi formohet te vëzhgimin, i referohem vëzhgimeve te kontrasteve midis Jezusit dhe gruas samaritane te Gjoni 4, që zbuluam te kapitulli 5 i këtij libri. Gjatë procesit të vëzhgimit ne bëmë pyetjet bazë dhe të lidhjeve e disa vëzhgime, nga të cilat përpilova skicën e thjeshtë në faqen 40. Kur të ndërmarrësh hapin e interpretimit, do të shkosh një hap më tej vëzhgimit të thjeshtë.

Ti do të bësh pyetjet te ndryshimet e vëzhguara midis Jezusit dhe gruas samaritane që dolën në kapitullin 5, të cilave nuk mund t'u përgjigjeshim me anë të vëzhgimit: "Çfarë kuptimi kanë këto ndryshime? Si ndikojnë te lidhja dhe komunikimi? A krijojnë pengesa, apo nuk janë domethënëse?". Në kulturën e Palestinës së shekullit të parë, të gjitha ndryshimet ishin të rëndësishme dhe secili krijonte një pengesë midis tyre derisa e bënte të pamundur çdo lloj komunikimi. Për t'i hequr këto pengesa, duhet të kthehesh te pyetja "Çfarë?". Shiko çdo ndryshim të vëzhguar dhe pyet: "Ç'ndryshim do të krijojë kjo pengesë midis Jezusit dhe gruas samaritane?".

Tani duhet të dish më shumë për hollësitë e kulturës së shekullit të parë nga sa të jep Bibla. Do të të duhen disa nga ndihmesat e jashtme të lartpërmendura për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Një enciklopedi biblike, një studim biblik, një program kompjuterik studimi biblik, ose faqe interneti biblike mund të të japin informacion rrënjësor që do të të ndihmojë të kuptosh të gjitha pengesat midis Jezusit dhe gruas samaritane dhe arsyen e ekzistencës së tyre.

Më poshtë ke disa fakte që kam mbledhur nga burime të tilla.

Fakti që gruaja ishte një mëkatore e njohur dhe Jezusi ishte i pamëkatë, krijonte një pengesë morale. Çifutët nuk shoqëroheshin kurrë me një kurorëshkelëse, ose prostitutë. Kurse fakti që ajo ishte grua dhe ai burrë, krijonte një pengesë sociale. Në kulturën hebraike të asaj kohe, burrat e gratë nuk përziheshin nga ana sociale as publikisht, aq më pak privatisht. Prandaj lexojmë në vargun 27 që, kur dishepujt u kthyen nga porosia e tyre, u habitën që Jezusi kishte folur me një grua.

Fakti që gruaja ishte samaritane kurse Jezusi çifut, krijonte një pengesë racore. Çifutët i përbuznin samarianët sepse i shihnin si një racë e papastër prej gjaku çifutësh, përzier me asirianë dhe raca të tjera të dëbuara që nuk kishin të bënin fare me ta. Dhe si samaritane, kjo grua ishte e besimit samarian, që çifutët e shihnin si prishje të judaizmit të tyre. Samarianët përdornin vetëm pesë librat e parë të Dhiatës së Vjetër si bibël. Ata nuk adhuronin në Jerusalem, si të gjithë çifutët, por në malin Gerizim, në vendlindje. Ky ngatërrim i Shkrimit dhe ndryshimet e adhurimit i bënte që çifutët të urrenin samarianët. Pra, edhe një tjetër pengesë e krijuar nga feja. Sigurisht që kjo grua jetonte në Samari, një vend që çifutët e përbuznin, që nga zhdukja e popullsisë dhe risistemimi i vendit nga ana e asirianëve, para shtatë shekujve. Pra, me kombësitë e tyre të veçanta, gruaja dhe Jezusi ndeshnin edhe një pengesë politike.

Duke zgjeruar skicën, shtova një kolonë në të djathtë, që tregon kuptimin e ndryshimeve, ose interpretimet që kam gjetur nga burime të jashtme.

Ndryshime

Gruaja	Jezusi	Pengesa
1. Gruaja kurorëshkelëse	Biri i Perëndisë, Rabin	Morale
2. Grua	Burrë	Sociale
3. Raca njerëzore	Çifut	Racore
4. Feja samaritane	Judaizmi	Fetare
5. Nga Samaria	Nga Judeja	Politike

A të ka bërë përshtypje materiali që kemi mbledhur deri tani? Shumë studentë befasohen vazhdimisht nga ajo që u zbulon Bibla, vetëm nëse bëjnë pyetjet e duhura dhe kërkojnë një ndihmesë të vogël interpretuese nga jashtë.

Synimi: Interpretimi

Qëllimi përfundimtar në përdorimin e të gjitha këtyre burimeve është një kuptim më i qartë i Biblës. Kjo nuk do të thotë vetëm të bësh vëzhgime rreth asaj që thotë Bibla, por edhe të interpretosh atë që thuhet, duke u dhënë kuptim fjalëve dhe ngjarjeve, që do të sigurojnë

një njohje rrënjësore të sfondit, kontekstit, koncepteve dhe kuptimit të tyre.

Siç e kam thënë në këtë libër, sugjeroj që të fillosh me Biblën e ta lësh librin të interpretojë veten. Merr kuptimin e mundshëm, duke bërë pyetje rreth vargut nën shqyrtim dhe shënoji vëzhgimet e tua. Pastaj fillo të lidhësh referimet dhe shiko në pasazhin, sipas kontekstit, por do të vësh re se në një vend të caktuar, pasazhi do të ngrejë më shumë pyetje, të cilave s'mund t'u përgjigjet një vëzhgim i thjeshtë. Do të të duhen burime të jashtme për të dhënë interpretimin e nevojshëm.

Për shembull, kur lexoni për Neheminë, i cili ishte kupëmbajtës i perandorit, çfarë nënkupton? A ishte thjesht një shërbëtor i përlulur, apo person në pozitën e lartë të kupëmbajtësit? Vetë teksti të jep të dhëna për përgjigjen, por duhet një burim i jashtëm për të siguruar rezultatet e kërkimeve historike, që të tregojnë se kupëmbajtësi, në kulturën e perandorisë së lashtë persiane, ishte një pozicion i rëndësishëm. Ky lloj informacioni e zgjeron kuptimin tënd për Neheminë, por kjo nuk buron nga Bibla. Po, fillo me Biblën dhe kthehu gjithmonë tek ajo, por mos ngurro të përfshish përdorimin e burimeve të jashtme për të zgjeruar kuptimin tënd.

Ndërsa shqyrton disa prej burimeve, do të zbulosh se skicimet e librave dhe pasazheve biblike disponohen në shumë prej tyre. Tani ti mund të ngresh pyetjen: “Pse duhet ta marr mundimin të bëj skicat e mia kur mund ta mbledh informacionin lehtësisht nga burimet e ndryshme?”. Menjëherë më vijnë në mendje dy arsye. Së pari, ti do që lënda të jetë e jotja. Nëse mbështetesh vetëm në punën e të tjerëve, pa bërë kërkimin tënd, njohja nuk do të ngulitet thellë. Kur bën punën duke bërë pyetjet, ndjekur referimet, parë përkufizimet dhe gërmuar për të dhënat bazë, njohja “ngjit” dhe bëhet e jotja. E mban mend më lehtë. Kjo lloj njohjeje e ngulitur që mbahet mend vlen shumë, sidomos kur je mësues i Biblës. Leksionet e tua do të jenë të pasura dhe më shumë nga zemra, do të kesh një avantazh të madh kur studentët të të pyesin, nga burimi i të dhënave të tua personale, mund të nxjerrësh dhe të japësh përgjigje të sakta dhe të dobishme.

Së dyti, kur të bësh kërkime për të gjetur informacionin tënd dhe të formulosh skicat dhe përmbledhjet, mësimi yt do të jetë unik, do të kesh ide që askush tjetër nuk i ka. Mësimi yt do të jetë i freskët dhe krijues. Nuk do të jetë diçka e mërzitshme dhe monotone, që gjen në një libër dhe e imiton si papagall në orën e mësimi, por do të jetë inkurajuese dhe frymëzuese për të tjerë.

Sigurisht që duhet të mbështetesh në punën e të tjerëve që kanë paraprirë, sepse do të ishte marrëzi e kundërta, por, duke marrë nga shumë burime, ti mbledh njohjen në një mënyrë ndryshe nga të tjerat dhe kjo lloj freskie do të jetë e ndryshme kur të japësh mësim.

Siç thotë thënia e vjetër: “Kur ke vjedhur nga një burim quhet plagjiaturë, por kur vjedh nga shumë burime, quhet krijimtari”.

Detyrë

1. Gjej një fjalë kryesore te Gjoni 1 dhe përkufizoje atë. Vëre përkufizimin në Fletën e Interpretimit.
2. Lexo një pjesë të përzgjedhur të Gjoni 1, në dy përkthime dhe një parafrazim. Shëno çdo ide interpretuese që mbledh në Fletën e Interpretimit.
3. Me anë të një enciklopedie, ose burimi biblik kompjuterik, kërko fjalën e përkufizuar më lart dhe shëno zbulimet e tua domethënëse në Fletën Interpretuese.

9

PRODUKTI YT PËRFUNDIMTAR

Skicimi i zbulimeve të tua gjatë studimit të Biblës

Nëse i ke përpiluar të gjitha skicat paraprake dhe ke plotësuar detyrat e këtij libri, fletorja jote e shënimeve tashmë është plot me materiale që përmbajnë të dhëna të fituara me vështirësi. Këto të dhëna, sado të dobishme, nuk ndodhen ende në një renditje të dobishme. Mund të kesh shënime rreth kulturës në faqen x, ndërsa përkufizimet e fjalëve janë shpërndarë kuturu. Shënimet dhe skicat ndrisin me perlat e njohjes, por tashmë është një përzjerje, pa renditje logjike.

Hapi pasues është i qartë dhe i natyrshëm. Ne e marrim këtë lëndë dhe e organizojmë në një renditje logjike dhe të dobishme, duke krijuar tituj të përshtatshëm. Rezultati do të të aftësojë që ta përfutosh lëndën me qartësi të madhe dhe ta japësh më efektivisht.

Shumë njerëz që duan të jenë studentë të mirë të Biblës nuk dinë të organizojnë lëndën në një skicë. Unë të nxis ta provosh, por, nëse ke problem për të gjetur një renditje logjike, mos ngurro të gjesh një model për të kopjuar. Shumë prej burimeve që përfshimë në kapitullin e mëparshëm na japin përmbledhje të lëndës biblike. Fjalorët biblikë japin shembuj të shkëlqyeshëm për të përmbledhur kuptimet e fjalëve të caktuara. Studimet biblike japin përmbledhje të librave të Biblës. Nuk ka asgjë të gabuar që këto përmbledhje të të udhëheqin ndërsa regullon lëndën tënde.

Skica përmbledhëse e pasazhit

Hapi i parë në skicim është përcaktimi i pjesës së Shkrimit që do të skicosh. Nëse synon të skicosh gjithë librin e Gjonit, për shembull, ke ndërmarrë një detyrë të madhe, ndaj të sugjeroj t'i ndash kapitujt në pjesë. Kjo shpesh ka më shumë kuptim se sa skicimi i një kapitulli të tërë, sepse shumë kapituj mund të përmbajnë më shumë se një temë

kryesore. Një mënyrë për të përcaktuar se çfarë duhet skicuar është të drejtohesh te ndarjet e kategorisë që botuesit vendosin në çdo kapitull. Kjo metodë të jep një fillim, sepse botuesi u ka dhënë këtyre kategorive të kapitullit titujt përkatës.

Mund të vendosësh të shtosh nënskicime si shtesa të skicës së pasazhit tënd. Këto skicime mund të jenë fjalë brenda pasazhit, të cilat kanë aq domethënie, sa të përligjin zbulimin dhe studimin individual. Ky lloj skicimi do të jetë i dobishëm, sidomos për mësuesit.

Para se të filloj me një demonstrim, ja disa parime të përgjithshme për skicimin. Procesi nuk është aq i vështirë sa mund të të duket, pasi vetë pasazhi do të diktojë pikat e një skice. Këto pika duhet të zhvillohen përgjatë progresit të pasazhit. Mos u mundo të vendosësh me forcë në skicë një temë që nuk gjendet brenda pasazhit, qoftë haptazi, qoftë me aludim, si pasojë e ndër-referimit ose zbulimit jashtëbiblik.

Ndërsa formon skicën, mund të përdorësh si tituj kapitullin ose titujt e kategorisë nga skicat e tua.

Si ilustrim të procesit, do të përdor Gjonin 1:1-18. Në rishikimin e skicave të mia të vëzhgimit, shoh se kam përmendur katër pika kryesore që kanë dalë nga studimi im i këtij pasazhi. Pika e parë vjen nga vëzhgimet e vargjeve 1-5, të cilat identifikojnë Krishtin si Fjala që ishte Perëndia dhe me Perëndinë nga fillimi dhe që krijoi botën. Pra, në skicën time unë vë si titullin e parë “Fjala – Krijuesi i pakrijuar”. Si titull vijues, përdor vëzhgimin tim për Gjon Pagëzorin, nga vargjet 6-8: “Pararendësi i Fjalës”. Ndarja e tretë kryesore vjen nga vargjet 9-13: “Rezultatet e trupëzimit të Fjalës”. Pastaj ndarja e katërt dhe e fundit është nga vargjet 14-18, që krijon “Tiparet e Fjalës së mishëruar”.

Kontrolloj skicën e vëzhgimit dhe fletën interpretuese për temat që shërbejnë si nënndarje të këtyre katër ndarjeve kryesore. Nën kategorinë e parë kryesore gjej materiale për tre nënkategori:

I.Fjala – Krijuesi i pakrijuar (Gjoni 1:1-5)

- A. Ekzistenca e përjetshme
- B. Burimi i përjetshëm
- C. Shfaqja e përjetshme

Tani do të kërkoj tema logjike të skicës sime, që të vihen nën këto nënkategori. Gjej materiale nga vëzhgimet dhe interpretimet e mia për natyrën hyjnore, që do të vihen logjikisht nën “Ekzistencën e përjetshme”. Për lëndën B, “Burimi i përjetshëm”, shoh që kam mbledhur të dhëna që tregojnë se Krishti është burimi i gjithçkaje të

krijuar, si dhe vetë jeta. Pra, nën nënkategorinë B, “Burimi i përvetshëm”, unë vë “bota materiale” dhe “jeta”. Kontrollon skicat e mia me imtësi dhe shoh se nuk kam material shtesë për “Shfaqjen e përvetshme”, ndaj e lë atë temë ashtu siç është, pa nënndarje.

Më pas, kërko ndarjen e dytë kryesore të pasazhit “Pararendësi i Fjalës”. Kontrollon skicat e mia për të dhënat që shkojnë me këtë titull. Këtu shoh që një pyetje bazë nxit përgjigjen që më nevojitet. Kush ka qenë pararendësi i Fjalës? Kisha vënë re përgjigjen nga v.6: pararendësi ishte Gjon Pagëzori, një njeri i dërguar nga Perëndia. Atëherë, në skicën time si nëntemën 1, shkruaj nën “II. Pararendësi i Fjalës”: “A. Gjon Pagëzori: Njeriu i dërguar nga Perëndia”. Duke mos gjetur asnjë nëntemë tjetër për këtë material i shoh përsëri skicat e mia.

Gjej edhe një Pyetje tjetër Bazë: “Pse?”. Pse u dërgua Gjoni nga Perëndia? Pyetja adreson qëllimin e misionit të Gjoni. Pra, në skicën time, si nëntema e dytë nën “Pararendësi i Fjalës” shkruaj “B. Qëllimi”. Vazhdoj të kontrolloj skicat e mia të mëtejshme dhe si përgjigje gjej dy shënime që shpjegojnë qëllimin e Gjoni në shënimet e mia për vargjet 7 dhe 8. “Ai erdhi si dëshmitar për të dëshmuar për dritën” dhe “që të gjithë të besonin nëpërmjet tij”. E kështu i shënoj këto dy materiale për skicën, si nëntemat 1 e 2, nën “qëllim”.

Mendoj se kemi shkruar shumë larg me këtë demonstrim për të të treguar se si funksionon procesi i formulimit të një pasazhi. Shih Skicat Shtesë të Pasazhit në Shtojcën B, pjesa e pestë.

Me rëndësi është të kujtojmë që të fillojmë me idenë kryesore, e pastaj ta ndajmë në disa nëntema, duke gjetur informacionin në Skicat e Vëzhgimit dhe Fletën Interpretuese, që përshtaten natyrshëm nën çdo kategori e nënkategori. Vazhdo t’i ndash temat kryesore në nëntema, derisa të kesh gjetur vendet e natyrshme në përmbledhjen tënde për gjithë informacionin e dobishëm.

Ja disa këshilla rreth përmbledhjes. Së pari, kur krijon një titull të bazuar te një sërë vargjesh, të gjitha të dhënat e nënndara nën atë titull duhet të rrjedhin nga këto vargje. P.sh, në skicën time përmbledhëse demonstrative, titulli im i parë “Fjala-Krijuesi i pakrijuar” përfshin vargjet 1-5. Të gjithë nëntitujt nën atë titull shpërbëhen nën këto pesë vargje. Unë nuk do të përdor materiale në këto nëntema, që largohen nga kjo pjesë e Shkrimit, sepse kjo do të më çonte në sfera të palidhura dhe skica ime përmbledhëse do të huteste fokusin e do të bëhej më e vështirë për t’u kuptuar dhe kujtuar.

Së dyti, mos përfshij kurrë një nëntemë, nëse nuk ke së paku dy prej tyre. Me fjalë të tjera, mos e vër kurrë informacionin nën një titull

SKICË

DËSHMIA E FJALËS TË BËRË MISH (Gjoni 1:1-18)

- I. Fjala – Krijuesi i pakrijuar (1-5)
 - A. Ekzistenca e përjetshme (1-2)
 1. Natyra hyjnore (1)
 2. Që prej fillimit (2)
 - B. Burimi i përjetshëm i krijimit (2-4)
 1. Bota e jashtme materiale (3)
 2. Jeta (4)
 - C. Shfaqja e përjetshme (drita) (5)
- II. Lajmëtar i Botës (6-8)
 - A. Kush? Njeriu i dërguar nga Perëndia (6)
 - B. Qëllimi? (7-8)
 1. Dëshmon për dritën (7a, 8)
 2. Që të gjithë të besojnë (7b)
- III. Rezultatet e Fjalës së mishëruar (9-13)
 - A. Negative (9-11)
 1. Ndriçon çdo njeri (9) POR
 2. I refuzuar nga njerëzit (10, 11)
 - a. nga bota (10)
 - b. nga të vetët (11)
 - B. Pozitive (12-13)
 1. Fëmijë të Perëndisë me anë të besimit (12)
 2. Prej Perëndisë, jo njeriut (13)
- IV Karakteristikat e Fjalës së mishëruar (14-18)
 - A. I vetëmlinduri nga Ai (14)
 - B. Më i madh se lajmëtar (15)
 - C. Burimi i hirit dhe të vërtetës (16-17)
 - D. Shprehje e dukshme e Perëndisë së padukshëm (18)

si nëntema 1, nëse nuk ke edhe nëntemën 2. Nëse ke vetëm një temë nën një titull, shënoje nëntitullin pa një germë ose numër, që tregojnë një ndarje. Ky është kryesisht një parim i një skicimi të mirë përmbledhës.

Skica përmbledhëse e Fjalës

Si ndihmës ndaj skicimit përmbledhës të pasazhit, mund ta shohësh si të vlefshme për studimin tënd, ose për qëllime mësimore, krijimin e një skice përmbledhëse në bazë të një fjale kryesore në pasazhin tënd. Vendose vetë sa të detajuar e do përmbledhjen. Shembulli në Skicën “Uji” në faqen 77, është një përmbledhje e një fjale të vetme.

Si ilustrim të funksionimit të procesit të skicës përmbledhëse kur zbatohet ndaj një fjale, do të të përshkruaj formimin e një Skice të Fjalës. Kjo skicë përmbledhëse bazohet te fjalën “Ujë”, që e gjejmë te Gjoni 3:5. E zgjedha këtë skicim që kam bërë para disa vitesh se ishte i thjeshtë. Në fakt, më kujtohet se nuk kisha më kohë dhe e dija se nuk mund ta përfundoja, ndaj plotësova vetëm fazën e referimeve. Tani duket se dështimi im për të plotësuar skicën mund të ketë qenë sipas vullnetit të Zotit. Është mirë të sigurosh një demonstrim të thjeshtë të procesit pa kaluar në shumë hollësi. Ja si veprova:

Shkova te skica ime e referimeve dhe studiova çfarë kisha shënuar atje. Vura re se e gjithë lënda ime për “ujin” mund të kategorizohej nën katër tituj bazë: (1) uji si lëng natyror në botën fizike (2) uji si metaforë për Fjalën (3) uji si metaforë për Shpirtin e Shenjtë dhe (4) uji në lidhje me rilindjen. Unë i thjeshtëzova këto katër kategori në këto deklaratat një a dy fjalëshe: (1) Uji, (2) Fjala, (3) Shpirti, (4) Rilindja. Pastaj pashë të gjitha ndër-referimet që kisha shënuar në skicën time dhe vendosa secilën nga katër kategoritë që ato mbështetnin. Pasi mora këto vendime, i ndava si duhet dhe i vura nën titullin përkatës.

Por thjesht, vendosja e referimeve biblike nën titujt e duhur nuk mjaftonte për një skicë të fuqishme përmbledhëse, me një ndërthurje të vazhdueshme, të lehtë për ta kujtuar dhe mësuar. Atëherë pashë çdo varg, për të gjetur një kuptim thelbësor që mund ta përfshija në katër a më pak fjalë. Mund të shohësh vetë rezultatet në faqen e kundërt.

Sigurisht, po të kisha vazhduar dhe të kisha shtuar materiale nga Fleta Interpretuese, skica ime përmbledhëse do të ishte zgjeruar jashtë mase. Por ka të ngjarë që forma bazë e përmbledhjes të mbetet e pandryshuar. Informacioni shtesë interpretues mund të gjejë lehtësisht

INTERPRETIM I SKICËS SË “UJIT”

I. Uji

- A. Simbolike – Jo gjithmonë kuptimi i fjalëpërfjalshëm
 - 1. Fjala (Efesianëve 5:26)
 - 2. Jeta e Përjetshme (Gjoni 4:14, 7:36-39)
 - 3. Shpirti i Shenjtë (Gjoni 7:39)
- B. Përdorimi i ujit: Larje (Efesianëve 5:26; Hebrenjve 10:22)

II. Fjala

- A. Simbolike
 - 1. Fara (1 Gjonit 3:9)
 - 2. Shpata e Shpirtit (Efesianëve 6:17)
- B. Përdorimi
 - 1. Pastrim (Efesianëve 5:26; Gjoni 15:3; Psalmi 119:9, 10)
 - 2. Shenjtërim (Gjoni 17:17; 1 Pjetrit 1:2; 1 Korintasve 6:11)
 - 3. E gjallë / vepruese (Psalmi 119:50; Hebrenjve 4:12)
 - 4. Punë në besimtarin (1 Thesalonikasve 2:13)

III. Shpirti

- A. E Gjallë (Gjoni 6:26)
- B. Shenjtëron (1 Pjetrit 1:2)
Mjeti është Fjala (Gjoni 17:17; 1 Korintasve 6:11)
- C. Jep jetë (Gjoni 6:63)

IV. Rilindja

- A. Uji (Gjoni 3:5)
- B. Shpirti (Gjoni 3:5)
- C. Fjala (1 Korintasve 4:15; Jakobi 1:18; 1 Pjetrit 1:23; Gjoni 1:13; Jakobi 1:15)
- D. Fara (1 Pjetrit 1:23; 1 Gjonit 3:9)

zbatim nën kategoritë e përmendura tashmë. Numri rendor për shënimet do të rritej dhe, po ashtu, do të vazhdohej me gërmat e mëdha. Madje mund të kisha gjetur kategori të reja të numrave romakë. Ji elastik! Aspekti thelbësor i skicës sate përmbledhëse përfundimtare është organizimi i gjithë kërkimeve, vëzhgimeve, përkufizimeve dhe interpretimeve të tua në mënyrë të tillë që mund t'i mbash mend ose t'i mësosh.

Shtypur në Shtojcën B, pjesa 4 e këtij libri në faqet 128-137, gjenden shembuj shtesë të fjalës që përvijojnë. Këta shembuj të përmbledhjes së studentit do të të tregojnë se si duken përmbledhjet e fjalës me informacionin e marrë nga të gjitha skicat e përfshira.

Një përsëritje e shpejtë

Me këtë kapitull ne plotësojmë procesin e studimit biblik, për të njohur përmbajtjen dhe interpretimin. Para se të vazhdojmë me hapin pasues kryesor, le të bëjmë një përsëritje të shpejtë të asaj që kemi mësuar. Në pikat e mëposhtme, vër re se si kalojmë me çdo hap nga e përgjithshmja te specifikja, duke kaluar më thellë dhe në më shumë hollësi. Kjo metodë nuk të nxjerr jashtë kontekstit, duke të ndihmuar në sistemimin dhe organizimin e lëndës në mënyrë logjike për qartësi më të madhe dhe fokusim më të lehtë.

1. *Tituj të kapitullit.* Titujt e kapitullit janë dorezat e mëdha që na ndihmojnë të kapim dhe kujtojmë përmbajtjen e çdo kapitulli. Ne kemi kapur tituj të kapitullit në majë të çdo kolone të titullit tonë të skicës.
2. *Tituj të paragrafit.* Ne i kemi titulluar paragrafët brenda çdo kapitulli si doreza të vogla që na ndihmojnë të kuptojmë përmbajtjen e çdo pjese të kapitullit. Kapëm tituj të paragrafit në kolonën, nën titullin e duhur të kapitullit, në titullin e skicës.
3. *Vëzhgimi.* Më pas u përfshimë në procesin e vëzhgimit të thjeshtë për të mësuar si të shohim përmbajtjen e një pasazhi. Si ndihmesa të vëzhgimit, ne zbatuam gjashtë pyetjet bazë, ose të “sipërfaqshme”: “Kush? Çfarë? Kur? Ku? Si? Pse?” Pastaj bëmë dymbëdhjetë pyetjet e lidhjeve për të ndihmuar vëzhgimin. Vëzhgimet tona i kemi shënuar në një skicë vëzhguese. Gjatë procesit, nuk u morëm shumë me atë që nënkupton një pjesë, por ishim kryesisht të interesuar për atë që ndodhet atje.

4. *Interpretimi*. Vëzhgimi na çoi në nevojën për të kuptuar domethënien e asaj që kemi vëzhguar. Kaluam në hapin interpretues për të zbuluar kuptimin. Në këtë hap pamë parimin bazë të interpretimit, para se të fillohet kërkimi në skicën e vëzhgimeve që kemi shënuar në hapin e vëzhgimit. Procesi i interpretimit na çoi në dy hapat kryesorë, që kanë të bëjnë me gjetjen e këtyre përgjigjeve-pasazheve me referime dhe hulumtimin e burimeve të jashtme.
5. *Ndër-referimi*. Ky ishte hapi i parë drejt interpretimit – kërkimi i domethënies përtej vëzhgimeve tona. Ne kemi kërkuar përgjigje nga Bibla, duke mësuar të ndjekim referimet, derisa të gjejmë atë që Bibla ka për të thënë në vende të tjera, në lidhje me temën në fjalë. Po ashtu e pamë kontekstin si mjet për të përcaktuar se çfarë ka për të thënë Bibla për një temë të caktuar, përgjigjet tona i kemi shënuar në një skicë referimesh.
6. *Kërkime jashtë Biblës*. Hapi vijues në procesin interpretues ishte kalimi jashtë Biblës për të gjetur përgjigje ndaj pyetjeve tona të interpretimit, duke hulumtuar burime të tjera. Ato përfshinin fjalorë të përgjithshëm, fjalorë bibliqë, konkordanca, studime biblike, enciklopedi, enciklopedi biblike, komentare, libra tematikë, atlasë, studime fjalësh, burime interneti dhe programe kompjuterike. Zbulimet tona i shënuam në një fletë interpretimi.
7. *Skicimi përmbledhës*. Kulmimi i studimit tonë bibliqë dhe përpilimit të skicave ishte skica jonë përmbledhëse, e cila organizoi lëndën që mblodhëm në një formë logjike që mund ta përdorim si burim mësimor ose studimor.

I gjithë procesi i studimit bibliqë që kam paraqitur këtu synon të të ndihmojë të kuptosh përmbajtjen dhe kuptimin e Biblës. Sigurisht, siç edhe e kam thënë, skica përmbledhëse rezultuese është një mjet i shkëlqyeshëm për studim të mëtejshëm, mësimin përmendësh dhe mësimdhënien. Por unë jam i bindur se procesi që prodhon këtë skicë përmbledhëse – leximi, gërmimi, referimi, të menduarit, skicimi, të kërkuarit dhe të përmbledhurit kanë vlerë në vetvete. I gjithë procesi të përfshin thellësisht te Fjala. Ndërsa punon, fillon të shohësh gjëra të ndryshme dhe të kesh ide që nuk i ke pasur kurrë më parë. Edhe sikur të mos e prekësh fare skicën përmbledhëse, tashmë ke ngulitur fort në mendje një kuptim dhe vlerësim të ri të mesazhit të Perëndisë për njerëzit.

Detyra

1. Gjej një fjalë kryesore te Gjoni 4 dhe nga skicat e tua formulo një skemë përmbledhëse të fjalës.
2. Shiko në skicat e tua dhe gjej kapitullin, ose pjesën e një kapitulli për të cilin bën shumicën e shënimeve. Bëj një përmbledhje të pasazhit në këtë pjesë.

HAPI I TRETË

Si ta realizosh

Udhëzues për zbatimin

10

PARIMET E ZBATIMIT

Aty ku gjithçka vihet në provë

Ti mund të mendosh se studimi biblik nuk ka asnjë pikë të dobët dhe në thelb, nuk ka. Por, meqenëse ne jemi mëkatarë, reagimet tona ndaj diçkaje pozitive dhe përfituese mund të marrin një drejtim negativ. C.S.Luis ka konstatuar se, edhe kur një i krishterë ia del mbanë në arritjen e përljes, reagimi i parë është ndjesia e krenarisë duke e shkatërruar këtë arritje. Me studimin biblik, kjo kthesë shpesh e trajton rritjen tonë në njohje dhe kuptim si një qëllim në vetvete, por synimi i studimit biblik nuk është thjesht rritja e njohjes mendore, por të mësuarit se si të zbatosh parimet e drejta që të jetojmë me përkushtim e shenjtërim. Ne duam të zbatojmë atë që mësojmë në jetën tonë të përditshme, por biem shumë lehtë në grackën e të kënaqurit vetëm me interpretimin dhe nuk kalojmë kurrë në zbatim.

Pak ekspertë biblikë kanë pasur më shumë njohje të Shkrimeve se sa Martin Luteri. Si murg katolik kalonte orë të tëra në studimin e Biblës, për të arritur një kuptim të detajuar të asaj që zbulonte në të, por, a mjaftohej ai me kaq? Aspak. Njohja e nxiti të vepronte. Shkrimi e bindi atë që shumë prej praktikave të kishës së tij ishin të gabuara. Ai vuri në rrezik emrin e vet dhe madje, jetën e vet kur mbërtheu një listë prej 95 gabimesh që duhej të ndreqeshin, në derën e kishës së mishëruar të Vitenbergut. Për shkak të këtij veprimi, e nxorën në gjyq para perandorit, e urdhëruan që të hiqte dorë nga kjo e ashtuquajtur herezi, që kishte mësuar në studimet e tij, sipas së cilës shpëtimi ishte vetëm me anë të hirit. Por Luteri deklaroi para perandorit: “Nuk mund të heq dorë, sepse ndërgjegjja ime është zënë rob nga Fjala e Perëndisë”.

Historia na tregon për shumë të krishterë të tjerë që kanë qenë të shtyrë nga njohja e Biblës për ta zbatuar atë dhe për të bërë gjëra të mëdha për Zotin. Të kujtohet Jan Husi, reformatori çek, i cili u dogj

në turrën e druve për shkak të bindjeve të tij, ose anglezi Xhon Uiklifi, që u persekutua për shkak të besimit, sepse përktheu Biblën në gjuhën e njerëzve të thjeshtë, ose Xhon Noksi, pasioni i të cilit për ungjillëzim e bëri që të ulej në gjunjë dhe të thërriste: “O Perëndi, më jep Skocinë, përndryshe do të vdes”?

Në të gjitha këto raste, njohja që kishin këta persona për Shkrimin i nxiti të ndërmerrnin një veprim përkushtues. Njohja pa zbatim është e pakuptimtë. Qëllimi i Biblës është të na tregojë si të jetojmë si pjesëtarë të mbretërisë së Perëndisë. Vetë Jezusi na nxiti që të ndërtojmë jo vetëm njohjen tonë, por jetën tonë mbi Fjalën e tij. Ja çfarë lexojmë te Mat.7:24-27:

“Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij te shkëmb. Ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; por ajo nuk u shemb, sepse ishte themeluar te shkëmb. Përkundrazi, ai që i dëgjon këto fjalë dhe nuk i vë në praktikë, do të krahasohet me një njeri budalla, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij te rërë. Më pas ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën te atë shtëpi; ajo u shemb dhe rrënimi i saj qe i madh”.

Është e qartë se nuk mjafton vetëm dëgjimi i mësimëve të Jezusit, bindja ndaj tyre e bën të mençur një person dhe i jep jetës një qëndrueshmëri të tillë si ajo e një shtëpie që ndërtohet mbi një themel të fuqishëm.

Siç kemi parë deri tani në këtë libër, ka një visar të mrekullueshëm njohurish në Bibël. Ka shumë për të mësuar, një detyrë kjo e mahnitshme, edhe pse kërkon një jetë të tërë për ta studiuar. Por kjo nuk duhet të na shkurajojë nëse e kuptojmë se Perëndia i kupton dobësitë e kufizimet tona. Ai nuk pret të pamundurën nga ne, por kërkon që të ndjekim kufizimet. Ne mësojmë atë që mundemi dhe e zbatojmë, qoftë pak, qoftë shumë. Zoti do që të jemi të pjekur, por e di se kjo nuk ndodh brenda një nate. Rritja është proces dhe kërkon kohë. Ai do të na ndihmojë për të ndërmarrë atë hap që mundemi, për të zbatuar fjalën e tij në jetën tonë.

Në disa raste zbatimi i Shkrimit është i qartë dhe i thjeshtë. P.sh., në urdhërimin “Mos shkel kurorën”, zbatimi është në sipërfaqe dhe shihet qartë nga të gjithë. Nuk nevojitet asnjë gjë, në kërkim të zbatimeve të ndryshme personale. Thjesht lexo dhe bindu, por në

pasazhe të tjera, ndërsa e vërteta mund të jetë e qartë, shpesh zbatimi nuk është. Ne duhet të mund të shqyrtojmë pasazhin, që të kërkojmë zbatime domethënëse për jetën tonë. Si mjete shqyrtuese për këtë qëllim, kam zhvilluar shtatë pyetje që mund të bëhen nga çdo pjesë e Shkrimit, të cilat do të të ndihmojnë për të zbuluar të vërtetat e zbatueshme të çdo pasazhi dhe për të gjetur mënyra zbatimi personale.

Shtatë pyetjet zbatuese

Që të zbatoj atë që kam mësuar nga studimi biblik, marr një fletë prej 16 x 24 cm (ose krijoj një dokument në kompjuter) dhe shkruaj në majë: “Zbatimi”. Teksa nis kërkimin tim të zbatimit, kam përpara të gjitha skicat dhe përvijimet te pasazhin biblik që po zbuloj. Pastaj filloj shtatë pyetjet zbatuese, që më ndihmojnë të zbuloj lëndën e studimeve interpretuese që mund të vë në praktikë, në jetën time. Ndërsa shikoj pasazhin dhe lëndën e studimit, bëj pyetjet dhe shënoj përgjigjet, në fletën zbatuese – të vërtetat e zbatueshme që gjej, ose *zbatimet* e mia. Ja shtatë pyetjet:

1. *Cilat të vërteta gjenden në këtë pjesë?* Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, studioj pasazhin dhe skicat e përvijimet e mia, që të gërmoj tekstin për të gjitha zbatimet që ofron. Rëndësi ka që të bëhet pyetja saktë, që të jesh i sigurt se ke gjetur gjithçka që gjendet aty. Sigurisht, nuk mund të caktoj se sa të vërteta duhet të gjesh ti, sepse kjo varet nga pasazhi, zgjatja e tij dhe efektshmëria e zbulimit tënd, por për të të dhënë një ide të përgjithshme, zakonisht në një pjesë të tillë si Gjoni 3:1-10, mund të dalësh me 3-5 zbatime në një studim normal dhe mbase edhe me 10, ose më shumë gjatë një studimi më të përqendruar. Unë kisha një student që gjeti 36 zbatime në tetë vargjet e para të Gjoni 3. Shih listën e Zbatimeve me 36 pikat në Shtojcën B, pjesa e pestë, në faqen 145.

Duke parë Gjoni 3:1-10, a “hidhet” tek ty ndonjë e vërtetë? Çfarë shikon në thënien e Krishtit se dikush duhet të rilindë që të shohë mbretërinë e Perëndisë? Kjo është një e vërtetë. Njeriu duhet të rilindë. Pra, shënoje këtë si një të vërtetë në fletën e zbatimit.

2. *Si zbatohet kjo e vërtetë në jetën time?* Tani përpiku të zbatosh në jetën tënde të vërtetat e përmendura në pyetjen 1. A zbatohet kjo e vërtetë në punë? Në shtëpi? Në lagjen tënde? Apo me familjen tënde? A ndikon në aktivitetin, apo pikëpamjen tënde?

Duke ndjekur shembullin tonë nga pyetja 1, si zbatohet në jetën tënde “Duhet të rilindësh”? Çfarë ndryshimi ka nëse je rilindur? A

ndikon në mënyrën se si shikoni botën? Cili është ai efekt? A ndikon në mënyrën se si jeton me bashkëpunëtorët, të afërmit, apo komshinjtë? Shkruaje përgjigjen në detaje.

3. *Sipas kësaj të vërtete, ç'ndryshime specifike duhet të ndërmarr në jetën time?*

Ideja përtej metaforës së të qenit i rilindur do të thotë se dikush bëhet krijesë e re, jeton në një shtëpi të re e nën autoritete të reja. Kjo pyetje të detyron të analizosh veten për të parë nëse jeta jote e pasqyron atë ndryshim dramatik. A po vepron akoma si atëherë kur nuk ishe i rilindur? A mund ta dallojnë familja, miqtë dhe bashkëpunëtorët ndryshimin? A i merr gjithë vendimet tashmë nga standardi i Krishtit? Apo e sheh akoma veten sikur je në krye të jetës tënde? Ji i rreptë dhe i pamëshirshëm me këto zbulime të bezdisshme se ky është qëllimi; të të detyrojë të shikosh në sferat problematike që mund të kesh shpërfillur, që të bësh ndryshimet e nevojshme në jetën tënde.

4. *Po çfarë propozoj për të zbatuar këto ndryshime?* Siç mund ta shikosh, këto pyetje janë të pamëshirshme në shqyrtimin e tyre. Ato synojnë që të mos humbasësh karremin, të detyrojnë që, jo vetëm të shikosh dhe dallosh dobësinë tënde, por edhe të konsideronsh hapa për të ndërmarrë veprim. Përmend të gjitha mënyrat që të shkojnë ndërmend për të bërë ndryshime në jetën tënde, të cilat do të pasqyrojnë faktin e rilindjes tënde. Ndoshta duhet të shmangësh situata të caktuara, të kontrollosh një zakon, ose të vetëpërmbahesh. Si mendon ta bësh këtë? A të duhet një partner për të të mbajtur të përgjegjshëm? Po të numërosh deri në tre, para se të përgjigjesh, a do të të ndihmojë që të mbash gjuhën? Nxirr zgjidhje të mirëfillta.

Më kujtohet kur po bëja fletën time zbatuese rreth Gjonit 4. Një nga të vërtetat bazë të rreshtuara ishte “adhurimi i Perëndisë me Shpirt dhe në të vërtetë”. Ndërsa studiova adhurimin në hapat e mi të vëzhgimit dhe interpretimit, zbulova se një mënyrë adhurimi është të ndihmohesh të tjerët në emrin e Krishtit. Një akt adhurimi është t'u shërbesh të tjerëve. Kur arrita te pyetja e zbatimit “Ç'ndryshime duhet të bëj në jetën time?”, u binda që nuk e kisha zakon të ndihmoja njerëzit. Pra, qëllimi im ishte që të bëhesha një person që synon të ndihmojë të tjerët. Në atë kohë jetoja në malet afër San Bernardinos. Gjatë verave të nxehta, këto rrugë malore shpesh bënin që veturat të ngroheshin tepër dhe nuk ishte e pazakontë të gjeje vetura me radiatorë të avulluar, të parkuar në anë të autostradës. Meqë shpesh e kam përshkuar vetë këtë rrugë, e kuptova se të siguroje ujë për këta

automobilistë të tendosur do të ishte një mundësi e përkryer për të “adhuruar”, duke ndihmuar të tjerët.

Pra, çfarë shkrova si përgjigje ndaj pyetjes: “Si mendoj ta bëj këtë ndryshim?”. Të blija dy enë 22 litërshe, t'i mbushja me ujë dhe t'i mbaja në portbagazh. E ndoqa këtë dhe si pasojë e procesit tim të shkrimit kam mundur t'u dëshmoj shumë automobilistëve mirënjohës të asaj autostrade, ndava një mënyrë më të mirë uji se sa thjesht H₂O.

5. *Cila është lutja ime personale në lidhje me këtë të vërtetë?* Lëre fuqinë e mrekullueshme të lutjes të të vijë në ndihmë, ndërsa i zbaton këto të vërteta. Kërkoji Perëndisë forcë, urtësi dhe kurajë për ta zbatuar siç duhet dhe për nder të Tij. Nëse ndeshesh me një problem, paraqite atë ndershmërisht. Unë sugjeroj fuqimisht që t'i shkruash lutjet, sepse shkrimi e “mishëron” mendimin tënd. Në vend të lutjes si fjalë kalimtare në mendje, e ke si diçka të prekshme në botën fizike. Kjo e bën disi më reale dhe atëherë e merr më seriozisht. Po ashtu, kur e shkruan lutjen, mund t'i referohesh përsëri dhe të lutesh kur të duash.

6. *Cilin varg, apo vargje biblike mund të mësoj përmendsh për të përmbledhur më së miri këtë të vërtetë?* Të mësuarit përmendësh të një pasazhi biblik është mënyra më e mirë që njoh për ngulitjen e një të vërtete në zemrën tënde. Shiko në skicën e referimeve për të dalluar nëse ke përfshirë një varg që mishëron të vërtetën që po trajton. Shpesh, vargu më i mirë për të mësuar përmendësh mund të jetë ai që po studion. Një varg i mundshëm për të mësuar përmendësh, që përcjell parimin e “rilindjes” nga Gjoni 3 është 2 Kor. 5:17: “Kjo do të thotë se ata, të cilët ishin bërë të krishterë ishin tashmë krijesa të reja. Ata nuk janë më po ata, sepse jeta e vjetër ka kaluar dhe jeta e re sapo ka filluar!”.

7. *Ç'illustrime mund të zhvilloj që mund të më ndihmojnë ta përveçtoj këtë të vërtetë dhe t'ua komunikoj të tjerëve?* Pa dyshim që ke vënë re se, kur predikimet, mësimet, ose librat kanë ilustrime të gjalla për të theksuar argumentet, i kujton më mirë. Në fakt, ndonjëherë i mbaj mend ilustrimet e një predikimi edhe kur harroj argumentin kryesor. Dhe sigurisht, ilustrimet më kthejnë te pika kryesore. Ky është synimi i ilustrimeve, ato e bëjnë të gjallë të vërtetën. Le të themi se i japin “mish” që të lidhesh më mirë me të. Ilustrimi yt mund të jetë një tregim i shkurtër, një poemë, vizatim, grafik, ose karikaturë. Një studente që do të ilustronte vendin e saj në trupin e Krishtit, vizatoi skicën e një trupi, që simbolizon Krishtin, ose kishën dhe e mbushi me vizatime të vogla ngjitëse të shumë personave. Ajo shënoi njërën prej këtyre figurave ngjitëse në referim me veten. Shih shembujt e Skicës Shtesë të Zbatimit në Shtojcën B, pjesa e pestë në faqen 88.

Si do ta ilustroje të vërtetën tonë te Gjoni 3, për nevojën e rilindjes? Mund të shkruash një tregim të shkurtër të një personi që kishte një zemër të sëmurë dhe që kishte nevojë urgjente për transplantim. Kur u gjet një dhurues i shëndetshëm, ai e mori zemrën dhe u gjallërua plotësisht. Ajo zemër e re i dha jetë të re dhe ai nuk vdiq. Madje i dukej sikur kishte nisur një jetë të re, sikur ishte i rilindur. Nëse nuk ke dhunti për prozë, tregojë me anë të një poeme, pikturoje ose skicoje. Ji i larmishëm për të përdorur dhuntitë më të mira për të përfshirë të vërtetën e zbatueshme përmes një ilustrimi.

Ja një shembull i fletës zbatuese që ka përpiluar një nga studentët e mi, duke përdorur këto shtatë pyetje:

Shih shembujt e Skicës Shtesë të Zbatimit në Shtojcën B, pjesa e pestë, në faqet 140-144.

Zbatimi dhe dëshmimi


Po aq e rëndësishme sa zbatimi i të vërtetave biblike në jetën tënde është edhe njohja e tyre aq mirë, sa të mbahen mend kur ua dëshmon të tjerëve. Njohja e shembullit të duhur nga Bibla mund të jetë një ndihmesë e madhe në aktualizimin e drejtpërdrejtë të saj ndaj nevojave dhe situatave të tyre. P.sh., ta zëmë se po flet me një klerik islamik e i thua se do t'i tregosh atë që Jezusi i tha një udhëheqësi fetar. Pastaj përmendi bisedën midis Jezusit dhe Nikodemit, te Gjoni 3. Ose, nëse po flet me një deputet, ose këshilltar bashkiak, kujto se Nikodemi ishte udhëheqës politik dhe tregoi atij fjalët e Jezusit drejtuar Nikodemit. Zbatimi i Shkrimit mund të të ndihmojë shumë kur dëshmon. Kujto kur treguam në kapitullin 5, se si Jezusi i dëshmoi gruas samaritane, te Gjoni 4. Së pari, i ofroi diçka të dëshirueshme, ujë që mund t'i shuante përjetë etjen. Së dyti, i tregoi se çfarë e pengonte që të shijonte këtë bekim: imoraliteti në jetën e saj. Së treti, i foli për planin e Perëndisë për adhurimin – si të vendoste një lidhje me të dhe së katërti, nxiti besimin e saj kur i tha se kush ishte. Në thelb, çështja ishte “Do të besosh apo jo?”.

Vër re se sa shumë ngjan kjo bisedë me Katër Ligjet Frymërore që përdor Campus Crusade for Christ (Instituti “Jeta e Re”) Ligji i parë ofron diçka të pëlqyeshme: *Perëndia të do dhe të ofron një plan të mrekullueshëm për jetën tënde*. Shumë metoda ungjillëzuese nuk nisin me këtë notë pozitive, por nisin shpesh me deklaratën se ai, ose ajo është mëkatar. Sigurisht që kjo është e vërtetë, por nuk ka të ngjarë të marrë një reagim pozitiv, pasi asnjë nuk dëshiron të akuzohet, sidomos në hyrjen e një bisede. Fjala greqisht *ungjill* është *euangelion*, që do

APLIKIMI

Efesianëve 4:11-16

1. *Aplikimi.* Nëse çdo i krishterë shton në maksimum dhuntinë e vet shpirtërore, dhe punon për t'i shërbyer trupit me dashuri, Porosia e Madhe do të ishte përmbushur që në vitet 1990-të. Prandaj në dashuri, kërkoj të nxis motrat dhe vëllezërit e mi që të kërkojnë, zhvillojnë dhe përdorin dhuntitë e tyre shpirtërore.
2. *Ndryshimet.* Përpjekjet e mia mund të përqendrohen në mënyrë strategjike në kishën time lokale, në shërbesën e Institutit "Jeta e Re" ose në të tjera organizata të krishtera. Duhet t'i kushtoj më shumë kohë vënies në funksion të aftësive të mia për të plotësuar përgjegjësitë.
3. *Zbatimi.* Të rris kohën e leximit dhe studimit duke përfshirë më shumë libra për administrimin. Të kërkoj për të thjeshtëzuar procesin e regjistrimit për të patur më shumë rezultat në konferencën e krishterë. Të kaloj më shumë kohë për të dokumentuar kërkimet e mia për trupin e Krishtit.
4. *Lutja personale.* Zot, le ta përdor dhuntinë time të administrimit për ndërtimin e trupit të Krishtit. Le të rritet trupi në dashuri ndërsa edhe unë përdor dhuntinë time në shërbim të plotësismit të Porosisë së Madhe.
5. *Vargu.* Vargu 16.
6. *Ilustrimi.* Trupi i Krishtit:



të thotë bisedë. Por t'i thuash një personi “je mëkatar i dënuar në ferr” zor se mund ta marrë si lajm të mirë.

Shumë njerëz kërkojnë dy gjëra që mungojnë në jetët e shumë njerëzve sot. E para është dashuria dhe e dyta, qëllimi. Nëse u ofron këto njerëzve, ka të ngjarë të të përgjigjen si u përgjigj gruaja samaritane ofrimit të ujit të gjallë nga Krishti. Ata do ta dëshirojnë, ofrimi do të jetë *lajm i mirë* për ta.

Vër re se, pasi i ofroi lajmin e mirë gruas, ai i tha pse nuk mund ta përjetonte atë. Ajo jetonte në imoralitet. Mëkati e mbante larg nga Perëndia dhe nga shijimi i ujit të gjallë.

Kurse ligji i dytë shpirtëror na tregon të njëjtën gjë, na thotë pse nuk mund ta përjetojmë ligjin e parë. *Njeriu është mëkatar dhe i ndarë nga Perëndia*. Ne nuk mund të përjetojmë dashurinë e Perëndisë, ose të ndjekim qëllimin tonë, pasi mëkati na pengon.

Më pas, Jezusi i tregoi gruas se si mund të kapërcehet pengesa: duke patur një marrëdhënie me Perëndinë.

Ligji i tretë shpirtëror na tregon të njëjtën gjë: *Jezu Krishti është sigurimi i vetëm për mëkatin e njeriut. Përmes tij mund ta njohësh dhe përjetosh dashurinë dhe planin e tij për jetën tënde*.

Dhe më në fund, Jezusi i personalizoi parimet dhe e vuri gruan në një pozitë ku asaj iu desh të merrte një vendim. Ai i zbuloi identitetin dhe ajo duhej të zgjidhte nëse do të besonte, apo jo.

Ligji i katërt shpirtëror kërkon një vendim, bazuar në besimin te Krishti: *Ne duhet të pranojmë personalisht Jezu Krishtin si Shpëtimtar dhe Zot e atëherë mund të njohim dhe përjetojmë dashurinë e Perëndisë dhe planin e tij për jetët tona*.

Siç mund ta shohësh, Shkrimi nuk është shkruar thjesht për të na dhënë një njohje mendore abstrakte, por të vërtetat e tij janë praktike dhe të zbatueshme.

Rreziqe për të shmangur

Kur një lojtar golfi bëhet gati të gjuajë topin, e qëllon drejt kunjës duke shpresuar të hyjë në gropë, ose të ndalojë në një vend në bar. Shumë rreziqe kanosin topin, nëse nuk qëllon në shenjë dhe devijon. Nga njëra anë grackat e ujit, pyjet dhe nga tjetra rëra afër barit.

Edhe zbatimi i studimit biblik ka rreziqe të ngjashme. Nëse nuk jemi vigjilentë, mund të ndalojmë pranë grackave të ndryshme që duan të gllabërojnë përpjekjet tona për të arritur synimet tona të zbatimit. Le të identifikojmë disa prej këtyre rreziqeve.

Rreziku i parë është ai i *interpretimit të gabuar* për zbatimin. Çuditërisht, ndonjëherë është e lehtë që të mendojmë se, meqë kemi kuptuar një të vërtetë, si rrjedhim e kemi zbatuar atë. Ne i kuptojmë parimet që kemi mësuar në bisedën e Jezusit me gruan samaritane dhe kur i ngulisim ato fort në mendjen tonë, mund të mendojmë lehtësisht se jemi “fitimtarë njerëzish”, pa i vënë aspak parimet në praktikë. Është njësoj si një njeri që mendon se për shkak të uniformës ushtarake që ka veshur, është luftëtar trim, megjithëse nuk ka qëlluar kurrë me armë. Nuk është njohja ajo që vlen, por çfarë ti bën me të.

Një tjetër rrezik ndaj zbatimit është *zvarritja*. Shpesh, nuk të bëhet të studiosh Biblën, diçka kjo e pazakontë. Mund të kesh shpenzuar vite të tëra pa e marrë mundimin të studiosh dhe kjo është rrënjësor në mënyrën e jetesës. Në gjithë këto vite mund të kesh vepruar me forcat e tua, sipas ndjenjave dhe në rrugën më të lehtë, duke bërë atë që të tregonin impulset e ndjenjave të kënaqshme. Nuk është e lehtë që t'i ndryshosh menjëherë këto zakone dhe të nisësh një rutinë të disiplinuar. Dëshirat e fuqishme dhe të qëndrueshme kërkojnë kohë që të kultivohen dhe nuk mund të arrihen pa u përkushtuar dhe pa ia nënshtruar ndjenjat drejtimit të vullnetit tënd. Nuk e arrin qëllimin e zbatimit dhe e trajton emocionin si qëllim në vetvete dhe si rrjedhim, zbatimi dështon.

Pengesa e tretë për zbatimin është një *reagim emocional pa veprim shoqërues*. Ti mund të kesh zbuluar një të vërtetë të thellë që të prek shumë dhe shkakton një reagim të fuqishëm emocional. Mund të jetë ose një reagim gëzimi i madh, ose shqetësimi i devotshëm dhe keqardhje për një mëkat të zbuluar. E megjithatë, ky emocion mund të shterohet dhe të mos arrijë të të motivojë për të vepruar. Nuk arrin kështu synimin e zbatimit dhe e trajton emocionin si një qëllim në vetvete e si rrjedhim, zbatimi dështon.

Kurse e katërta është ajo e *pritjes së rezultateve të menjëhershme*. Ndërsa i zbatojmë parimet biblike në jetët tona me lutje dhe përkushtim, është e lehtë të presim një rezultat të menjëhershëm. Problemi është i zgjidhur dhe nuk duhen më përpjekje, por kam mësuar se shumë herë Zoti duket po aq i interesuar për procesin, sa edhe për rezultatet, sepse zakonisht gjatë procesit ne rritemi më shumë në shëmbëllimin e tij. Ashtu si puna dhe ushtrimet forcojnë muskujt, edhe procesi i trajtimit të problemeve dhe dobësive prodhon durim dhe besim. Rezultatet e menjëhershme janë të rralla dhe nuk duhet të priten.

Pengesa e fundit për zbatimin efektiv është *zhgënjimi*. Zhgënjimi rrjedh shpesh nga pritja e rezultateve të menjëhershme. Mund të

rrjedhë edhe nga ndërprerjet, ose nga dështimi i gjetjes së kohës që nevojitet për studim biblik. Ose mund të vijë edhe nga mendimi se nuk po mëson gjithçka që duhet. Cilado qoftë arsyeja e zhgënjimit, merru sa më shpejt me të. Uli shpresat për sukses të menjëhershëm. Nëse nuk gjen kohë për studimin biblik, përdore mirë kohën që ke. Mos e krahaso masën e mësimit tënd me atë të një tjetri, ose me atë që të duhet të mësosh në të ardhmen, por vazhdo përpara. Kujto se breshka fitoi. Mos e lër pengesën e zhgënjimit të të shqetësojë.

Të gjithë ne herë pas here ndeshemi me këto pengesa. Edhe topi i kampionit të golfit bie në një kurth rëre. Ka rëndësi të zgjedhim hekurin e duhur dhe të gjuajmë përsëri, me më shumë kujdes për të shmangur pengesa të tilla në të ardhmen. Ne do të donim që topi të binte në gropë që herën e parë, por kjo nuk është realiste. Ndoth rrallë dhe madje, edhe golfistëve më të mirë u duhen së paku tri goditje për të arritur një gropë (kurse për disa të tjerë duhen shtatë ose tetë). Dhe duhet kohë dhe praktikë, edhe për të arritur një nivel mesatar. Qëllimi është të ngulmohet. Kujto se procesi i rritjes është i rëndësishëm në vetvete, sepse ndërton karakterin.

Pengesa për dëshmim

Do ta mbyll kapitullin duke adresuar një pengesë për dëshmim që mund ta shmangësh duke zbatuar shkrimin. Kjo pengesë është tërheqja në një argument me personin, të cilit po i dëshmon. Mund të ndodhë shumë lehtë. Mendjet e tyre mund të mbushen me pyetje të parëndësishme ose keqinformime për Biblën, kur të shohin të informuar. Pyetje të tilla si “Ku e gjeti Kaini gruan?”, ose “Pse Perëndia lejoi të vriteshin të gjithë ata njerëz në Kanaan?”. Përpiku të shmangësh drejtime të tilla gjatë dëshmisë.

Mbaj mend se gruaja samaritane provoi të njëjtën taktikë me Jezusin. Kur ai theksoi se ajo kishte qenë e martuar pesë herë dhe tashmë jetonte me dikë që nuk ishte burri i saj, ajo tha: “Zot, po shoh se ti je një profet. Etërit tanë adhuronin mbi këtë mal dhe ju thoni se në Jerusalem është vendi ku duhet të adhurojmë”. Pikërisht kur Jezusi iu afrua së vërtetës për jetën e saj, ajo u përpoq të ndërronte drejtimin e bisedës, duke nisur një argument fetar. Jezusi nuk pranoi, por iu drejtua nevojës që ajo kishte për të adhuruar Perëndinë në të vërtetë dhe me Shpirt.

Njerëzit sot janë si kjo grua, përpiqen të shmangin përballjen me çështjet morale në jetët e tyre dhe ngrenë disa pyetje që ka shekuj që debatohen. Unë u përgjigjem rrallë pyetjeve të tilla gjatë dëshmisë,

sepse nuk janë aktuale dhe nuk dua që biseda të shkasë në gjëra anësore dhe të zgjasë pa fund. Por, zakonisht e përgëzoj personin duke i thënë se ka bërë një pyetje interesante, nëse është e tillë dhe kështu meriton një përgjigje. Nëse pyetja është mjaft kritike ose bezdisëse ndaj personit, zakonisht ai ose ajo do të pajtohet. Dhe shpesh, kur të kesh mbaruar bisedën, ata do ta kenë harruar pyetjen.

Sigurisht që përdor gjykimin në raste të tilla. Nëse e shoh se pyetja i shqetëson me të vërtetë dhe nuk më ndahen pa iu përgjigjur do t'i përgjigjem menjëherë. Por është më mirë që të shmangim kurthin e rërës, që në këtë rast janë pyetjet që të tërheqin nga qëllimi kryesor. Kur dëshmon, ndiq shembullin e Krishtit. Nuk duhet të synosh hapjen e një argumenti, por të flasësh për Jezusin.

Detyrë

1. Zgjidh një pjesë nga Gjoni 3 dhe bëj shtatë pyetjet e zbatimit. Bëj një zbatim të së vërtetës nga Gjoni 3, në mënyrë të matur dhe të hollësishme.

11

STUDIM BIBLIK I SHTYRË NGA NEVOJA

Të gjesh përgjigjet për nevojat e menjëhershme

Ne mësuam në kapitullin e mëparshëm se qëllimi përfundimtar i çdo studimi biblik është zbatimi. Njohja e Biblës nuk ka kuptim nëse nuk e zbatojmë ndaj mënyrës se si jetojmë dhe e përdorim për t'iu nënshtruar Krishtit. Në këtë libër synoj të të udhëheq përmes një procesi efektiv të studimit biblik, për të të dhënë një mënyrë që të fitosh njohje të Biblës dhe ta zbatosh atë në mënyrë të frytshme.

Unë kam zbuluar se njohja e zgjeruar e Biblës është një burim i madh qëndrueshmërie në jetën e një personi. Sa më shumë të dish, aq më shumë mund të zbatosh dhe sa më shumë ta zbatosh, aq më shumë bëhesh i ngjashëm me Jezusin, kësisoj aq më e lumtur dhe e qëndrueshme bëhet jeta jote. Dhe ne, njerëzve mëkatarë, na duhet fort kjo lloj qëndrueshmërie. Çdo ditë ndeshemi me vështirësi dhe shpesh ato arrijnë deri në kriza emocionale, fizike, martesore, profesionale ose financiare. Kemi një nevojë të vazhdueshme që të njohim vullnetin e Perëndisë dhe ta shohim situatën tonë nga perspektiva e tij. Gjithë puna qëndron në njohjen e Biblës, në mënyrë që të zbatojmë zgjidhjen e tij ndaj nevojave tona. Njohja që kemi për Biblën bëhet rezervuar ndihme për trajtimin e krizave.

Siç kam thënë shumë herë më parë, e kuptoj plotësisht se procesi i mësimi të Biblës dhe zbatimi i të vërtetave të saj kërkon kohë. Njohja intensive e Fjalës së Perëndisë nuk vjen në çast dhe ti ke një jetë të tërë përpara. Çfarë bën kur të duhen zbatime biblike, por nuk e ke akoma njohjen zbatuese? E kam shkruar këtë kapitull si një masë të përkohshme për të të ndihmuar në raste të tilla. Mendo për kapitullin si një fashë që shërben për të ndalur rrjedhjen e gjakut, derisa të mpikset gjaku për t'u shëruar. Përdore derisa të mos të të nevojitet më.

Së pari, do të të tregoj se si të gesh përgjigje të shpejta kur të të nevojiten. Ta zëmë se ke një problem me temperamentin tënd, një problem jo krejt të pazakontë. Ti ke jetuar me shpërthimet e zemërimit, pasi nuk të kanë shqetësuar (ndonëse ata që të rrethojnë mund të kenë një këndveshtrim të ndryshëm). Por më në fund, temperamentit yt ka krijuar një krizë. Ti zemërohesh në punë me shefin dhe ai të thërret në zyrë e të paralajmëron se do të të pushojë nga puna, nëse kjo do të përsëritet. E di se të duhet ndihmë dhe sapo ke nisur programin e studimit biblik, por nuk ke përparuar aq shumë sa të dish se ku të gesh ndihmë në Bibël.

Mund të përdorësh një konkordancë ose një program fjalëkërkues qoftë në internet ose diku tjetër. Këto burime do të të japin të gjitha pasazhet biblike që merren me zemërimin. Sigurisht që fjala “zemërim” shfaqet me qindra herë në Bibël dhe shumë prej prej tyre u referohen tregimeve në të cilat një person zemërohet. Të tjerë i referohen zemërimit të Perëndisë, atij të mbretërve, etj... Që studimi yt të jetë efektiv në trajtimin e problemit tënd specifik, duhet ta ngushtosh kërkimin.

Pastaj mund të provosh një temë biblike, ose enciklopedi biblike, si në formë libri, ashtu edhe në burimet kompjuterike që të shikosh për fjalën “zemërim”. Ndërsa lexon artikullin, do të shpjegosh përdorimet e ndryshme të fjalës, duke përfshirë një diskutim për shfajësimin dhe mosshfajësimin e zemërimit. Do të të tregojë paralajmërime të Biblës kundër zemërimit, që do të shpjegojë se në ç'rrethana zemërimi është gabim. Do të të referojë Shkrime që kanë të bëjnë me zemërimin në këto kontekste. Artikulli do të trajtojë vetëpërbajtjen si mjet i frenimit të zemërimit.

Më pas mund të ndjekësh këto referime. Shiko pasazhet biblike të zbatueshme për zemërimin, për të pasur një kuptim më të mirë se pse humbja e kontrollit është e gabuar.

Përmendja e vetëpërbajtjes në artikullin e enciklopedisë të jep një tjetër pistë për të ndjekur, që t'i afrosh zgjidhjes së problemit me temperamentin. Lexoje përsëri artikullin për vetëpërbajtjen, ndiqe duke parë pasazhet biblike të zbatueshme. Shkruaj çdo pjesë që gjen, i cili merret specifikisht me çështjen e zemërimit dhe humbjes së vetëpërbajtjes. Pasi t'i kesh shënuar pasazhet, mund t'i zbatosh shtatë pyetjet e kapitullit të mëparshëm dhe të përfshish procesin zbatues që ke mësuar atje.

Skica e rasteve të krizave gjatë studimit biblik

Tani dua të të jap një arsye tjetër për të gjetur ndihmë në disa sfera të kriszës, që janë të zakonshme për shumë prej nesh. Një skicë që përmban një listë të kategorizuar referimesh biblike që do të të ndihmojë të gjesh pasazhet që zbatohen ndaj nevojës, ose lëndimit tënd. Fakti që Bibla përmban shumë ndihmesa praktike për vështirësitë dhe krizat tona është në vetvete një ndërtues besimi. Tregon se sa shumë kujdeset Perëndia për ne dhe se dëshiron të na shërbejë në dhimbjen tonë. Njohja e këtij fakti është një burim i fuqishëm shprese dhe guximi.

Vargjet biblike në këtë skicë do të të ndihmojnë të gjesh atë që Perëndia ka për të thënë për problemin, tensionimin tënd ose vendimin e vështirë që duhet të ndërmarrësh. Unë jam i bindur se kur një i krishterë sheh atë që ka për të thënë Bibla, ai ose ajo e ka më të lehtë të ndreqë mendime dhe veprime që nuk përputhen me Perëndinë. Kjo vlen sidomos për ata që i kanë zemrat e ndjeshme ndaj Perëndisë.

Unë lutem që këto ndihmesa të jenë përfituese, të të afrojnë me Perëndinë që të do duke e ditur me siguri që përgjigjen ke për ta gjetur në zemrën e vetë Perëndisë.

Skica e rasteve të krizave gjatë studimit biblik		
Braktisje	Psalmi 27:10 Mat. 28:18,20; Gjoni 14:16	2 Kor. 4:9 Heb. 13:5
Pranim	Rom. 3:30 Gal. 2:16	1 Gjoni 1:8-10
	Rom. 8:18, 23-25 Job 2:10 Predikuesi 5:19	Luka 1:38 1 Kor. 7:17 Heb. 10:34
Varësi	Gal. 5:22-23 Rom. 8:5-9 12:2;	1 Gjoni 4:4 5:4-5 1 Pjet. 5:6-7
Nevoja për dashuri	Veprat 27	

Alkoholi dhe droga	Zan. 1:28 Num. 6:2-4 L. i Përt 6:4 Psalmi 55:22 104 F. e Urta 20:1 23:20 23:29-35 31:4-6 Isa. 5:11 Mat. 11:19 16:27-29 27:34 Marku 15:23 Luka 7:33, 34 10:34 Gjoni 2:9, 10 14:6 Rom. 12:1 13:1-5	Rom. 13:13 14:21 1 Kor. 5:11 6:10-12 6:19, 20 Gal. 5:16-21 Efes. 5:18 Kol. 3:2 1 Tim. 2:5 5:23 1 Thes. 5:4-8 1 Pjetrit. 1:13 2:13-17 4:3, 4 5:7 Zbul. 9:20, 21 18:23 21:8 22:15
Zemërimi	Psalmi 2:5-9 7:11 10 95:11 130:3, 4 Isa. 48:9 Dan. 9:9 Amos 5:18-20	Nah. 1:2, 3 1:6-8 Marku 3:5 Rom. 1:18 2:5 1 Thes. 1:10 2:1b
PARAJMËRIME PËR ZEMËRIMIN NJERËZOR		
	Psalmi 37:8 F. e Urta 10:18 14:17, 29 15:1, 18 16:32 20:3, 22 22:24, 25 24:29 26:24	F. e Urta 27:5, 6 29:11, 20, 22 Pred. 7:9 Mat. 5:22 7:1-5 Luka 17:3, 4 Rom. 12:19 14:4 2 Kor. 7:8-10

Zemërimi (vazhdim)	PARAJJMËRIME PËR ZEMËRIMIN NJERËZOR (vazhdim)	
	Gal. 5:20 Efes. 4:26-32 Kol. 3:8 2 Tim. 4:2 Heb. 12:15	Jakobi 1:19, 20 3:3-14 4:1 5:9
	TË PËRBALLESH ME TË	
	Zan. 4:5-7 F. e Urta 15:28 19:19 22:24, 25	F. e Urta 25:15 Mat. 2:16 Marku 10:14 Gjoni 4
	PASOJAT	
	Psalmi 73 F. e Urta 14:17 25:28	Mat 5:38; 44 Efes. 4:30, 31
Shqetësimi	E KEQJA	
	Psalmi 55:22 121 Mat. 6:25-34	Veprat 27 Fil. 4:6, 7 1 Pjet. 5:7
	E MIRA	
	2 Kor. 11:28	Fil. 2:20
	TË MERRESH ME "SHËRIMIN"	
	Gjoni 14:1-3 14:18, 27 Fil. 4:4-9	Heb. 13:6 Jakobi 1:22 1 Gjonit 4:18
Vdekje	Psalmi 23:6 F. e Urta 3:21-26 14:32	1 Kor. 15:54-58 Fil. 1:21, 23 Heb. 2:14, 15
Marrja e vendimeve	2 Tim. 3:15-18	Heb. 11:23-27
Depresioni	[DËSHPËRIMI]	
	Zan. 4:6, 7 Eksodi (Dalja) 6:9 Num. 11:10-15	1 Mbret. 19 Jobi 3 Psalmi 23:4

Depresioni	[DËSHPËRIMI] (VAZHDIM)	
(vazhdim)	Psalmi 27 32 34:15-17 38 40:1-3 51 69 88 102 103:13, 14 121 F. e Urta 18:14	Vajtimet Mat. 5:12 11:28-30 26:37, 38 26:75 Gjoni 4:1-3 15:10, 11 Veprat 27 Rom. 8:28 15:13 2 Kor. 4:8, 9 Efes. 1:3-14
	TË PËRBALLESH ME TË	
	Gjoni 14:1-14 14:26, 27 Kol. 1:16, 17	Heb. 1:3 13:5
	TA PARANDALOSH	
	Fil. 4:11-13	Fil. 4:8
Dëshira	Zan. 3:6 Dalja 20:17 F. e Urta 10:3, 24 11:6 28:25 Mat. 6:21 Luka 12:31-34 Rom. 13:14 Gal. 5:16	Efes. 2:3 Titi 2:12 3:3 Jakobi 1:13-16 1 Gjonit 2:16 Juda 18 1 Pjetr. 1:14 4:2, 3
Disiplina	F. e Urta 3:11, 12 13:24 19:18 22:6, 15 23:13 29:15 1 Kor. 5:1-13	1 Kor. 11:29-34 2 Kor. 2:1-11 12:7-10 Efes. 6:1-4 1 Tim. 4:7 Heb. 12:5-11

Divorci	Zan. 2:18-25 Eksodi (Dalja) 20:14 L. i Përt. 24:1-4 Isaia 50:1 Jer. 3:1 Mal. 2:16 Mat. 5:2 5:27, 28 5:31, 32 6:14, 15	Mat. 19:3-9 Marku 10:2-12 Rom. 6:1-2 12:1-2 13:14 1 Kor. 7:10-24 7:33-34 7:39-40 Jakobi 5:16
	SHKAQET	
	1 Kor. 7:10-15	
	PARANDALIMI	
	1 Sam. 12:33	
Durimi	Psalmi 40:1-3 Gjoni 11 Veprat 27	2 Kor. 12:7-10 Heb. 12:5-11
Ambicja	Titi 3:5 Jakobi 3:14-16	1 Pjet. 2:1
Frika	Zan. 3:10 Psalmi 103 121 F. e Urta 10:24 29:25 Mat. 10:26-31	Veprat 27 2 Tim. 1:7 Heb. 2:14, 15 1 Pjet. 3:6 3:13, 14 1 Gjonit 4:18
Financa	L. i Përt. 8:11-14 Jobi 31:24-25 31:28 Psalmi 49:10-12 52:5-7 62:10 F. e Urta 3:9 10:9 11:1 15:27	F. e Urta 17:23 19:17 22:7 23:4, 5 27:24 28:20 30:7-10 Pred. 5:10 Mat. 6:24-34 18:23-25

Financa (vazhdim)	Mat. 19:16-24 25:14-30 Marku 6:7-11 8:36 Luka 12:13-21 16:19f Rom. 13:6-8	1 Kor. 16:2 2 Kor. 8:14, 15 9:7 Fil. 4:18, 19 1 Tim. 6:7, 10 Heb. 13:5
	SHKAQET	
	Eksodi (Dalja) 20:17 Psalmi 72:2, 3 F. e Urta 3:9-10 3:27-28 11:15 11:24, 25 14:21 17:18 19:15, 17 21:5 22:7	F. e Urta 22:26, 27 28:20, 22 Pred. 5:15-17 Mal. 8:10 Luka 3:11 6:38 12:15-21 Rom. 18:8, 9 Gal. 6:10 1Thes. 3:10 Zbul. 3:17
	TË PËRBALLESH ME:	
	Zan. 1:28 Eksodi 20:15, 27 Psalmi 50:10-12 50:15	Psalmi 55:22 Mat. 6:25-34 25:14-29 1 Pjet. 5:7
Falja	Psalmi 32 103 F. e Urta 17:9 Mat. 6:14, 15 18:15-17 Marku 11:25	Luka 17:3-10 Efes. 4:32 Kol. 3:13 Jakobi 5:15 1 Gjonit 1:8-10
Miqësia	F. e Urta 27:6, 10 17:9, 17	Gjoni 15:13-15
Dashuria dhe Pranimi i Perëndisë	Psalmi 27 103	Luka 15 Veprat 27

Thashethemet	F. e Urta 10:18 11:13 18:8	F. e Urta 20:19 26:20-22 Jakobi 4:11
Hidhërimi	2 Sam. 12 Psalmi 6:5-7 23:4 119:28 137:1, 5, 6 F. e Urta 14:13 15:13 Mat. 5:4 14:12-21	Mat. 26:38 Gjoni 11 1 Kor. 15 2 Kor. 4:14-5:8 Efes. 4:30 1 Thes. 4 2 Tim. 1:10 Heb. 2:14, 15 9:27
Ndjenja e fajit	Psalmi 32 103 Isaia 53:6 Mat. 6:12 18:21f	Luka 15 Rom. 8:23 2 Kor. 7:8-10 1Pjet. 1:24 1 Gjonit 1:9
	SHKAQET	
	Zan. 2:17 3:4, 5 3:8, 22 Jobi 1:9-11 Gjoni 14:26	Gjoni 16:8, 13 Fil. 3:12-16 1 Tim. 4:2 1 Gjonit 1:8-10 Zbul. 12:10
	PASOJAT	
	Psalmi 73 Rom. 6:23	1 Gjonit 1:9
	TË PËRBALLES ME:	
	1 Sam. 16:7 Psalmi 103:14 139:1-4 Gjoni 8:3-11	Jakobi 5:16 1 Pjet. 3:18 1 Gjonit 1:8, 9
	PARANDALIMI	
	Efes. 4:32	

Veset	F. e Urta 19:19 Isaia 1:10-17 Jer. 13:23 22:21 Rom. 6-7	Gal. 5:16-21 1 Tim. Heb. 5:13f 1 Pjet. 2:14, 19
Homoseksualiteti	Zan. 19 Lev. 18:22 20:13	Rom. 1:26-32 1 Kor. 6:9-11 1 Tim. 1:10
Shpresa	Psalmi 27 40:1-3 119 121 F. e Urta 10:28 13:12	Veprat 27 Rom. 15::4, 5 1Thes. 1:3 4:13-18 Heb. 6:11, 18-19
Të ndjerit i pashpresë, i dëshpëruar	Psalmi 27 40:13 103	Psalmi 121 Gjoni 11 Veprat 27
Përrulja	F. e Urta 13:34 15:33 16:19 22:4 29:23 Gjoni 13:1-17	Gal. 6:1, 2 Efes. 5:15-21 Fil. 2:1-11 Jakobi 4:6, 10 1Pjet. 5:6, 7
Përtacia	F. e Urta 12:24, 27 13:4 15:19	F. e Urta 18:9 26:13-16 Mat. 25:26
Jetë e mbushur me telashe	1 Kor. 6:9-12 21:8 Efes. 5:18	Zbul. 21:8 22:15
Vetmia	Zan. 2:18 Psalmi 25:16 121 Luka 15	Gjoni 11 Veprat 27 Efes. 1:3-14 2 Tim. 4:9-12
	TË PËRBALLESH ME:	
	F. e Urta 18:24 Gjoni 3:16	Rom. 8:9 8:14-17

Vetmia (vazhdim)	TË PËRBALLESH ME: (VAZHDIM)	
	Rom. 8:26-31 8:35, 39 1 Kor. 6:19	1 Gjonit 1:9 4:13
Dashuria	F. e Urta 10:12 17:19 Mat. 5:44 22:39, 40 Rom. 13:10	1 Kor. 13 1 Pjet. 1:22 1 Gjonit 4:10, 19 5:2, 3 2 Gjonit 5, 6
Gënjeshttra	Eksodi (Dalja) 20:16 F. e Urta 12:19, 22	Efes. 4:25 Kol. 3:9
Probleme me martesën	Zan. 2:18-25 L. i Përt. 24:1-4 F. e Urta 5:18 8:22 19:13 21:9 19 27:15, 16	Pred. 9:9 Mat. 5:31, 32 19:3-9 1 Kor. 7:10-16 Efes. 5:21-33 Kol. 3:18-25 Heb. 13:4 1 Pjet. 3:1-7
	SHKAQET	
	1 Kor. 7:12-16 2 Kor. 6:14-16 Efes. 5:21-33	Kol. 3:18-25 1 Pjet. 3:1-7
Martesa	Zan. 2:18, 24 Efes. 5:22-33 Kol. 3:18-21	1 Pjet. 3:1-17 1 Tim. 3:4, 5
Prind / fëmijë	Zan. 2:24 2 Kor. 12:14	Efes. 6:1-4 1 Tim. 3:4, 5
Paqe	Psalmi 40:1-3 119 121 F. e Urta 3:1, 2 16:7 Gjoni 11 14:27	Rom. 5:1 12:18 14:19 Fil. 4:6-9 Kol. 3:15 Heb. 12:24

Krenaria	F. e Urta 8:13 11:2 13:10 16:18	F. e Urta 18:12 21:24 27:1 29:23
Pendimi	Luka 3:8-14 24:47 Veprat 3:19 5:31	Veprat 17:30 26:20 2 Kor. 7:10 12:21
Lëndimet	F. e Urta 26:24-26	Heb. 12:15
Vetë-vlerësimi	Luka 15	Efes 2:3-14
Sëmundjet	Psalmi 119:71 Mat. 9:2-6 9:18-21 9:23-26 10:5-8 13:58 25:39, 40 Marku 6:7-13 7:24-30 9:20-27 Luka 9:1, 2, 6	Luka 13:1-5 Gjoni 9:2, 3 Rom. 5:3-5 8:28 1 Kor. 11:29, 30 2 Kor. 2:7-10 Heb. 9:27 12:22 Jakobi 1:2-4 5:14-16 1 Pjet. 1:5-7
	TË PËRBALLESH ME:	
	Rom. 11:33 1 Kor. 12:25, 26 Heb. 11:1	Jakobi 5:6 1 Gjonit 1:9
Beqaria	Zan. 2:18 Mat. 19:11, 12 1 Kor. 7:7, 28	1 Kor. 7:32-35 Heb. 12:15, 16
Telashet	F. e Urta 12:25 14:30 17:22	Mat. 6:24-34 Fil. 4:6, 7 1 Pjet. 5:6, 7

12

TI MUND TA BËSH

Realizimi i studimit biblik

Tani që kemi kaluar së bashku përmes pjesëve të Ungjillit të Gjonit dhe kemi mësuar një proces për të gërmuar thellë në Bibël që të kuptojmë atë që na thotë, jam i sigurt se tashmë e ke fituar vetë zellin për të zënë libra të tjerë. Ky zell do të të japë vrullin që të fillosh procesin dhe të kapesh diku për të vazhduar, por siç kam thënë edhe në kapitujt e mëparshëm, emocionet nuk mjaftojnë për të të mbajtur. Ndërsa risia shterohet dhe përfshihesh në punën e vështirë të studimit të Biblës, ky zell mund të avullojë e atëherë, çfarë do të të nxisë të vazhdosh?

Të duhen tri gjëra për të patur disiplinën dhe motivimin për të vazhduar kur mund të bësh diçka më të lirë. Duhet të kesh një plan, përparësi dhe një premtim. Në këtë kapitull të shkurtër, do të të jap një udhëzim të vogël në lidhje me të treja.

Një plan për studimin biblik

Kam njohur disa njerëz maniakë që jetonin çdo çast të jetës së tyre me një program të ngjeshur të planifikuar në detaje; çdo furnizim me vaj të makinës së tyre në faturat përkatëse, edhe këmishat të sistemuara mirë sipas ngjyrave.

Ata i programonin me hollësinë më të imët orët e mëngjesit, kafen do ta përfundonin në orën 07:23, dhëmbët do t'i lanin në 07:29, do të niseshin për në punë në 07:33 dhe në orën 07:57 do të shkonin për në zyrë. Unë nuk jam një nga këta njerëz. Duhet të kem dikë që të dijë se ku i kam lënë këpucët herën e fundit. Unë mendoj se shumica e njerëzve ngjajnë më shumë me mua se sa me atë që u përshkrua më lart.

Por unë kam mësuar se, nëse nuk ke pak disiplinë dhe një plan që të të udhëheqë e disiplinohë për të bërë atë që duhet të bësh, nuk mund

t'ia dalësh. Nuk mund ta mbash gjallë pasi shterohen emocionet. Ideja e të ndjekurit të një plani rigoroz për studim biblik i tremb disa njerëz që në fillim, por pa plan nuk realizohet.

Qëllimi im këtu nuk është të të imponoj një plan specifik, të përbashkët për të gjithë, te të cilin duhet të ndërtosh jetën. E kuptoj se jemi të gjithë të ndryshëm dhe secili prej nesh ka nevojë për një plan që do të përputhet me situatën dhe prirjet personale.

Aspekti i parë i këtij plani është të gjesh një kohë studimi të rregullt. Njoh njerëz që zgjohen në orën 6:00 dhe kalojnë një orë të tërë në studim biblik para se të nisin ditën, por njoh të tjerë për të cilët një program i tillë do të ishte i vështirë. Ata nuk zgjohen herët në mëngjes dhe, nëse zgjohen aq herët, rreth orës 10:00, nuk do mbajnë mend se kur e kanë hapur Biblën. Të tjerë mund të kalojnë në kohën e drekës 15-30 minuta për çdo ditë në të njëjtën kohë, edhe para se të flenë.

Është e qartë se një infermiere që punon turnin e natës nuk mund të dojë të studiojë në 5:30 të mëngjesit, orar që shihet si “i përshtirshëm”. Nuk ka gjë shpirtërore t’u shërbesh të sëmurëve të nesërmen me sytë gjysmë të hapur për të lexuar etiketat e ilaçeve. Duhet të gjesh kohën e përshtatshme dhe t’i përmbahesh asaj.

Tipari vijues i planit tënd është të përcaktosh kohëzgjatjen e studimit tënd. Sa kohë do të kalosh me të? Mund të nisësh me 30 minuta në ditë, pastaj kalo në një orë a më shumë, ndërsa kultivon zakonin e studimit. Shpejtësia e leximit dhe aftësia për të kapur lëndën do të jetë faktor vendimtar. Disa njerëz mund të përmbushin brenda gjysmë ore atë, për të cilën disa të tjerëve do t’u duheshin dy orë. A do të studiosh çdo ditë, shtatë ditë në javë? Apo pesë ditë, apo gjashtë? Ndoshta je nënë e re me tre fëmijë parashkollorë dhe do të jesh me fat po të gjesh 15 minuta të lira në ditë. Shumë mirë, bëje brenda 15 minutash. Në fillim nuk është sasia ose cilësia e kohës së studimit që ia vlen, por qëndrueshmëria. Rëndësi ka që të kalosh rregullisht kohë me Fjalën. Vetëm kjo kohë do të jetë mjaft e vlefshme.

Përparësia e studimit të Biblës

Ndoshta ke vendosur ta marrësh seriozisht studimin e Biblës, por e ke ditën të ngjeshur. Udhëtimi nga puna dhe për në punë zgjat nëntë orë. Dreka të merr një orë dhe dëshiron ta kalosh gjysmën tjetër duke lexuar gazetën. Në fund të fundit, çdo njeri duhet të dijë se ç’bëhet në botë. Pastaj, kur kthehesh në shtëpi, qetësohesh duke ndjekur edicionin informativ dhe pas darke, ndjek programin e preferuar televiziv, së bashku me gruan. Pastaj, e ka radhën pasioni yt, rregullimi i një veture

të prodhimit të vjetër në garazh. Pas një dite plot stres, të duhet një variacion i tillë. Sigurisht që të duhen 30 minuta për t'u marrë me një punë rutinë, para se të biesh për të fjetur. Pastaj, lajmet përsëri, që të informohesh dhe menjëherë në shtrat. Me këtë program vendos se koha më e mirë është brenda 10 minutash, për ndoshta katër ditë në javë.

Kjo është diçka, por çfarë tregon ky program për përparësitë e tua? A janë gjithë këto aktivitete më të rëndësishme se sa studimi biblik? Vënia e përparësive tregon se ku ndodhet zemra. E nxis çdo të krishterë që ta lexojë këtë libër për të shqyrtuar mirë aktivitetet ditore, para se të vendosë programin e studimit biblik. Mund të të duhet të heqësh dorë nga ndonjë aktivitet, ose të marrësh kohë nga një ose disa aktivitete të tjera dhe t'ia kushtosh studimit biblik. Është sakrificë dhe diçka që të krishterët duhet ta bëjnë.

Premtimi i studimit biblik

Dakord, e pranoj se pika e fundit nuk ka të bëjë me përcaktimin e programit, por me rezultatin e këtij përcaktimi. Dua të të them çfarë të premtos Perëndia, nëse do të jesh i zellshëm për të studiuar Fjalën e Tij.

Sipas Hebrenjve 4:12, Bibla mund të na zbulojë dëshirat tona më të thella: “Sepse fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe dhe depërton deri në ndarjen e shpirtit dhe të frymës, të nyjeve dhe të palcave dhe është në gjendje të gjykojë mendimet dhe dëshirat e zemrës”. Pastaj, te 2 Tim.3:16, ne shohim se si na ndihmon të kuptuarit e Shkrimeve për t'i kontrolluar këto dëshira: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi”. Nëse zhytemi në Fjalën e Perëndisë, ai do të na mësojë, stërvisë dhe konformojë sipas shëmbëllimit të Krishtit. Kur të vërtetat e Biblës bëhen pjesë jetike e jetëve tona, ne provojmë rritje të vërtetë shpirtërore. Ne kemi fitore te rrethanat dhe mbushemi me gëzim teksa shohim Perëndinë të veprojë në jetët tona.

Ti mund të shohësh gjatë gjithë Psalmit 119 rëndësinë e Fjalës së Perëndisë dhe bekimet që rrjedhin prej saj. Siç na thotë Perëndia te Jozueu 1:8, kur e ruajmë Fjalën e tij në mendjet tona vazhdimisht, kur meditojmë ditë e natë për të, mësohemi t'i bindemi atij. Si pasojë, do të jemi të begatë dhe të suksesshëm, jo patjetër në gjërat materiale, por në përmbushjen e veprës së tij në ne dhe përmes nesh dhe ky është një sukses i vërtetë. Ky është premtimi i Perëndisë dhe mund të mbështetesh në të.

Shtojca

SHTOJCA A

Parafrazim, studim tematik dhe studim biografik

Ndonjëherë bëj tre ushtrime shtesë te pasazhe të caktuara për shkak të ndihmesës së specializuar që më ofrojnë. Nuk po i përfshij këto ushtrime brenda tekstit kryesor të këtij libri, sepse i kam konsideruar fakultative. Nuk dua të ndërhyj në renditjen e metodave të skicimit dhe përmbledhjes, që mendoj se janë kritike për të përfshirë një student te Fjala, por i ofroj këto ushtrime këtu për këdo që i konsideron si të vlefshme.

Parafrazimi

Ndonjëherë parafrazimi i një pasazhi është ndihmues për të pasur një kuptim më të qartë të mesazhit të tij. Shprehja e një ideje ose tregimi me fjalët e tua të ndihmon të depërtosh brenda tij. Procesi i gjetjes së fjalëve alternative për të shprehur idenë, ta zgjeron të kuptuarit. Skica e thjeshtë për parafrazimin që gjendet në këtë shtojcë do të të udhëheqë përmes të shkruarit të një parafrazimi në një pjesë të caktuar.

Studimi tematik

Ka raste kur duhet të mësosh ç'thuhet në Bibël rreth një teme të caktuar, metoda më e mirë mund të jetë një studim tematik. Shembujt tanë mësimorë në këtë libër kanë qenë të bazuar te studime pasazhesh, duke iu drejtuar temave të ndryshme që dalin prej tyre, por, nëse duhet të mësosh gjithçka që mundesh rreth një teme, p.sh., “dembelizmi”, duhet ta drejtosh studimin në një tjetër mënyrë. Skica e mëposhtme reth Studimit Tematik do të të udhëheqë në procesin e studimit të një pasazhi të caktuar.

Studim biografik

Lloji i tretë i studimit të ndryshëm në këtë shtojcë është Studimi Biografik. Një studim specifik tematik, ku subjekti është person dhe jo ide, ose koncept. Skica e tretë që pason do të të udhëheqë në procesin e studimit bibliografik.

Parafraza

Një tjetër hap ndihmës në të kuptuarit dhe mësuarit të Shkrimeve është të bërit e parafrazës për të parë hollësitë e pasazhit që po studiohet.

Si të shohësh hollësitë e pasazhit duke shkruar parafrazën.

- A. Si të parafrazosh: Të parafrazosh një pjesë të Shkrimit do të thotë të studiosh një pjesë dhe më pas ta formulosh me fjalët e tua.
- B. Si mund të të ndihmojë parafrazimi:
 1. Parafrazimi kërkon të mendosh mjaftueshëm në çdo hap të leximit të pasazhit për ta formuluar më pas me fjalët e tua. Kjo qartëson të menduarit në të vërtetat e paraqitura.
 2. Gjithashtu ndihmon në komunikimin e të vërtetave shpirtërore me të tjerët. Duhet të shprehësh të vërtetat në një mënyrë të atillë që mund të kuptohet lehtësisht nga të tjerët përreth. Paraqite në një shqipe bashkëkohore. (Mesazhi i Eugene Peterson është një parafrazim modern që mund të merret si shembull model).
- C. Si të përdorësh shumëllojshmërinë në parafazë:
 1. Një parafrazë normale: Është një lloj parafrazimi ku merr nga një fjali nga pasazhi dhe e riformulon me fjalët e tua. Është e rëndësishme që të ndryshohet i gjithë pasazhi duke lënë sa më pak fjalë të origjinalit në formulimin e ri.
 2. Një parafrazë e përmbledhur: Ndoshta kërkon ta reduktosh pasazhin në dy të tretën, gjysmën ose edhe një të tretat e gjatësisë së origjinalit. Përpiqu të mos lësh jashtë pjesët thelbësore. Ky lloj është veçanërisht i mirë për pasazhet e gjata ose ato përshkruese.
 3. Një parafrazë e zgjeruar: Mund të të interesojë ta zgjasësh pasazhin edhe njëherë sa origjinali. Atëherë do të të duhet të shpjegosh plotësisht domethënien e pasazhit. Ky lloj mund të përfshijë interpretim dhe shpjegim të gjërave që nuk janë të qarta. Është e përshtatshme më shumë për pasazhet doktrinale se ato përshkruese.

4. Përdorimi i imagjinatës: përdor imagjinatën për parafrazimin.
 - a. Herë pas here përpiqu të ndryshosh ilustrimet duke i sjellë më pranë në kohë. Në vend që të thuash që Fjala e Zotit është “më e mprehtë se një shpatë me dy tehe” mund të thuash se është “më e mprehtë se bisturia e një kirurgu”.
 - b. Mund të imagjinosh sikur po u shkruan ose po u drejtohesh disa njerëzve. Për shembull, do të të duhet të parafrazosh një prej letrave të Palit. Ndaj imagjino sikur po i shkruan një miku që sapo është bërë i krishterë dhe të duhet t’i shpjegosh të vërtetat e letrave me gjuhën e përditshme, të sotme.

Studimi Tematik**I. Çfarë është një studim tematik?**

- A. Në vend që të studiohet një libër i tërë ose qoftë edhe një pjesë e tij, studimi tematik ka për qëllim përcaktimin e asaj çfarë Shkrimi të mëson rreth një teme të dhënë. Për shembull, do të të duhet të studiosh se çfarë thotë Bibla në lidhje me “përtacinë”.
- B. Për një studim doktrinal, thjesht zgjidh një temë doktrinale si për shembull doktrina e shfajësimit.
- C. Në varësi të kohës që ke në dispozicion mund të të duhet të zgjedhësh një pjesë nga Shkrimi prej të cilit ke zgjedhur materialin. Për shembull: “Doktrina e Krishtit të Kolosianëve”, ose “Përdorimi i termit fëmijë në shkrimet e Gjonit”.
- D. Çelësi për një studim të mirë tematik qëndron te përzgjedhja e një teme të mirë.

II Si ta përzgjedhësh materialin për një studim tematik?

- A. Përdor një konkordancë. Shih përdorimin e fjalëve që lidhen me temën.
- B. Ndër-referimet. Njëherësh kur të gjesh disa pasazhe që lidhen me temën e përzgjedhur, do të ndeshesh shpesh edhe me ndër-referime prej këtyre pasazheve kundrejt të tjerave.
- C. Fjalori biblik. Kjo mund të të japë si informacion të mirë ashtu edhe referenca të mëtejshme nga shkrimi për temën e përzgjedhur.
- D. Tema e listuar. Ndonjëherë referenca nga versione të ndryshëm biblikë të sjellin një listë mundësish referencash në lidhje me temën. Ka edhe Bibla tematike, si Bibla Tematike e Nave, që të sjell një tekst të tërë me pasazhe të ndryshme që lidhen me llojshmëri temash.
- E. Nëse e ke kufizuar temën vetëm me disa pjesë të Shkrimit, si “Lutjet e Palit në letrat e tij” do të të duhet të lexosh ose skanosh materialin për t’u përqendruar në sesionet që të nevojiten.

III Si ta organizosh materialin që ke përzgjedhur?

- A. Njëherësh që ke përzgjedhur materialin, studioje dhe mbaj shënime rreth gjërave që i konsideron të rëndësishme për t'u mbajtur mend.
- B. Studio shënimet dhe kategorizoji. Grupo bashkë idetë e ngjashme. Thekset e ndryshme të vargjeve të ndryshme do të japin të kuptojnë tema të ndryshme për skicën. Kategorizimi i vargjeve mund t'ju shërbejë për ta zgjeruar studimin në vazhdimësi në disa fusha të caktuara.
- C. Hidhe materialin në një skicë logjike. Nise si tentativë skice duke e përmirësuar hap pas hapi. Përpiku të futësh në të gjithë materialin që ke.

IV. Si ta bësh të zbatueshëm një studim tematik?

Shih parimet e aplikimit në kapitullin dhjetë të *Udhëzues për të kuptuar Biblën nga Xhosh Mekdauelli*.

Studimi Biografik

Ky është një studim tematik i specializuar – tema lidhet me personin.

- I. Si të hulumtosh një studim biografik?
 - A. Gjëra për të patur parasysh.
 1. Materiali do të përdoret me të njëjtën metodë ashtu si në studimin tematik.
 2. Ji i kujdesshëm ndërsa përdor një fjalor biblik që nuk do të ndikojë në mënyrën tënde të të mënduarit ose në nxjerrjen e përfundimeve të gatshme. Është gjë e mirë konsultimi me një fjalor biblik, por pasi ke bërë arsyetimin tënd.
 3. Disa personazhe kanë më shumë se një emër si, Sauli për Palin, Kefa dhe Simoni për Pjetrin, Izraeli për Jakobin. Sigurohu që disponon të gjitha referencat rreth personit.
 4. Në disa raste emrat biblikë janë përdorur për më shumë se një person si, Sauli, Gjoni, Maria, etj.. Sigurohu që je duke lexuar personin që po studion.
 5. Disa personazhe mbulojnë një pjesë të gjerë të Shkrimit dhe do të duash ta kufizosh studimin në një fazë të veçantë të jetës së personit. (Shembull: Jeta e lutjes së apostullit Pal.)
 - B. Gjëra për të kërkuar. Më poshtë jepen sugjerime rreth asaj që duhet të kërkosh për studimin tënd. Ndonjëherë, për shkak të mungesës së informacionit rreth një individi të caktuar, mund të mos jetë e mundur të gjesh gjithçka të nevojitet. Në fakt, kjo nuk mendohet të jetë një metodë rraskapitëse por thjesht një udhëzues. Gjatë kërkimit të informacionit rreth personit që po studion, mund të mendosh të tjera alternativa të studimit.
 1. Prejardhja
 - a. Cilat ishin rrethanat e lindjes së tij – kur, ku, etj?
 - b. Cilët ishin prindërit e tij, po familja? Si ishin ata? Si ishte situata shpirtërore?
 - c. Si ndikoi mjedisi dhe mësimet e hershme në jetën e tij të mëvonshme?
 - d. Çfarë faktorësh të tjerë ndikuan në përgatitjen e tij për jetën?

2. Faktorë kryesorë të rritjes së tij
 - a. Cili ishte profesioni i tij kryesor dhe çfarë rezultatesh ka patur?
 - b. Për çfarë është dalluar më së shumti?
 - c. Cilët kanë qenë njerëzit më të rëndësishëm në jetën e tij? Miqtë, armiqtë, familja? Çfarë ndikimi kanë patur të tjerët në jetën e tij dhe anasjelltas?
 - d. Gjeografikisht – ku jetoi dhe shërbeu?
 - e. Çfarë marrëdhënie pati me Perëndinë? Si ndikoi kjo në jetën dhe arritjet e tij?
 - f. A shkroi ndonjë pjesë të Shkrimit? Çfarë tregon kjo për atë si person?
3. Ngjarje kryesore
 - a. Cilat ishin ngjarjet kryesore të jetës së tij? Po krizat kryesore?
 - b. Cilat ishin periudhat apo fazat e ndryshme të jetës së tij? Cilat ishin pikat më kyçe që ndanin këto faza?
 - c. Si vdiq dhe si ndikoi vdekja e tij?
4. Karakteri
 - a. Çfarë karakteri kishte?
 - b. Cilat ishin pikat e tij të forta?
 - c. Po dobësitë?
 - d. Cilat ishin pasojat e pikave të forta dhe të dobëta të karakterit të tij?
 - e. Cilat ishin mëkatet e tij specifike? Çfarë pasojash pati për këto?
 - f. Cila ishte sjellja e tij e përgjithshme në lidhje me jetën dhe njerëzit e tjerë?
 - g. Cili ishte statusi i tij shpirtëror?
 - h. Çfarë parimesh themelore e drejtuan jetën e tij?
5. Ndikimi
 - a. Çfarë ndikimi pati te bashkëkohësit e tij?
 - b. Çfarë ndikimi pati në historinë pasuese?
 - c. Në rastet e personazheve të Dhiatës së Vjetër, zbulo në lidhje me:

- 1) A mund të ishte konsideruar një model i Krishtit? Nëse po, si?
 - 2) Nëse po, si e pasqyron Dhiata e Re?
6. Hollësitë. Përqendrohu te hollësitë. Këto i japin ngjyrë dhe shpesh janë domethënëse.

II Si ta organizosh materialin gjatë studimit biografik?

- A. Mund të të nevojitet ta rregullosh materialin sipas formës së skicës. Disa nga udhëzimet e mësipërme (B nën I) rreth asaj se çfarë të kërkosh mund të të sugjerojë kategori të tjera.
- B. Ndoshta do të duash ta pasqyrosh karakterin e një personi në formë skice.
- C. Përfundoje historinë duke shkruar një sesion zbatues për jetën tënde personale. Kjo mund të arrihet duke mësuar si nga anët pozitive, ashtu edhe nga ato negative të jetës së personazhit në studim.

SHTOJCA B

Skica model

Pjesa 1: Skicat e titullit

Pjesa 2: Skicat vëzhguese

Pjesa 3: Skicat e referimeve

Pjesa 4: Skicat interpretuese

Pjesa 5: Skicat zbatuese

Skica kryesore te Gjoni

Gr. 1	Gr. 2	Gr. 3	Gr. 4	Gr. 5	Gr. 6
Jezusi i njohur					
:1-5 I njohur si <i>Fjala</i>					
:6-8 I njohur nga <i>Gjoni</i>					
:9-13 I njohur nga <i>ne</i>					
:14-18 I njohur përmes <i>lavdisë së Tij</i>					
:19-28 I njohur nga <i>drejtuesit fetarë</i>					
:29-34 I njohur si <i>Qengji i Perëndisë</i>					
:35-42 I njohur nga <i>Andreu</i>					
:43-51 I njohur nga <i>Natanaeli</i>					

Skicat kryesore: Shembuj shtesë

Galatasve, Shembulli për studentin

Galatasve						
Kapitujt	1	2	3	4	5	6
Titujt e kapitujve	Autobiografia e Palit në jetën e hershme	Ungjilli i Hirrit për paganët	Ligji përkundrejt Hirrit	Liria në Krishtin	Ecja e lirë në Shpirtin	Porosi
Titujt e paragrafëve	:1-5 Përshëndetja :6-10 Një ungjill i vërtetë për t'u predikuar :11-17 Përgjegjësia e Palit për të predikuar :18-24 Reputacioni i Palit në Jerusalemin	:1-10 Aprovimi i apostujve :11-12 Pali ballafaqohet me Pjetrin	:1-14 Ligjet nuk janë rruga :15-22 Jezusi dhe ligji :23:29 Uniteti në Krishtin	:1-7 Të drejtat e birësimit në Krishtin :8-11 Njeriu i lirë i kthyer në skllavëri :12-20 Zhgënjimet e Palit :21-31 Shembulli i Isakut dhe Ismaelit	:1 Ji i lirë :2-12 Legalizmi i përjashtuar :13-15 Dashuria si rezultat i lirisë :16-24 Ecja në Shpirtin :25-26 Përujje nën Shpirtin	:1-5 Mbani barrët e njëri-tjetrit :6-10 Korje në Shpirtin :11-16 Lavdërim vetëm në kryq :17-18 Dëshmi e përmbledhur dhe mbyllja
Varg kyç	12	2	13	31	22	10
Fjala kyç	Zbulesa	Paganët	Ligji	I lirë	Shpirti	Korje

Skicat kryesore: Shembuj shtesë

Efesianëve, Shembulli për studentin

Efesianëve						
	1	2	3	4	5	6
Kapitujt						
Titujt e kapitujve	Pozicion i ri në Krishtin	Jetë e re në Krishtin	Dashuri e re në Krishtin	Unitet i ri në Krishtin	Sjellja e re në Krishtin	Mbrojtje e re në Krishtin
Titujt e para-grafeve	:1-2 Përshëndetja :3-14 Trashëgimia jonë :15-23 Lutja e Palit për ne	:1-10 I gjallë në Krishtin :11-22 Paganë dhe hebrej të bashkuar në një në Krishtin	:1-13 Sekreti i Perëndisë i zbuluar :14-19 Dashuria e Zotit e mishëruar :20-21 Bujaria e Zotit e zbuluar	:1-16 Trupi i pajtur me së miri :17-24 Ecja në trupin :25-32 Shenjtëria e trupit	:1-2 Ecja në dashuri :3-14 Ecja në dëlirësi :15-21 Ecja në Shpirtin :22-33 Ecja në unitet	:1-4 Familja :5-9 Sklevër dhe padronë :10-20 Armatimi i Perëndisë :21-24 Shënimet e fundit
Varg kyç:	9	5	6	15, 16	18	11
Fjala kyç:	Premtimi	I gjallë	Bashkë-trashëgimtarë	I gjithë trupi	Ecja	Mbrojtja (Armatimi)

Skicat vëzhguese: Shembuj shtesë

2 Timoteut 3: 16-17, Shembulli për studentin

Shkrimi	Vëzhgimet	Pyetjet
<p>2 Timoteut 3: 16 “I gjithë shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i domosdoshëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi</p>	<p>Të gjitha shkrimet përfshijnë në të tashmen foljen “jam” në këtë rast “është”</p> <p>Zoti është burimi – jo njeriu – madje as vetë shkruarit.</p> <p>1) “dhe” – bën të barasvlershme për nga rëndësia frymëzimin me domosdoshmërinë</p> <p>2) është frymëzuar për dobinë time</p> <p>3) I gjithi është i domosdoshëm – jo vetëm disa pjesë</p> <p>Mënyra është e domosdoshme – për gjërat e domosdoshme</p> <p>Mund ta përdor për të mësuar veten dhe të tjerët</p> <p>Do të më tregojë çfarë duhet të di</p> <p>Do të më tregojë ku e kam gabim</p> <p>Do të më tregojë çfarë duhet të bëj</p> <p>Do të më tregojë si të veprojmë drejt</p> <p>Më ndihmon për të jetuar në mënyrë të drejtë</p>	<p>Çfarë do të thotë “i frymëzuar”?</p> <p>Si është shpjeguar “i domosdoshëm” – në këtë varg?</p> <p>Çfarë do të thotë “i domosdoshëm”?</p> <p>Çfarë më mëson?</p> <p>Çfarë do të thotë “bindje” ?</p> <p>Ndreqje nga çfarë? – e gabuar në sytë e Perëndisë.</p> <p>Mësim në çfarë dhe për çfarë?</p> <p>Çfarë drejtësie apo drejtësie e kujt?</p> <p>Çfarë do të thotë “drejtësi” ?</p>
<p>2 Timoteut 3:17 “që njeriu (i Perëndisë) të jetë i përkryer, (tërësisht i pajisur) për çdo vepër të mirë”.</p>	<p>Nën qëllim (i varur)</p> <p>S’mund të kem rezultat pa shkak!</p> <p>Gjithçka e sipërpërmendur është për njeriun që dëshiron t’i përkasë Perëndisë – jo vetvetes</p> <p>Mund të jem tërësisht gati për gjithçka që më del para.</p> <p>Mund të kem të gjitha burimet e nevojshme për të bërë gjithë veprat e mira që Zoti më ka thirrur të bëj (Filipianëve 4:13, 1 Thesalonikasve 5:24)</p>	<p>Çfarë nënkupton “njeriu i Perëndisë” ?</p> <p>Çfarë do të thotë “i përkryer” dhe çfarë përfshin kjo në vetvete?</p> <p>Si pajisem?</p> <p>Çfarë është një vepër e mirë?</p>

Skicat vëzhguese: Shembuj Shtesë*Veprat 1: 1-8, Shembulli për studentin*

Shkrimi	Vëzhgimet	Pyetjet
:1	1. KUSH: Luka (autori), Teofili, Jezusi 2. ÇFARË: Traktati (Libri i Veprave) 3. KUR: Teofili – ishte një person, jo një vend 4. PSE: Për t’u treguar të gjithëve te atë që predikoi dhe bëri Jezusi	1. Pse njerëzit e Teofilit? 2. Pse është quajtur traktat?
:2	1. KUSH: Krishti, Shpirti i Shenjtë, apostujt 2. KUR: Ditën që ai u mor në qiell 3. PSE: Për t’u dhënë urdhërimet apostujve përmes Shpirtit të Shenjtë 4. SI: Shërbesës së Shpirtit të Shenjtë	1. Si i jep Shpirti i Shenjtë urdhërimet e Tij? 2. Cila është shërbesa e Shpirtit të Shenjtë?
:3	1. KUSH: Jezusi, ata (njerëzit), Zoti 2. ÇFARË: Duke treguar prova të sigurta, duke folur për gjërat e mbretërisë 3. KU: Pas kryqëzimit, gjatë 40 ditëve 4. PSE: Për të shfaqur veten të gjallë 5. SI: Provat, fjalimet	1. Si i tregoi provat e sigurta? 2. Si e tregoi veten të gjallë? 3. Çfarë ishte kryqëzimi?
:4	1. KUSH: Jezusi, ata (njerëzit), Ati 2. ÇFARË: Urdhërimet dhënë atyre 3. KUR: Kur të jenë mbledhur, në pritje për Atin 4. KU: Jo larg Jerusalemit 5. PSE: Për premtimin 6. SI: Nga Shpirti i Shenjtë	1. Pse ishin mbledhur? 2. Cili ishte premtimi i Atit?
:5	1. KUSH: Gjoni, ju (njerëzit), Shpirti i Shenjtë, Krishti (i dukshëm) 2. ÇFARË: Pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë 3. KUR: Jo shumë ditë më pas 4. SI: Përmes Shpirtit të Shenjtë	1. Cili është ndryshimi midis pagëzimit me Shpirtin e Shenjtë dhe atij me ujë?

Skicat vëzhguese: Shembuj Shtesë*Veprat 1: 1-8, Shembulli për studentin*

Shkrimi	Vëzhgimet	Pyetjet
:6	<ol style="list-style-type: none"> 1. KUSH: Ata (njerëzit), Krishti 2. ÇFARË: Marrja e tij në pyetje 3. KUR: Ngjitja e tij në qiell 4. PSE: Rimëkëmbja (ripërtëritja) e Izraelit 5. SI: Habi te nënkuptimet e thënieve të tij 	<ol style="list-style-type: none"> 1. A ishte marrja në pyetje para apo pas ngjitjes në qiell? 2. Çfarë nënkuptonte ai me formulimin e tij?
:7	<ol style="list-style-type: none"> 1. KUSH: Krishti, njerëzit, Ati 2. ÇFARË: Shpjegimi te Punët e Zotit 3. KUR: Kohë a stinë të panjohur 4. PSE: Sepse Ati nuk ua ka treguar kohën 5. SI: Përmes fuqisë së Atit të Tij 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pse nuk ua bëri të ditur Ati kohën kur?
:8	<ol style="list-style-type: none"> 1. KUSH: Krishti (i dukshëm), ju (njerëzit), Shpirti i Shenjtë, Njerëzit e Jerusalemit, Samarisë, Judesë dhe mbarë tokës 2. ÇFARË: Fuqi pas marrjes së Shpirtit të Shenjtë 3. KUR: Pasi Shpirti i Shenjtë zbriti te ata 4. KU: Në Jerusalem, Samari, Jude dhe mbarë tokën 5. PSE: Për të dëshmuar Krishtin 6. SI: Përmes marrjes së fuqisë së Shpirtit të Shenjtë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Si e marrin Shpirtin e Shenjtë? 2. Pse ndodh pas ngjitjes së Krishtit në qiell?

Skicat ndër-referuese: Shembuj shtesë*Gjoni 3: 1, Shembulli për studentin*

Ndër-referimi	Domethënia
“Krer”	
Luka 23:13	Lidhja me Pilatin Kategoritë Kryepifti Udhëheqësit
Luka 23:35	Përqeshnin Jezusin.
Gjoni 7:26	Udhëheqësit nuk besonin në Jezusin.
Gjoni 7:48	Nikodemi kishte frikë të fliste te lidhjen e tij me Jezusin.
Gjoni 12:42	Shumë krerë besuan në Jezusin- asnjëherë nuk e shprehën me zë të lartë nga frika e farisenjve. Farisenjtë mund t’i përjashtonin nga Sinagoga.
Veprat 3:17	Pjetri thekson që “udhëheqësit” vepruan nga padija kur e kryqëzuan Jezusin.
Veprat 4:5, 8	Dy kategori të tjera: Pleqtë dhe skribët. Pasi 500 besuan, udhëheqësit dhe të tjerët u mblodhën te kryepifti dhe mar-in në pyetje Pjetrin.
Veprat 13:27	Pali u tregoi drejtuesve judenj në sinagogë. Ai tha se as njerëzit, as udhëheqësit nuk e njohën atë dhe ta dallonin përmes mësimeve të tij.

Skicat Ndër-referuese: Shembuj shtesë*Galatasve 4:21-31, Shembulli për studentin*

Vargu	Ndër-referimi	Domethënia
v. 21	Luka 16:29	Të dyja pasazhet tregojnë për njeriun që dëgjon atë që thotë ligji
v. 22	Zanafilla 16, 17, 18:1-21	Këto pasazhe janë të dhëna historike te lindjen e dy fëmijëve të Abrahamit, njëri (Ismaili) nga një grua sllave, Hagara, dhe tjetri (Isaku) nga një grua e lirë, Sara. Pasazhet tregojnë edhe konfliktin midis dy grave dhe dy fëmijëve të tyre. Në këto jepet edhe premtimi i Perëndisë në lidhje me lindjen e Isakut.
v. 23	Romakëve 9:6-8	Ky është tregues që Zoti i sheh ndryshe bijtë e premtimit dhe bijtë e gjakut. Të parëlidhurit janë fëmijët e vërtetë të Zotit.
v. 24	1 Korintasve 10:11	Ndër-referimi konstaton se ngjarjet e ndodhura në Dhiatën e Vjetër u shkruan për të na mësuar ne. Pali përdor ngjarjet e së shkuarës si një alegori e së vërtetës shpirtërore.
v. 25	(Fjalori biblik)	Mali Sinai ishte vendi ku Moisiu mori Ligjin.
v. 26	Zbulesa 21:2	Ndër-referimi tregon për vizionin e Gjonit rreth Jerusalemit të ri që zbret nga qielli.
v. 27	Isaia 54:1	Kjo është origjina e citatit në vargun 27. Përmbajtja te Isaia përbën një prej festimeve si rezultat i ndryshimit prej rrënimit në bekim.
v. 28	Galatasve 3:29	Në të dyja rastet referenca ka lidhje me faktin që ata që besojnë në Krishtin janë të destinuar për lavdërim.
v. 29	Galatasve 5:11	Pali jepte të kuptonte se ai persekutohet sepse e predikon ungjillin me fuqi të Shpirtit të Perëndisë.
v. 30	Zanafilla 21:10, 12	Kjo është një e dhënë historike te dëbimin e Hagarës dhe birit të saj.
v. 31	Galatasve 5:1	Në vargun 31, Pali përshkruan aplikimin e alegorisë dhe kjo shërben si urë kalimi për paralajmërimin në vargun 5:1.

Skicat Interpretuese: Shembuj shtesë

Gjoni 3:1 (Versioni LIM), Shembulli për studentin

“Farisenjtë” (Shembulli nr 1)

- I. Testamenti i Vjetër në lidhje me farisenjtë
 - A. Farise: Një prej shoqërive më të spikatur dhe më me ndikim të Judaizmit.
 - B. Rrethprerja: Rrethprerja e mashkullit, një rit i dhënë nga Perëndia si një shenjë e besëlidhjes midis Atij dhe Abrahamit, për t'i treguar pasardhësve të Abrahamit që ata i përkisnin Atij.
 - C. Ligji i Moisiut: Përmbledhja e kërkesave të Perëndisë ndaj njeriut në Dhjetë Urdhërimet.
 - D. Hebrenjtë: Njerëzit e zgjedhur të Perëndisë-gjithkush nga raca hebreje i dalë nga robëria.
 - E. Fisi i Beniaminit: Pali farise, pasardhës i fisit prej njërit prej djemve të Jakobit.
 - F. Sinagoga: Instituti hebre për interpretimin e Dhiatës së vjetër.
 - G. Rabin: Mësues i ligjit

- II Dhiata e re në lidhje me farisenjtë
 - A. Shkruetit: Një kategori e njerëzve të shkolluar që studiojnë sistematikisht ligjin.
 - B. Hebrenjtë:
 - C. Pali: Ish-farise dhe përndjekës i hebrenjve i kthyer në një prej apostujve më të shquar
 - D. Publikan: Tagrambledhës romak, i urreyer nga çifutët
 - E. Agjërim: Mungesë ushqimi dhe pijeje
 - F. Prozelit: Banorë të huaj
 - G. Filateri: Kuti lëkure e mbajtur nga meshkujt çifutë në pjesën ballore të kokës dhe në krahun e majtë.
 - H. Damask: Qytet i vjetër i Sirisë, pranë vendit ku Pali u kthye në besimin e krishterë.
 - I. Nikodemi: të drejtosh fariseun dhe udhëheqësin e judenjve të kthehet në krishterim.

III. Karakteristikat e:

- A. Sektit Jude... Veprat 15:5: “Por u ngritën disa nga sekti i farisenjve, që kishin besuar dhe thanë: ‘Duhet rrethprerë johebrenjtë dhe të urdhërohen të zbatojnë ligjin e Moisiut’”.
- B. Ruajtësit e traditës
1. Marku 7:3: “Në fakt farisenjtë dhe të gjithë judenjtë nuk hanë pa i larë më parë me shumë kujdes duart, duke iu përmbajtur traditës së pleqve”.
 2. Marku 7:5-8: “Pastaj farisenjtë dhe skribët e pyetën: ‘Përse dishepujt e tu nuk sillen sipas traditës së pleqve, por hanë bukë pa i larë duart?’”. Por ai duke u përgjigjur u tha atyre: ‘Mirë profetizoi Isaia për ju, hipokritë, siç është shkruar: ‘Ky popull me buzë më nderon, por zemra e tyre rri larg meje. Por kot më bëjnë një kult, duke mësuar doktrina, të cilat janë porosi nga njerëzit’. Duke lënë pas dore, pra, urdhërimin e Perëndisë, ju i përmbaheni traditës së njerëzve: larje brokash dhe kupash; dhe bëni shumë gjëra të tjera të ngjashme’”.
 3. Galatasve 1:14: “Dhe si përparoja në judaizëm më tepër se shumë bashkëkohës të kombit tim, duke qenë jashtëzakonisht i zellshëm për traditat e etërve të mi”.
- C. Kokëfortë për ligjin e Moisiut
1. Veprat 26:5: “Ata më njohin qysh atëherë dhe mund të dëshmojnë, po deshën, se kam jetuar si farise, sipas sektit më të drejtë të fesë sonë”.
 2. Filipianëve 3:5: “U rrethpreva të tetën ditë, jam nga kombi i Izraelit, nga fisi i Beniaminit, Hebre nga Hebrenjtë, dhe sipas ligjit farise”.
- D. Shumë i kujdesshëm në hollësitë e jashtme.
1. Mateu 23:23: “Mjerë ju, skribë e farisenj hipokritë! Sepse ju llogaritni të dhjetën e mëndrës, të koprës dhe të barit të gjumit, dhe lini pas dore gjërat më të rëndësishme të ligjit: gjyqin, mëshirën dhe besimin; këto gjëra duhet t’i praktikoni pa i lënë pas dore të tjerat”.

2. Luka 18:11: "Fariseu rrinte në këmbë dhe lutej në vetvete kështu: 'O Perëndi, të falënderoj që nuk jam si njerëzit e tjerë, grabitqarë, të padrejtë, kurorëshkelës dhe as si ai tagrambledhës'".
- E. I ngurtë në agjërim.
1. Luka 5:33: "Atëherë ata i thanë: 'Përse dishepujt e Gjonit si dhe ata të farisenjve agjërojnë shpesh dhe luten, kurse të tutë hanë dhe pinë?'".
 2. Luka 18:12: "Unë agjëroj dy herë në javë dhe paguaj të dhjetën e gjithçkaje që kam".
- F. Xhelozë për judaizmin.
1. Mateu 23:15: "Mjerë ju, o skribë dhe farisenj hipokritë! Sepse përshkoni detin dhe dheun për të bërë prozelitë, dhe kur ndokush bëhet i tillë, e bëni bir të ferrit dhe dy herë më të keq se ju!"
- G. Të dhënë pas dukjes së jashtme.
1. Mateu 23:5-7: "Por të gjitha veprat e tyre i bëjnë për t'u dukur nga njerëzit; i zgjerojnë filateritë e tyre dhe i zgjatin thekët e rrobave të tyre. Duan kryet e vendit në gostira dhe vendet e para në sinagoga, si edhe përshëndetjet në sheshe dhe të quhen rabbi, rabbi nga njerëzit".
- H. Lakmues.
1. "Dhe farisenjtë, të cilët ishin shumë të dhënë pas parasë, i dëgjonin të gjitha këto dhe i tallnin".

Skica e Interpretimit: Shembuj shtesë*Shembulli për studentin**Fariseu (shembulli nr 2)***I. Persekutesit e pamëshirshëm**

- A. Veprat 9:1,2: “Ndërkaq Sauli, duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit, shkoi te kryepriifti dhe i kërkoi letra për sinagogat e Damaskut, me qëllim që, po të gjente ndonjë ithtar të Udhës, burra o gra, të mund t’i sillte të lidhur në Jerusalem”.
- B. Filipianëve 3:5-6: ‘U rrethpreva të tetën ditë, jam nga kombi i Izraelit, nga fisi i Beniaminit, hebrej nga hebrejtë, dhe sipas ligjit farise, sa për zellin, përndjekës i kishës; përsa i përket drejtësisë, që është në ligj, i paqortueshëm”.

II. Udhëheqës të mëkateve të tyre:**A. Drejtësi në dukje të jashtme**

1. Luka 7:36-50: “Një nga farisenjtë e ftoi atë të hajë bashkë me të, dhe ai hyri në shtëpinë e fariseut dhe u ul në tryezë. Dhe ja, një grua nga ai qytet, që ishte një mëkatore, kur mori vesh se ai ishte në tryzën e shtëpisë së një fariseu, solli një enë alabastri plot me vaj erëkëndshëm. Dhe, duke qëndruar prapa te këmbët e tij dhe duke qarë, filloi t’ia lajë me lot këmbët dhe t’ia fshijë me flokët e kokës së saj; dhe t’ia puthte e t’ia vajoste me vaj erëkëndshëm. Kur e pa këtë gjë, fariseu që e kishte ftuar, tha me vete: ‘Nëse ky do të ishte një profet, do ta dinte çfarë lloj njeriu është gruaja që po prek, sepse ajo është një mëkatore. Dhe Jezusi, duke u përgjigjur, i tha: “Simon, kam diçka për të të thënë”. Dhe ai tha: “mësues, fol”. Dhe Jezusi i tha: “Një huadhënës kishte dy huamarrës; njëri i kishte borxh 500 denarë dhe tjetri 50. meqë ata nuk kishin të paguanin, ai ua fali borxhin të dyve. Sipas teje, cili nga ata do ta dojë më shumë?” Dhe Simoni, duke u përgjigjur, i tha: “Ma do mendja, ai, të cilit i fali më shumë”. Dhe Jezusi i tha: “Gjyko drejt”. Pastaj, si u suall nga gruaja, i tha Simonit: “A e sheh këtë grua? Unë hyra në shtëpinë tënde dhe ti nuk më dhe ujë për të larë këmbët; ajo, përkundrazi,

m'i lau këmbët dhe m'i fshiu me flokët e kresë. Ti nuk më dhe as edhe një puthje; por ajo, qysh se hyra, nuk pushoi së puthuri këmbët e mia. Ti nuk ma vajose kokën me vaj; kurse ajo m'u vajosi këmbët me vaj erëkëndshëm. Prandaj unë po të them se mëkatet e saj të shumta i janë falur, sepse ka dashur shumë; por kujt i falen pak, do pak". Pastaj i tha asaj: "Mëkatet e tua të janë falur". Atëherë ata që ishin në tryezë bashkë me të filluan të thonin me vete: "Po kush qenka ky që falka edhe mëkatet?" Dhe ai i tha gruas: "Besimi yt të shpëtoi; shko në paqe".

B. Verbëri për gjërat shpirtërore

1. Gjoni 3:1-10: "Midis farisenjve ishte një njeri me emrin Nikodem, një krer i judenjve. Ky erdhi natën te Jezusi dhe i tha: "Mësues, ne e dimë që ti je një mësues i ardhur nga Perëndia, sepse askush nuk mund të bëjë shenjat që bën ti, nëqoftëse Perëndia nuk është me të". Jezusi iu përgjigj dhe i tha: "Në të vërtetë, në të vërtetë, po të them që nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë". Nikodemi i tha: "Po si mund të lindë njeriu kur është plak? A mund të hyja ai për së dyti në barkun e nënës së vet dhe të lindë?" Jezusi iu përgjigj: "Në të vërtetë, në të vërtetë, po të them se kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Shpirti, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë. Çka lindur nga mishi është mish, por çka lindur nga Shpirti është shpirt. Mos u mrekullo që të thashë: "Duhet të lindin përsëri". Era fryn ku të dojë dhe ti ia dëgjon zërin, por ti nuk e di nga vjen, as ku po shkon; kështu është edhe çdo njeri që ka lindur nga Shpirti". Nikodemi duke u përgjigjur i tha: "Si mund të ndodhin këto gjëra?" Jezusi u përgjigj dhe i tha: "Ti je mësuesi i Izraelit dhe nuk i ditke këto gjëra?"

C. Theksim në ligjin ceremonial

1. Mateu 15:1-9: "Atëherë skribët dhe farisenjtë e Jerusalemit erdhën te Jezusi dhe i thanë: "Përse dishepujt e tu shkelin traditën e pleqve? Sepse nuk i lajnë duart para se të hanë". Por ai u përgjigj dhe u tha atyre: "Dhe ju përse shkelni urdhërimin e Perëndisë, për shkak të traditës suaj? Perëndia, në fakt, ka urdhëruar kështu: "Ndero atin dhe nënën"; dhe "ai që mallkon të atin ose të ëmën të dënohet me vdekje" –

kurse ju thoni “Kushdo që i thotë atit ose nënës: “gjithçka me të cilën mund të të mbaja, i është ofruar Perëndisë”. Ai nuk është më i detyruar të nderojë atin e vet dhe nënën e vet. Kështu ju keni prapësuar urdhërimin e Perëndisë, për shkak të traditës suaj. Hipokritë, mirë profetizoi Isaia për ju kur tha: “Ky popull po më afrohet me gojë dhe më nderon me buzët; por zemra e tyre rri larg. Dhe më kot më nderojnë, duke i mësuar doktrina që janë urdhërime nga njerëzit”.

D. Shtrembërim i Shkrimit

1. Mateu 15:1,9: “Atëherë skribët dhe farisenjtë e Jerusalemit erdhën te Jezusi dhe i thanë: “Dhe më kot më nderojnë, duke i mësuar doktrina që janë urdhëruar nga njerëzit”.

E. Pengesa besimtarëve potencialë

1. Veprat 9:16,22: “Sepse unë do t’i tregoj atij sa më shumë i duhet të vuajë për emrin tim”. “Por Sauli bëhej gjithmonë e më i fortë dhe i hutonte Judenjtë që banonin në Damask duke ua vërtetuar se Jezusi është Krishti”.

Skicë interpretimi: Shembuj shtesë

Gjoni 4, Shembull për studentin

“Adhurimi”

- I. Përdorimi i Dhiatës së Vjetër
 - A. Kuptimi i fjalës në hebraisht
 1. “Shërbim, puna e skllëvërve, shërbëtorë të paguar”
 - B. Metoda
 1. Lavdërim publik: Psalmi 92:95 -100
 2. Lavdërim si bashkësi: Psalmi 42:4; 1 Kronikave 9:20
 3. Individuale: Zanafilla 24:26; Dalja 33:9; 34:8
 4. Lutja: Psalmi 60:79,80
 5. Trefish i theksuar:
 - a. Lutjet
 - b. Leximi i Shkrimit
 - c. Interpretimi
 - C. Qëllimi: Të shprehësh dashurinë dhe mirënjohjen ndaj Perëndisë përmes një veprimi konkret si rezultat i një adhurimi të brendshëm shpirtëror, Ligji i Përtërirë 11:13; Tensioni midis aspektit shpirtëror dhe atij ceremonial, Dalja 40:6.
- II. Adhurimi në Dhiatën e Re
 - A. Natyra e Adhurimit: dy aspekte të një lloji adhurimi
 1. Njëpërmjet Shpirtit: Gjoni 4:24 (Fil 3:3) jo ku por si
 - a. Adhurim shpirtëror – e kundërta e riteve të jashtme – trupor
 - 1) Perëndia është Shpirt
 - 2) Nevoja e lindjes shpirtërore, Gjoni 3:5,6
 - 3) I pakufizuar në vend a pozicion

- b. Duhet – absolutisht e domosdoshme
 - 1) Shpirti, Gjoni 3:7
 - 2) Shlyerje, Gjoni 3:15
 - 3) Adhurimi, Gjoni 4:24
 - c. Sot: Më tepër njerëzor se shpirtëror; më tepër mahnitshëm se lavdërues i vërtetë, Mateu 15:8, e në vazhdim; zemra, Gjoni 2:24 dhe Gjoni 3; zemra e prishur, Romakëve 1.
 - d. Romakëve 8 – mish, shpirt.
 - e. Perëndia është shpirt, dritë, dashuri dhe jo shpirti, dashuria, drita është Perëndi - vendi i duhur i fjalëve
2. Në të vërtetën
- a. Sipas së vërtetës, në një mënyrë të përshtatshme me zbulesën e vetes së Tij.
 - 1) E vërteta e Shpirtit të Shenjtë
 - 2) E vërteta e Fjalës; njohja e të vërtetës
 - 3) E vërteta e Jezu Krishtit
 - 4) Romakëve 2:1-3 (Jo çfarë mendon ti)
 - b. Realiteti
 - c. Njohuria – Gjoni 22 (23,24 e vërtetë); Zbulesa 22:9, “Mbaji fjalët e këtij libri”; ka rëndësi që të kemi një kuptim të vërtetë për Perëndinë
 - d. Adhures të vërtetë
 - 1) Nëse adhuron në Jerusalem, s’do të thotë patjetër që bën adhurim të vërtetë
 - 2) Nëse adhuron në Samari, s’do të thotë patjetër që bën adhurim të vërtetë
 - 3) Adhurimi i vërtetë është me anë të Shpirtit dhe në të vërtetë
 - e. Në të vërtetë jo me shtirje por me sinqeritet

B. Shfaqja e Adhurimit / teknikat

1. Lavdërimi: Efesianëve 5:19 – “ Mirënjohja është rrënjësore”
 - a. Himnet: Zbulesa 5:8-14; 1 Korintasve 14:26; Kolosianëve 3:16
 - b. Psalmet: Kolosianëve 3:16; Mateu 26:30
 - c. Gëzimi: Rritet spontanisht nëse thellësisht je i gëzuar. “Bashkësi të ngushtë me atë që lavdërohet”. “Duke na urdhëruar që ta lavdërojmë Atë, Perëndia na fton që të jemi me Të”. C. S. Lewis, Reflektimet, fq. 98.
2. Lutja
3. Agjërimi
4. Përdorimi – leximi dhe shpalosja e Fjalës
5. Gjuhët: 1 Korintasve 14
6. Festë dashurie: 1 Korintasve 11:23-25
7. Shërbimi ndaj besimtarëve të tjerë: Luka 10:25-42; Mateu 5:23-48; Jakobi 1:23
8. Përkushtimi: Romakëve 12:1

C. Keqkuptime te adhurimin

1. Ritet e jashtme: Romakëve 2:17-3:8; Mateu 15:8,9
2. Sinqeriteti: Romakëve 2:1-16

III. Keqpërdorime të adhurimit

- A. Paganë ka kapacitet: Romakëve 1; Zbulesa 13:8 Zemra e prishur nuk mund të bëjë adhurim të vërtetë
- B. Kush?
 1. Paganët: Romakëve 1
 2. Njerëzit e moralshëm: Romakëve 2:1-16
 3. Njerëzit fetarë: Romakëve 2:17-3:8
- C. Si?
 1. Me krenari: Romakëve 1
 2. Me ceremoni
 3. Me objektiv të gabuar: Romakëve 1; Gjoni 4; Zbulesa 13:8
 4. Në trup

5. Jo në të vërtetë (Samaria)
6. Jo një ndërgjegje e përsosur dhe e pastër: Hebrenjve 9:9-14. Pengesë e thjeshtë – pastron ndërgjegjen, adhurimi i vërtetë përfshin njohjen e faljes së mëkateve
7. “I përshpirtshëm”; emocional; pesë ndjesitë, atmosfera, tempulli, natyra, etj..

IV. Koha e Adhurimit

- A. Ditën: Veprat 20:7
 - B. Në mënyrë të përditshme: Veprat 2:46
- V. Theksi i adhurimit: dashuri e brendshme dhe përkushtim i një zemre mirënjohëse

Skicat kalimtare: Shembuj shtesë

Gjoni 1:1-10, Shembulli për studentin

I. Ishte Fjala (Gjoni 1:1-4)

- A. Në fillim (Gjoni 1:1-2)
- B. Me Perëndinë (Gjoni 1:2)
- C. Perëndia (Gjoni 1:1)
 - 1. Krijuesi i gjithçkaje (Gjoni 1:3)
 - 2. Në Të ishte jeta (Gjoni 1:4)
 - 3. Jeta ishte drita e njeriut (Gjoni 1:4)

II. Drita (Gjoni 1:5)

- A. Shkëlqen në errësirë (Gjoni 1:5)
- B. Errësira nuk e kuptoi (Gjoni 1:5)

III. Një njeri (Gjoni 1:6-8)

- A. I dërguar nga Perëndia (Gjoni 1:6)
- B. Që quhej Gjon (Gjoni 1:6)
- C. Me qëllim (Gjoni 1:7)
 - 1. Të dëshmonte për dritën (Gjoni 1:8)
 - 2. Që të gjithë të besonin nëpërmjet tij (Gjoni 1:7)
- D. Por ai nuk ishte drita

IV. Drita e vërtetë (Gjoni 1:9-10)

- A. Ndriçon çdo njeri (Gjoni 1:9)
- B. Ishte në botë (Gjoni 1:10)
- C. Bota ishte krijuar përmes Tij (Gjoni 1:10)
- D. Bota nuk e njohu (Gjoni 1:10)

Skicat zbatuese: Shembuj shtesë*Gjoni 4, Shembulli për studentin***I. Të vërtetat themelore**

A. Gjoni 4:27-43; Njerëzit janë gati të dëgjojnë tani; ungjillëzimi agresiv përkundrejt ungjillëzimit miqësor.

1. Gratë, v. 29
2. Burrat, v. 39
3. Më shumë burra, v. 41

II Zbatime

- A. Të zakonshmit
- B. Njerëzit me ngjyrë
- C. Lokale, librari, fusha sportive
- D. Biseda të lira
1. Liri
 2. Problem
 3. Zgjidhje
 4. Mundësi personale – ftesa për t'u lutur bashkë.

III. Ndryshimet në jetë

- A. Mesazhi – prezantim i drejtpërdrejtë i Jezusit.
- B. Ndarje sa më shumë e dëshmisë.
- C. Sjellja – njerëzit janë të interesuar; Perëndia i ka përgatitur.
- D. Kërkoju njerëzve të të ndihmojnë – “A mund të më jepni diçka për të pirë?”.
- E. Bisedat – jofetare drejt temave përgjithësisht shpirtërore, prej kësaj në një temë më specifike.
- F. Dil nga vetja – i gatshëm/ thyer/ traditat e vjetra.
- G. “Mesazhi” – Përdor parimet e Katër Ligjeve Frymërore në vazhdimësi/qasje të zgjidhjes.
- H. Përballja e parë në ungjillizim.

IV. Zbato të gjitha ndryshimet

- A. Vetëdije e dallueshme.
- B. Ndjeshmëri ndaj Shpirtit të Shenjtë.
- C. Ndjeshmëri ndaj pengesave të mundshme.
- D. Lutu specifikisht për njerëzit në vendet ku po shkon.
- E. Memorizo dhe shkruaje dëshminë tënde.
- F. Njohuri më e thellë te metodën e Jezusit për të dëshmuar.
- G. Në vend të argumentave bëj komplimenta.
- H. Ndaje konceptin me tre njerëz të tjerë pastaj në një grup.
- I. Shpirti i Shenjtë

V. Lutja

- A. “Zoti Jezus, më bëj të jem zgjuar me kohë e pa kohë për ndarjen e Lajmit të Mirë me të tjerët”.


VI. Vargu

- A. Gjoni 4:35

VII. Ilustrimi

- A. Ji i zgjuar kohë e pa kohë – i vetëdijshëm për mundësitë. Ky kapitull mund të ishte titulluar: “Çfarë bëri Krishti, dhe çfarë lanë pa bërë dishepujt (nën disa rrethana specifike)”. Ndërsa dishepujt po binin në ujdi për çmimin e ushqimit, Krishti drejtoi për shpëtim një prostitutë.

Me kë u ndeshën dishepujt kur shkuan në qytet për të blerë ushqimin e përgatitur? Me një grua! A ishte e interesuar ajo? Kë tjetër ndeshën në rrugë ata? Në vargun 28, burrat në qytet! Po këta ishin të interesuar? A folën dishepujt me ta? Dyshoj se jo. Në atë kohë ata ishin plot paragjykime.



Me kë u ndeshën dishepujt kur u kthyen te pusi? Në fillim me burrat e qytetit. A folën me ta? Jo. Pastaj, u ndeshën sërish me gruan që po kthehej në qytet. A folën me të?

Jo, dhe e qortuan Krishtin sepse kishte biseduar me të. Pyes veten se, nëse dishepujt do të kishin folur për atë çfarë kishin parë dhe dëgjuar për Krishtin (1 Gjonit 1:3), a do të ishin të interesuar gruaja dhe burrat? “Ndërsa Krishti solli bekim në qytet, dishepujt vetëm sa bënë ca shpenzime në dyqanet përreth”.

Skicat zbatuese: shembuj shtesë

Gjoni 1:1-5, Shembulli për studentin


- I. Cila është e vërteta themelore në këtë pjesë të Shkrimit?
 - A. Jezusi ishte dhe është i vetmi i përjetshmi që ekzistoi para kohërave dhe materies.

- II. Si zbatohet kjo në situatën me qytetin Studenti? Në vendin e punës? Në organizatë? Në lagje? Në vend?
 - A. Thekso si mund të bëhet i njohur Perëndia përmes Zotit Jezus. Perëndia u bë njeri që të ishte njësh me njeriun. Kë mund të njihni më mirë se Jezu Krishtin – Krijuesin – Perëndinë që u bë si një prej krijesave të tij? Gjithashtu, “Ne njohim dashurinë nga kjo, sepse ai dha jetën e tij për ne”. (1 Gjoni 3:16) “Ne nuk kemi një kryepriфт të cilit nuk i vjen keq për dobësitë tona” (Hebrenjve 4:15), dhe “Askush nuk e ka parë Perëndinë kurrë. I vetëmlinduri Bir, që është në gjirin e Atit, mund ta tregojë” (Gjoni 1:18).

- III. Në dritën e këtyre të vërtetave, çfarë ndryshimesh specifike do të bëje në jetën tënde?
 - A. Të fiksosh sytë te Jezusi “autori dhe absoluti i besimit”.
 - B. Të jetosh në një marrëdhënie të tillë me Jezusin sa të thuash ndershmërisht “Për mua të jetuarit është Krishti”.
 - C. Mesazhi im: T’u tregosh jo të krishterëve që Perëndia mund të njihet personalisht, sepse Jezu Krishti është “Fjala e Gjallë e Perëndisë”.

- IV. Si mendon që do t’i zbatosh këto ndryshime?
 - A. Duke ndarë “Katër Ligjet Frymërore”.
 - B. Duke studiuar pas IBS rreth personit të Jezusit: Kristologji.
 - C. Duke mbajtur mend Shkrimin që tregon hyjninë e Krishtit.
 - D. T’u tregoj Dëshmitarëve të Jehovahit rreth Jezusit.

- V. Cila është lutja jote personale në lidhje me këto të vërteta?
- A. Që do të lavdëroj gjithmonë Jezus Krishtin si Zotin dhe Perëndinë tim. Gjithmonë kujto se nuk je “shpënguar përmes gjërave që prishen.., por përmes gjakut të çmuar”. Gjithashtu, jeta dhe ekzistenca jote është përmes Hirrit të Tij dhe shpëtimi “jo për shkak të vetes”.
- VI. Cilin varg do të doje të mbaje mend, i cili përmbledh më së miri të vërtetat e këtij pasazhi?
- A. Gjoni 1:1-5
- VII. Zhvillo një ilustrim, i cili do të të tregojë dhe komunikojë këto të vërteta.



Lista e të vërtetave kryesore tek Gjoni 3:1-8

Shembulli për studentin

1. Duhet lindur përsëri.
2. Njeriu natyror nuk mund të kuptojë të vërtetën shpirtërore.
3. Njeriu natyror nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë.
4. Mishi dhe shpirti janë të ndarë.
5. I njëjtë + I njëjtë = I njëjtë
6. Jezusi është Perëndia.
7. Njeriu është i paplotë nëse nuk ka lindur përsëri.
8. Nuk mjafton të jesh fetar për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë.
9. Statusi moral dhe shoqëror nuk mjafton.
10. Ne nuk mund ta realizojmë vetë rilindjen.
11. Të rilindur nga Fjala e Perëndisë.
12. Vetëm të besosh që Jezusi është Biri i Perëndisë nuk mjafton.
13. Duhet të ketë një pastrim fillestar.
14. S'duhet të befasohesh.
15. Jezusi erdhi nga Perëndia.
16. Jezusi është i ndjeshëm ndaj njerëzve.
17. Përljaja ndaj Perëndisë është më e mrekullueshme se ndaj njerëzve.
18. E drejtoi Nikodemin nga niveli i tij vetjak në Nivelin e Tij.
19. Krishti njuh zemrat e njerëzve.
20. Lindja prej së larti sjell ndryshim të përhershëm të natyrës.
21. Zemra e njeriut duhet të ndryshojë.
22. Gjithkush mund të vijë te Krishti, ditën dhe natën.
23. Lindja e re është universale.
24. Një rrugë e vetme për në mbretërinë e Perëndisë.
25. Gjithkush e ka potencialin për të njohur Perëndinë.
26. Ndryshimi midis të parit dhe të hyrit në mbretëri.
27. Moshë dhe edukimi nuk janë kërkesa për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë.
28. Përljaja
29. Të njohësh vetëm Shkrimin nuk mjafton.
30. Krishti qëndron gjithmonë në nivelin shpirtëror.
31. Jo çdokush është fëmijë i Perëndisë.
32. Nëse je i sinqertë – Perëndia do ta shfaqë veten e Tij.
33. Sinqeriteti në besim nuk mjafton.
34. Jezusi ndryshon zemrën e njeriut, jo mjedisin.
35. Ne nuk mund ta ndryshojmë veten tonë.
36. Të njohurit e Jezusit si mësues dhe udhëheqës i madh nuk mjafton.

SHTOJCA C

Mjete studimi të riprodhueshme

Mund të jetë më e lehtë për ty të fotokopjosh skicat model bosh, se sa t'i përpilosh vetë.

Pas skicave të zbrazëta, kemi dy ndihmesa shtesë studimi që mund të jenë të dobishme. Së pari, ke një listë me gjashtë pyetje vëzhguese dhe dymbëdhjetë pyetje interpretuese, të gjitha në një fletë, për referime të drejtpërdrejta. Fleta e dytë përbëhet nga dy lista: njëra me hapat e interpretimit dhe tjetra me pyetjet zbatuese. Mund t'i fotokopjosh këto faqe për t'i patur të disponueshme gjatë studimit biblik.

Skica e vëzhgimit

Shkrimi	Vëzhgimet	Pyetjet

Skica e Ndër-referimit

Ndër-referimi	Kuptim

PYETJET VËZHGUESE

Nga

MANUALI UDHËZUES PËR TË KUPTUAR BIBLËN

Nga Xhosh Mekdauell

Gjashtë pyetjet interpretuese:

1. Kush?
2. Çfarë?
3. Kur?
4. Ku?
5. Pse?
6. Si?

Pyetjet te Lidhjet:

1. Cilat janë gjërat e ngjashme?
2. Cilat janë të ndryshme?
3. Cilat përsëriten?
4. A ka prova për shkakun dhe efektin?
5. A ka lëvizje nga e përgjithshmja në specifiken?
6. A ka përparim?
7. Cilat pyetje apo përgjigje jepen?
8. A ka problem dhe zgjidhje?
9. A ka rëndësi pasazhi?
10. Ç'fjalë janë përdorur për lidhjet?
11. A ka urdhërime?
12. A ka premtime?

HAPA INTERPRETIMI

Nga

NJË DHËZUES PËR TË KUPTUAR BIBLËN

Nga Xhosh Mekdauell

1. Studim referimesh
2. Konteksti
3. Përkufizime
4. Referime, bibla studimore, libra dhe burime kompjuterike
5. Skicime

HAPA ZBATUES

Për zbatimin e të vërtetave bazë zbatuese për jetën time

1. Si zbatohet kjo e vërtetë në jetën time? Në punë? Në lagjen time? Në shtëpi? Në vendin tim? Shkruaje hollësisht përgjigjen.
2. Në bazë të kësaj të vërtete, ç'ndryshime specifike duhet të ndërmarr në jetën time?
3. Si mendoj t'i arrij këto ndryshime?
4. Cila është lutja ime personale në lidhje me zbatimin e kësaj të vërtete?
5. Ç'pjesë të Shkrimit duhet të mësoj përmendësh, që e përmbledh më së miri këtë të vërtetë?
6. Ç'illustrim mund të zhvilloj, që të më ndihmojë për ta mbajtur mend këtë të vërtetë dhe t'ua përcjell të tjerëve? (Për shembull: një histori, poemë, grafikë, film vizatimor, ose një pikturë)

PËRMBAJTJA

Kapitulli 1. Pse të studiojmë Biblën?	3
Kapitulli 2. Të arrish Tablonë e Gjerë	12

Hapi i parë: Si ta “Shohësh” Udhëzues për vëzhgimin

Kapitulli 3. Bëj pyetjet e duhura	22
Kapitulli 4. Rrëmo më thellë	31
Kapitulli 5. Shih si funksionon	39

Hapi i dytë: Si “ta njohësh atë” Udhëzues për interpretimin

Kapitulli 6. Interpretimi – Gjej kuptimin e vërtetë	48
Kapitulli 7. Lëre Biblën të ta interpretojë	54
Kapitulli 8. Kërko jashtë Biblës	63
Kapitulli 9. Produkti yt përfundimtar	72

Hapi i tretë: Si ta realizosh. Udhëzues për zbatimin

Kapitulli 10. Parimet e zbatimit	82
Kapitulli 11. Studim biblik i shtyrë nga nevoja	93
Kapitulli 12. Ti mund ta bësh	105

Shtojca

Shtojca A: Parafrazim, studim tematik dhe studim biografik	110
Shtojca B: Skica model	119
Shtojca C: Mjete studimi të riprodhueshme	146